



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar”, me profile: a) Dizajn dhe Zhvillim Aplikimesh; b) Menaxhim të dhënash; c) Siguria e sistemeve të informacionit; d) Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh,

ofruar nga

Universiteti Europian i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Assoc. Dr. Gloria Tyxhari

Dr. Olgerta Idrizi

Tetor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, ofruar nga “Universiteti
European i Tiranës”

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar”, me profile: a) Dizënjim dhe zhvillim aplikimesh; b) Menaxhim të dhënash; c) Siguria e sistemeve të informacionit; d) Menaxhim dhe Vlerësim Projektësh”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 408 Dt 22.08.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr. 2484/1 Dt 21.08.2023
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.109, datë 08.07.2020, Urdhër Nr. 110, datë 08.07.2020, Urdhër Nr. 111, datë 08.07.2020, Urdhër Nr. 113, datë 08.07.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 41 datë 14.05.2020
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë, Master Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 6 PAE / 4 PAK 2023-2024 7 PAE / 5 PAK 2024-2025 6 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023, 13 studentë - 1 DZHA / 7 M. të dhënash / SSI 5 2023-2024, 9 studentë - 2 DZHA / 3 MVP / 4 SSI 2024-2025, 4 studentë - 2 DZHA / 2 SSI



19	Komente / të tjera:	-
----	---------------------	---

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” në Universitetin European të Tiranës (UET) është një program njëvjeçar me 60 kredite ECTS, i strukturuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe udhëzimet përkatëse të MAS dhe ASCAL. Programi synon të sigurojë një vazhdim të thelluar të studimeve të ciklit të parë në fushën e informatikës dhe teknologjisë së informacionit, duke ofruar njohuri praktike dhe kompetenca të avancuara profesionale nëpërmjet pesë profileve të specializuara: Dizënjim dhe zhvillim aplikimesh, Menaxhim të dhënash, Siguria e sistemeve të informacionit, TV–Multimeda, Menaxhim dhe vlerësim projektsh, por IAL është shprehur se ka 4 profile aktive, edhe veç për këto 4 profile ka aplikuar për akreditimin, ku profili “TV-Multimedia” nuk ka asnjë student të regjistruar.

Programi është konceptuar për të përgatitur studentët për tregun e punës përmes një qasjeje të balancuar midis teorisë dhe praktikës, duke përfshirë komponentë si praktikat profesionale, projektet aplikative dhe përdorimin e laboratorëve të teknologjisë së informacionit. Ai zhvillon aftësi në fushat e analizës, zgjidhjes së problemeve dhe bashkëpunimit, ndërkohë që nxit përfshirjen në mobilitet ndërkombëtar dhe përditësimin me zhvillimet më të fundit në shkencën dhe teknologjinë e informacionit.

Përveç mësimdhënies teorike, programi përfshin praktika mësimore që mund të kryhen në institucione me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi ose në vendet e punës së studentëve. Kjo i mundëson studentëve të aplikojnë njohuritë në mjedise reale pune, duke rritur aftësitë e tyre profesionale dhe përgatitjen për tregun e punës.

Pas diplomimit, studentët e programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, kanë mundësi të punësohen në sektorin publik apo privat në role të tilla si zhvillues softuerësh, analist të sistemeve, specialist të sigurisë kibernetike, administratorë të bazave të të dhënave, menaxherë projektsh IT, si dhe konsulentë për zgjidhje teknologjike. Profili i zgjedhur gjatë studimeve u jep studentëve mundësinë të thellojnë ekspertizën në një drejtim të caktuar, duke u bërë më konkurrues në tregun e punës.

Programi gjithashtu ofron mundësi për pjesëmarrje në leksione të hapura dhe seminare me profesionistë të njohur nga fusha e IT, duke u ofruar studentëve një perspektivë të gjerë mbi trendet aktuale dhe praktikat më të fundit në industri. Kjo qasje e integruar i përgatit studentët me njohuri dhe aftësi për të ndjekur zhvillimet e vazhdueshme në fushën e TIK-ut.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga dy anëtarë: **Prof.Asoc. Dr. Gloria Tyxhari** dhe **Dr. Olgerta Idrizi**, me mbështetjen e Koordinatorit Teknik të ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar me dorëzimin nga ana e Universitetit Europian të Tiranës, të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një agjende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës, në datat 22 dhe 23 Prill 2025, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Informatikës dhe Arkitekturës, Përgjegjës të Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit (efektiv dhe me kontratë), me studentët e programit të studimit, me përfaqësues të Drejtorisë së Standarteve dhe Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, me përfaqësues të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor si dhe Bibliotekën.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 41, datë 14.05.2020 janë:

1. Institucioni, të përmirësojë kurrikulën e këtij programi studimi përsa i përket ristrukturimit të lëndëve dhe moduleve, rritjes së punëve laboratorike dhe praktikave sipas profileve që ofrohen, si edhe të kryejë pasurimin e syllabuseve të lëndëve me literaturën bashkëkohore dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe.
2. Institucioni, të mundësojë një specializim më të qartë në kurrikulën e këtij programi studimi sipas profileve.
3. Institucioni, të përmirësojë cilësinë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
4. Institucioni, të rrisë bashkëpunimin me institucione dhe ekspertë të jashtëm në mësimdhënie dhe kërkim-zhvillim në fusha konkrete me interes të ndërsjelltë dhe jo vetëm brenda institucionit.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- I. Referuar rekomandimit të parë ngritur nga bordi i akreditimit, është vënë re se janë shtuar orët laboratorike dhe disa literatura janë përditësuar bazuar në rekomandim, por përsëri në syllabuset e vitit të fundit 2024-2025 gjenden literatura të detyruar ose rekomanduara, më të hershme se viti 2019 dhe në gjuhë të huaj, pra rekomandohet përditësimi i vazhdueshëm të lëndëve me literaturë bashkëkohore dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe. **Ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.**
- II. Lëndët me zgjedhje janë sipas profileve por nuk janë të grupuara. Rekomandohet të bëhet grupimi i lëndëve sipas profileve për të kontrolluar edhe lëndët që studenti zgjedh sipas profilit. Pra në kurrikulën e këtij programi studimi nuk ka një specializim të qartë për studentin sipas profileve. *Ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.*
- III. Rekomandohet qëndrueshmëri e stafit akademik. Plotësuar pjesërisht edhe pse ka lëvizje të shpeshta të stafit akademik.
- IV. Sipas evidencave të dorëzuara, vërehet angazhim i ekspertëve të jashtëm në mësimdhënie dhe kërkim-zhvillim, kjo falë edhe bashkëpunimeve të shumta që UET ka me Institucione dhe biznese. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**

Më datë 07.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.14/27 Prot., datë 07.10.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 17.10.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.14/32 Prot., datë 17.10.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit European të Tiranës, për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

Komenti i “UET”:

- *Standardi I.2 Kriteri 5: GVJ rekomandon që të ndërmerren hapa për ndërtimin dhe dokumentimin e trajnimeve profesionale për të diplomuarit në bashkëpunim me sektorin privat, duke reflektuar kështu angazhimin e institucionit për zhvillimin profesional të vazhduar dhe përputhjen me nevojat e tregut.*
- *Përgjigje e UET: Institucioni vlerëson rekomandimin e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm lidhur me nevojën për ndërtimin dhe dokumentimin e trajnimeve profesionale për të diplomuarit në bashkëpunim me sektorin privat. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se natyra e programit Master Profesional në "Informatikë të Aplikuar", me kohëzgjatje njëvjeçare dhe orientim praktik, e bën më sfiduese përfshirjen e studentëve në aktivitete të strukturuar jashtë kurrikulës.*

Pothuajse të gjithë studentët e këtij programi kanë deklaruar që janë të përfshirë në marrëdhënie pune, cka ndikon në disponueshmërinë e tyre për të marrë pjese në projekte të ndryshme kërkimore apo aplikative të zbatuara nga institucioni apo trajnime pasdiplomimi. Për këtë arsye, angazhimi i tyre në projekte të lidhura drejtpërdrejt me programin apo në trajnime të organizuara nga UET ka qënë i kufizuar. Mbetet për të përmirësuar dhe dokumentuar angazhimin e tyre në projekte apo në trajnime të organizuara në bashkëpunim me punëdhënësit. Institucioni ka ndërmarrë hapa për të forcuar bashkëpunimin me sektorin privat dhe për të krijuar mundësi fleksibile për zhvillimin profesional të studentëve dhe diplomuarve, duke synuar që këto iniciativa të jenë të përshtatura me dinamikën e angazhimeve të tyre profesionale. Në këtë kuader, partneritetet ekzistuese me institucione vendase dhe të huaja, si dhe projektet Erasmus+ apo projekte të tjera, përfaqësojnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të komponentit të trajnimeve pas diplomimit.

Institucioni mbetet i angazhuar për të adresuar rekomandimin në mënyrë të plotë, duke ndërtuar mekanizma të qëndrueshëm dhe të dokumentuar për bashkëpunimin me sektorin privat, në funksion të përputhjes së programit me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin profesional të vazhduar të studentëve.

GVJ: vlerëson sqarimet e dhëna nga institucioni dhe nënvizon angazhimin për forcimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe për zhvillimin e mekanizmave fleksibël për përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve në trajnime profesionale. Megjithatë, bazuar në analizën e dokumentacionit dhe të dhënave të verifikuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se aktualisht nuk ekziston dokumentim i strukturuar dhe i qëndrueshëm mbi organizimin e trajnimeve profesionale pas diplomimit në bashkëpunim me punëdhënësit. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe rekomandimi i dhënë në draft-raport mbetet i pandryshuar.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UET”:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

- Standardi I. 3 Kriteri 4 GVJ rekomandon përmirësimin e raporteve si "Analiza EMT mbi arritjen e objektivave formuese", duke përfshirë në to edhe indikatorë të qartë dhe reflektime mbi ndikimin e bashkëpunimeve në realizimin e objektivave formues dhe profesionale të programit. Gjithashtu, sugjeron institucionalizimin e një raportimi periodik analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të zhvillimit të programit.
- Përgjigje e UET: Universiteti European i Tiranës vlerëson rekomandimin e GVJ-se dhe e konsideron të drejtë nevojën për përmirësimin e dokumentacionit analitik lidhur me ndikimin konkret të marrëveshjeve të bashkëpunimit në cilësinë e realizimit të programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar". Si një institucion me një portofol të gjerë bashkëpunimesh dhe projekte të shumta kombëtare e ndërkombetare, UET është i vetëdijshëm se jo të gjitha këto iniciativa kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në përmbajtjen apo zbatimin e këtij programi specifik, vecanërisht për shkak të natyrës së tij profesionale dhe kohëzgjatjes njëvjecare.
 Duhet theksuar se gjatë procesit të akreditimit nuk është kërkuar dokumentacion shtesë që të përmbajë analiza të detajuara, specifike dhe periodike me indikatorë matës mbi përfitimet nga marrëveshjet në funksion të zbatimit konkret të programit. Megjithatë, përfshirja e stafit akademik në projekte të ndryshme kërkimore dhe zhvillimore ka sjellë përfitime të rëndësishme në aspektin e përmirësimit të praktikave mësimore, integritetit të përvojave reale në auditor dhe rritjes së cilësisë së mentorimit akademik. Këto përfitime janë reflektuar në dokumente si "Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese" dhe në dokumente të tjera të vëna në dispozicion për procesin e akreditimit.
 UET angazhohet të adresojë rekomandimin e Bordit përmes institucionalizimit të një raportimi periodik analitik, i cili do të përfshijë indikatorë të matshëm mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar". Ky raport do të strukturohet në mënyrë që të evidentojë ndikimin e bashkëpunimeve në përmbajtjen e kurrikulës, përmirësimin e metodologjisë mësimore, përfshirjen e stafit në projekte dhe mundësitë për angazhimin e studentëve në aktivitete profesionale. Gjithashtu, do të vlerësohen kufizimet objektive që lidhen me natyrën intensive dhe afatshkurtër të programit, si dhe me profilin e studentëve që, pas diplomimit, orientohen menjehere drejt tregut të punës për shkak të kërkesës së lartë për specialiste të kualifikuara në fushën e informatikës.
 Per konkretizim, një rast bashkëpunimi që ilustron ndikimin real të marrëveshjeve në rritjen e cilësisë së formimit profesional të studentëve është ai me kompaninë Integrated Tech Solutions. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, aktualisht, 15 student të UET të programeve Bachelor dhe Master janë përzgjedhur dhe po marrin pjesë në Akademinë për Zhvillues për produktin "Microsoft Dynamics 365 Business Central", të organizuar nga vetë kompania. Programi ofrohet pa asnjë tarifë pjesëmarrjeje për studentët, trajnim intensiv 6-mujor dhe përfundon me certifikim pjesëmarrjeje, si dhe me mundësinë e certifikimit direkt nga Microsoft. Sipas marrëveshjes, studentët më të suksesshëm do të përfitojnë kontratë pune 6-mujore me të drejtë rinovimi.

GVJ: vlerëson qasjen konstruktive të institucionit dhe angazhimin e shprehur për të përmirësuar raportimin analitik mbi bashkëpunimet dhe për të ndërtuar një sistem periodik monitorimi me indikatorë matës. Megjithatë, nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në dokumentat e dorëzuara me kontekst analitik mungon një analizë e strukturuar me indikatorë të matshëm. Gjithashtu nuk është vënë në dispozicion tabela përmbledhëse me projektet që ndikojnë drejtpërdrejt në programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar”, kërkuar gjatë takimit.

Shembulli i paraqitur nga institucioni përfshin studentë të niveleve Bachelor dhe Master pa specifikuar përkatësinë e tyre ndaj këtij programi, ndaj nuk përbën evidencë të drejtpërdrejtë për vlerësimin në fjalë. Si rrjedhojë, konkluzioni dhe rezultati i GVJ mbeten të pandryshuar.

Komenti nuk meret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UET”:

- *Standarti II.1, Kriteri 3, GVJ rekomandon që zhvillimi i praktikës profesionale të kalojë në semestrin e dytë të programit, pasi në këtë fazë studentët kanë përfunduar pjesën më të madhe të lëndëve dhe kanë fituar njohuri më të thelluara, që do të mundësojnë një përvojë praktike më të efektshme. Po ashtu, sugjerohet që në dokumentacionin përkatës të shtohet një përshkrim i qartë mbi arsyetimin e ndarjes së projektit të diplomës në dy semestra, për të siguruar transparencë dhe koherencë të brendshme në strukturën e programit, raportimi periodik analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të zhvillimit të programit.*
- *Përgjigje e UET: Ndoshta kjo nuk ka dalë qartë në dokumentacionin e dorëzuar, por në praktikë, në UET prej disa vitesh projekti i diplomës zhvillohet i ndarë në dy semestra, me qëllim që të sigurohet një proces i qartë, i strukturuar dhe në përputhje me parimet e zhvillimit të kompetencave profesionale dhe kërkimore të studentëve.
Në semestrin e parë, qëllimi është orientues dhe përgatitor. Studentet njihen me: listen e pedagogëve të mundshëm udhëheqës, fushat e tyre të ekspertizës, disa nga punimet dhe publikimet shkencore të pedagogëve, me qëllim që të mund të bëjnë një zgjedhje të informuar për drejtimin e temës së tyre.
Më pas, secili student plotëson formularin personal të temës së diplomës, ku përcakton fushën e interesit dhe kërkesën për pedagogun udhëheqës. Këto formularë i kalojnë Departamentit përkatës, i cili, në mënyrë të koordinuar, finalizon shpërndarjen përfundimtare të studentëve sipas pedagogeve udhëheqës, duke respektuar përputhjen mes fushës së studimit dhe profilit të ekspertizës akademike.
Në semestrin e dytë, procesi zhvendoset drejt fazës metodologjike dhe zbatimit të punimit të diplomës. Studentët ndjekin seanca javore me karakter metodologjik dhe zhvillojnë konsultime individuale me pedagogun udhëheqës (1 orë në javë), sipas një orari të përcaktuar, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe monitorim sistematik të progresit.*

Ky organizim në dy faza krijon një strukturë të balancuar dhe transparente, e cila rrit cilësinë akademike të punimeve të diplomës, forcon përputhshmërinë midis temave të zgjedhura dhe fushave të ekspertizës së stafit akademik dhe garanton ndjekje të rregullt dhe të dokumentuar të procesit të diplomimit.

Megjithatë, Universiteti Europian i Tiranës konfirmon se për vitin akademik 2025-2026 dhe ne vijim, si praktika profesionale ashtu edhe punimi i diplomes janë zhvendosur në semestrin e dytë të programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar". Ky ndryshim është reflektuar në planin mësimor dhe dokumentacionin perkates.

GVJ: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson sqarimin e institucionit dhe faktin që, në praktikë, procesi i projektit të diplomës është zhvilluar tashmë në dy semestra me një strukturë të qartë dhe të monitoruar. Gjithashtu, merret në konsideratë informacioni se për vitin akademik 2025-2026 është bërë zhvendosja e praktikës profesionale dhe e projektit të diplomës në semestrin e dytë.

Megjithatë, duke qenë se ky ndryshim është i sapozbatuar dhe nuk u reflektua në dokumentacionin e dorëzuar për procesin e akreditimit, GVJ vlerëson se rekomandimi mbetet i vlefshëm deri në evidentimin dhe dokumentimin e plotë të zbatimit të tij në praktikë. Rezultati dhe konkluzioni i GVJ mbeten të pandryshuar..

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i "UET":

- *Standarti II.1, Kriteri 7, GVJ nuk ka konstatuar ndonjë program që ofrohet në të njëjtën fushë studimi, e të ketë të njëjtën emërtesë me ngjashmëri në nivel 70%.*
- *Përgjigje e UET: Programi Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" është konceptuar si një program unik, i ndërtuar në funksion të kërkesave të tregut të punës dhe orientuar drejt formimit të specialistëve që janë të aftë të aplikojnë njohuritë informatike në kontekste të ndryshme profesionale, si administratë publike, industri, shërbime, edukim dhe sektorë të tjerë ku teknologjia është e integruar.*

Programi synon të ofrojë një trajnim të orientuar drejt zbatimit praktik, duke reflektuar natyrën profesionale të ciklit të dytë dhe duke u diferencuar nga programet teorike ose kërkimore të fushës. Përmbajtja e tij është ndërtuar në konsultim me aktorët e tregut dhe përfshin komponente të dedikuara për zhvillimin e zgjidhjeve informatike të aplikueshme, cka e bën të vecantë në profilizim dhe në objektivat formues. Në këtë kontekst, ne vlerësojmë se mos konstatimi i një programi tjetër me përmbajtje të ngjashme në nivel 70% reflekton pozicionimin specifik të programit të studimit, si përgjigje ndaj nevojave reale të tregut dhe zhvillimeve teknologjike.

Programet master profesional të ofruara nga universitete të tjera në vënd kanë orientim të ngjashëm aplikativ, por të fokusuar në fusha specifike si ekonomia, biznesi, menaxhimi apo financa, duke integruar komponente informatike në kontekstin e atyre disiplinave. Përmbajtja e tyre përfshin lëndë që janë të ngjashme me ato të programit të studimit

Master Profesional në Informatikë të Aplikuar, si Sistemet e informacionit, bazat e të dhënave, rrjetet kompjuterike, dhe zhvillimi softuerik.

GVJ: vlerëson sqarimin e dhënë nga institucioni dhe pranon se programi Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" ka një profil unik, të orientuar drejt formimit praktik dhe të ndërtuar në konsultim me aktorë të tregut të punës. Ky sqarim është në përputhje me konstatimin fillestar të GVJ-së, e cila nuk evidentoi ndonjë program tjetër me ngjashmëri përmbajtjeje në nivel 70%.

Megjithatë, ky konstatim nuk përbën rekomandim dhe nuk ka ndikuar në vlerësimin e standardit, pasi është përdorur vetëm si element konstatues për të theksuar specifikën e programit në tregun akademik vendas. Për rrjedhojë, rezultati dhe vlerësimi për këtë standard mbeten të pandryshuar.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i "UET":

- *Standarti II.3, Kriteri 5, GVJ ...dokumentacionit në gjuhën angleze për programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, përmban vetëm disa elemente thelbësore, përkatësisht: Statutin dhe organigramën institucionale, rregulloren e programit, si dhe kurrikulën dhe planin mësimor. Megjithatë, përmbajtja e plotë e programit të studimit në anglisht mbetet e paplotë, pasi mungojnë dokumente të rëndësishme si syllabuset e lëndëve, pershkrimi i kompetencave të fituara, modeli i suplementit të diplomës dhe një përmbledhje zyrtare e programit në gjuhën angleze. GVJ rekomandon plotësimin e dosjes me këto dokumente sa më parë për të përmbushur kërkesat e transparencës dhe ndërkombëtarizimit e programit. raportimi periodik analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të zhvillimit të programit.*
- *Përgjigje e UET: Dosja e dorëzuar për programin Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" përmban elementet kryesore të kërkuar në gjuhën angleze, përkatësisht: statutin, organigramën institucionale, rregulloren e programit, kurrikulën dhe planin mësimor. Deri në momentin e vlerësimit, nuk është kërkuar dokumentacion shtesë për syllabuset në apo dokumentacion shtesë në gjuhën anglisht, përtej elementeve të dorëzuara. Hartimi i syllabuseve në gjuhën angleze është pjesë e praktikës së rregullt të punës në cdo Departament të UET, si pjesë e angazhimit për ndërkombëtarizimin dhe mobilitetet akademik. Edhe për programin master Profesional në "Informatikë e Aplikuar", Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, krahas versioneve në gjuhën shqipe, ka hartuar dhe përditësuar syllabuset në gjuhën angleze, të cilat janë pjesë e dokumentacionit të brendshëm dhe përfshihen në dosjen e plotë të programit të studimit.*

GVJ: vlerëson sqarimin e institucionit dhe rekomandon që sqarimi i dhënë të merret në konsideratë dhe të shërbejë si element orientues për proceset e ardhshme të akreditimit. Megjithatë, duke qenë se standardi në fjalë është vlerësuar si "Përmbushet plotësisht", ky sqarim nuk sjell ndryshim në rezultatin dhe vlerësimin përfundimtar të GVJ për këtë standart.

Komenti merret parasysht por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UET”:

- *Standarti II.4, Kriteri 5, GVJ konstaton se, pavarësisht vlerës së literaturës së përzgjedhur, ekziston problematika e përditësimit të literaturës bazë në syllabus-et e lëndëve, konkretisht vihet re se një pjesë e literaturës është e tejkaluar kohërisht, përtej pragut të rekomanduar prej 5 vitesh. Kjo vlen veçanërisht për fusha me zhvillim të shpejtë, si në rastin e lëndës “Aplikim i Sistemeve të Informacionit”, Menaxhim i Proceseve të biznesit, Kriptografia dhe Ethical Hacking, etj, ku tekstet bazë janë përzgjedhur të jenë para vitit 2020.*

Në këtë kuadër, GVJ rekomandon përditësimin e teksteve për çdo lëndë. Kjo do të kontribuonte në rritjen e transparencës, cilësisë akademike dhe përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare.

Përgjigje e UET: Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë në Universitetin Europian të Tiranës (UET) vëren konstatimin e GVJ-së mbi përditësimin e literaturës bazë në syllabuset e lëndëve dhe thekson se literatura bazë e përzgjedhur për programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar i përket viteve 2018 e në vijim, duke respektuar në masën më të madhe dhe aty ku është e mundur pragun e rekomanduar prej 5 vitesh për fushat me zhvillim të shpejtë. Në rastet kur nuk ka botime të reja të teksteve të referencës, stafi akademik jep shpjegim, duke cituar edicionin më të fundit të disponueshëm dhe duke argumentuar vlerën pedagogjike të materialit. Kjo praktikë është konsoliduar në nivel departamenti.

GVJ: vlerëson sqarimin e UET dhe evidenton përpjekjet e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë për të respektuar pragun e rekomanduar të përditësimit të literaturës bazë në masën më të madhe të syllabus-eve. Megjithatë, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe analizat e GVJ, rezulton se në disa lëndë ky kriter nuk është plotësuar, pasi referencat bazë vazhdojnë t’i përkasin periudhës para vitit 2020 — konkretisht në lëndë si Aplikim i Sistemeve të Informacionit, Menaxhim i Proceseve të Biznesit, Kriptografi dhe Ethical Hacking. Duke qenë se këto fusha kanë zhvillim të shpejtë teknologjik dhe kërkojnë literaturë të përditësuar për të garantuar përputhje me praktikën bashkëkohore, GVJ e konsideron të nevojshëm përditësimin e mëtejshëm të literaturës bazë në këto raste. Rekomandimi mbetet në fuqi, ndërsa rezultati dhe vlerësimi i standardit nuk ndryshojnë.

Komenti nuk merret parasysht dhe RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UET”:

- *Standarti II.6, Kriteri 1, GVJ konstaton se, mungojnë dokumente të posaçme që përcaktojnë drejtime kërkimore të qarta brenda programit apo projektet të lidhura drejtpërdrejt me të.*



***Përgjigje e UET:** Në lidhje me konstatimin e GVJ-se për mungesën e dokumentave të posacme që përcaktojnë drejtime kërkimore të qarta brenda programit apo projekte shkencore të lidhura drejtpërdrejt me të, sqarojmë se Programi i studimit “Master Profesional në Informatikë të Aplikuar”, me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatje njëvjeçare, ka një karakter tërësisht profesional dhe nuk ka si objektiv parësor përfshirjen në projekte kërkimore-shkencore. Megjithatë, njësia akademike përgjegjëse për këtë program, si dhe njësia bazë nga e cila buron, janë të angazhuara në veprimtari kërkimore të strukturuar dhe marin pjesë në një numër të konsiderueshëm projektesh shkencore, sic dëshmohet në dokumentacionin mbështetës. Kjo tregon për një kapacitet të qëndrueshëm kërkimor në nivel njësie, edhe pse vetë programi nuk ka komponent të dedikuar kërkimor.*

GVJ: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson sqarimin e institucionit dhe pranon karakterin profesional të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar”, i cili, për shkak të natyrës dhe kohëzgjatjes njëvjeçare, nuk ka si objektiv kryesor zhvillimin e komponentëve kërkimorë. Megjithatë, siç evidentohet edhe në analizën e GVJ në raport, mungojnë dokumente të dedikuara që përcaktojnë drejtime kërkimore të lidhura drejtpërdrejt me programin apo projektet që mbështesin zhvillimin e tij profesional dhe aplikativ.

Ndërsa përfshirja e njësisë bazë në projekte kërkimore të ndryshme tregon kapacitete të qëndrueshme në nivel departamenti, GVJ thekson se lidhja e tyre me objektivat formues të programit nuk është e dokumentuar në mënyrë të qartë. Për këtë arsye, rekomandimi për hartimin e dokumenteve orientuese që përcaktojnë drejtimet kërkimore të lidhura me programin mbetet në fuqi, pa ndryshuar rezultatin dhe vlerësimin përfundimtar të GVJ.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UET”:

- ***Standarti II.6, Kriteri 3, GVJ konstaton se, Pavarësisht këtyre studentët e këtij programi nuk janë pjesëmarrës në këto aktivitete. Për të siguruar përfshirjen aktive të studentëve të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, në aktivitete kërkimore dhe projekte praktikë GVJ rekomandon se institucioni duhet të ndërmarrë hapa konkrete si: integrimi i kërkimit praktik në kurikulë, mbështetje me mentorim dhe trajnime shitesë, etj.***

***Përgjigje e UET:** Programi i studimit “Master Profesional në Informatikë të Aplikuar” përmban komponent praktik, i cili realizohet nëpërmjet detyrave dhe ushtrimeve praktike të integruara në çdo lëndë të kurrikulës. Për të mbështetur këtë proces, studentëve u vihet në dispozicion laboratorë të specializuar të informatikës, të pajisur me aplikacione dhe platforma teknologjike në versionet më të fundit dhe të përditësuara, duke mundësuar një përvojë mësimore të afërt me realitetin profesional.*

Për të nxitur përfshirjen e studenteve në aktivitete praktike dhe kërkimore jashtëkurrikulare, departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë organizon leksione me



lektorë të ftuar, forume me ekspertë të fushës, si dhe promovon pjesëmarrjen në hackathon, konkurse dhe projekte të organizuara nga kompani dhe institucione partnere. Njoftimet për këto aktivitete shpërndahen rregullisht nga departamenti në adresat elektronike të studentëve, mediave sociale të UET etj, por pjesëmarrja mbetet në vullnetin dhe interesin individual të studentëve. Megjithatë vlen për tu theksuar fakti, që studentët e këtij programi studimi janë në mardhënie pune, cka e vështirëson pjesëmarrjen e tyre në trajnime dhe mentorime shtesë.

GVJ: vlerëson sqarimin e UET dhe e konsideron pozitiv angazhimin e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë për të krijuar mundësi për përfshirjen e studentëve në veprimtari me karakter praktik e profesional, si leksione me lektorë të ftuar, forume tematike, hackathon, konkurse dhe aktivitete të organizuara në bashkëpunim me kompani partnere. Këto nisma përbëjnë hapa të vlefshëm për të nxitur ndërveprimin e studentëve me zhvillimet bashkëkohore të fushës dhe për të forcuar lidhjen midis formimit akademik dhe praktikës profesionale.

Megjithatë, bazuar në analizën e GVJ në raport dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk rezulton të jetë e dokumentuar në mënyrë të strukturuar pjesëmarrja konkrete e studentëve të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” në këto aktivitete apo në studime dhe projekte me përmbajtje kërkimore-aplikative. Për të përmbushur kërkesën e këtij kriteri — që synon jo vetëm mundësimin, por edhe nxitjen dhe motivimin e studentëve për përfshirje aktive në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore — GVJ vlerëson se të gjitha aktivitetet e zhvilluara, në të cilat janë ftuar ose kanë marrë pjesë studentët e këtij programi, duhet të përmbledhen në një tabelë përmbledhëse që të specifikojë: llojin e aktivitetit, datën e zhvillimit, pjesëmarrjen e studentëve të programit (nese ka), përmbajtjen ose tematikën e aktivitetit, apo çdo element tjetër që reflekton ndikimin e tij në zhvillimin profesional të studentëve.

Ky dokumentim do të ndihmojë në demonstrimin e qartë të mënyrës se si programi i studimit jo vetëm krijon mundësi, por edhe nxit dhe motivon studentët për përfshirje aktive në aktivitete studimore e kërkimore. Rekomandimi i GVJ mbetet në fuqi, ndërsa rezultati dhe vlerësimi për standardin nuk ndryshojnë.

Komenti merret parasysh pjesërisht por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UET”:

- *Standarti II.6, Kriteri 3, ... Gjithashtu, institucioni në mënyre periodike bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe të ftuar, i cili vlerësohet nga autoriteti drejtues dhe nga studentët. Raportet e performancës ndihmojnë në identifikimin e fushave për përmirësim dhe në zhvillimin profesional të mëtejshëm të stafit si dhe vlen si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit. Raporte të kësaj natyre nuk janë venë në dispozicion për GVJ.*

***Përgjigje e UET:** Në dokumentacionin e dorëzuar për procesin e akreditimit janë përfshirë shembuj konkret që dëshmojnë zbatimin e kësaj praktike. Konkretisht është*



vendosur në dispozicioni formati i vlerësimit nga eprori dhe drejtuesi (Dokumenti 30.16) si dhe një shëmbull i plotësuar nga drejtuesja e departamentit (Dokumenti 30.17). Po ashtu, është përfshirë formati i vlerësimit nga studentet online (Dokumenti 40), së bashku me një shëmbull të plotësuar të këtij vlerësimi (Dokumenti 40.1). këto dokumente dëshmojnë qartësisht angazhimin e institucionit për të monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies dhe të përvojës studentore.

Në këtë mënyrë, institucioni jo vetëm që ndjek një qasje të strukturuar dhe transparente për vlerësimin e stafit akademik, por edhe e dokumenton këtë proces në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme.

GVJ: vlerëson sqarimin dhe dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, i cili dëshmon se procesi i vlerësimit të performancës së stafit akademik zbatohet në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar, si për personelin me kohë të plotë, ashtu edhe për atë të ftuar. Formatet e përdorura për vlerësimin nga eprorët, drejtuesit e njësive dhe studentët tregojnë një qasje të mirëstrukturuar dhe transparente, që mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të stafit.

GVJ e ka konfirmuar këtë praktikë në përmbajtjen e vet të raportit si dhe në evidencat në të cilat referohet, por formulimi i përdorur në fjalinë përmbjllëse të paragrafit përkatës ka lënë të kuptohet e kundërta, si pasojë e një pasaktësie redaktimi dhe jo e një mospërputhjeje me realitetin institucional. Ky koment nuk ka ndikuar në rezultatin e vlerësimit për këtë standard, i cili është vlerësuar maksimalisht me “Përmbushet plotësisht”. Duke u mbështetur në evidencat e paraqitura dhe në përmbajtjen faktike të raportit, GVJ konfirmon se institucioni e zbaton në mënyrë të qëndrueshme dhe të verifikueshme procesin e vlerësimit të performancës së stafit akademik.

Komenti merret parasysh dhe RVJ ndryshon.

Komenti i “UET”:

- *Standarti V.2, Konkluzione ...GVJ konstatoi se UET përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale, ambjentet e IAL, broshurave, medias online dhe jo vetëm, ditëve të hapura dhe takimeve nëpër institucionet e arsimit të mesëm. Sipas takimeve me stafin akademik, Përgjegjësën e Departamentit dhe në bazë të evidencave të dorëzuara, vihet re një kërkesë e ulët në regjistrime, vit pas viti.*

Përgjigje e UET: Në përgjigje të konstatimit të GVJ-së lidhur me nivelin e kërkesës për regjistrim në programet e ciklit të dytë, Master Profesional, institucioni dëshiron të sqarojë se, pavarësisht tendencës së vërejtur në uljen e numrit të aplikimeve vit pas viti, kjo nuk lidhet me mungesën e strukturave promovuese apo me mungesë angazhimi institucional. Përkundrazi, Universiteti Europian i Tiranës ka zhvilluar dhe implementuar një sistem të konsoliduar promovimi, i cili përfshin publikimin e informacionit në rrjetet sociale, ambjentet e institucionit, broshura informuese, media online, organizmin e ditëve të hapura, si dhe takime të drejtpërdrejta me studentët e vitit

të tretë të ciklit bachelor. Megjithëse këto mekanizma kanë funksionuar në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, vihet re se tendenca në ulje e kërkesave për regjistrim në programet Master Profesional është një fenomen që reflektohet në shkallë kombëtare dhe nuk është specifik për Institucionin tonë. Kjo tendencë është e lidhur ngushtë me ndryshimet në politikat e punësimit të aplikuara nga administrata publike dhe sektori privat, ku në shume rast Diploma e Masterit Shkencor përmendet si kriter i preferuar kualifikimi për pozicionet e punës. Për këtë arsye, institucioni vlerëson se tendenca e uljes së kërkesave për regjistrim në programet Master Profesional duhet parë në një kontekst më të gjerë, ku faktorët e jashtëm si politikat aktuale të punësimit në administratën publike dhe sektorin privat, luajnë një rol të rëndësishëm. Gjithsesi, institucioni mbetet i angazhuar për të analizuar dinamikat e tregut të arsimit të lartë dhe të punësimit, si dhe për të ndërmarre masa të përshtatshme për të rritur atraktivitetin e programeve profesionale në përputhje me nevojat reale të tregut dhe pritshmëritë e kandidatëve potencialë.

GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së UET për sugjerimin e sipër cituar, vërejmë se: UET dhe strukturat e tij, për programin e studimit Master Profesion në Informatikë të aplikuar me profile, kanë zhvilluar dhe implementuar një sistem të konsoliduar promovimi por përsëri fluksi i regjistrimeve është i ulët. Ky është një fakt i cili konstatohet dhe nga vetë Institucioni, panvarësisht punës së realizuar prej tyre. Institucioni mund të implementojë politika të tjera ose të rishikojë programin e studimit në mënyrë përrthithjen e studentëve në këtë program.

Komenti merret parasysht por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i "UET":

- Standarti VI.5, Kriteri 5, GVJ Rekomandohen veprimtari periodike për ti informuar në mënyrë të drejtpërdrejtë studentët për nevojën e ndërgjegjësimit të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile.


Përgjigje e UET: Institucioni i kushton rëndësi të vecantë përfshirjes së studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të përvojës akademike. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë një sërë veprimtarish të strukturuar që synojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme. Studentët angazhohen rregullisht në fokusgrupe ku ndajnë mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi përmbajtjen e programeve dhe cilësinë e mësimdhënies. Përmes platformave të vlerësimit online, ata japin vlerësim mbi lëndët dhe stafin akademik, duke kontribuar në identifikimin e fushave për përmirësim. Gjithashtu, mbledhjet e hapura me studentët të zhvillura nga Departamenti dhe takimet mujore me përfaqësuesit e qeverisë studentore dhe Rektoren, krijojnë një hapsirë të drejtpërdrejtë komunikimi, ku shqetësimet dhe propozimet e tyre trajtohen me seriozitet institucional.



Një komponent i rëndësishëm në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe ndërgjegjësimit studentor është edhe kontributi i rrjetit të Alumnit. Institucioni ka krijuar mekanizma të qëndrueshëm komunikimi me ish-studentët e programit, të cilët ofrojnë perspektiva të vlefshme mbi përvojën e tyre akademike dhe integrimin në tregun e punës. Përmes pjesmarrjes në forume, takimi informuese dhe aktiviteteve të organizuara nga departamenti, Alumni ndihmjnë në orinetimin e studentëve aktual, ndajnë praktikatat më të mira dhe japin sugjerime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes dhe metodologjisë mësimore. Ky bashkëpunim përfaqëson një vlerë të shtuar për institucionin dhe ndihmon në forcimin e lidhjes midis formimit akademik dhe kërkesave reale të tregut. Përmes këtyre mekanizmave, institucioni synon jo vetëm të informojë studentët por edhe ti inkurajojë të marrin rol aktiv në ndërtimin e një kulture cilësie dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të tyre të studimit. Angazhimi i tyre shihet si një komponent thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe efektiv të institucionit.

GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së UET për sugjerimin e sipër cituar, konfirmojmë se ky rekomandim synon në realizimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të drejtëpërdrejta me studentët në mënyrë që të rritet angazhimi i tyre në proceset e sigurimit të cilësisë.

Komentit nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	GVJ arrin në përfundimin se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile: a) Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh; b) Menaxhim të dhënash; c) Siguria e sistemeve të informacionit; d) Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh, i ofruar nga Universiteti European i Tiranës (UET), është në përputhje me interesat kombëtare dhe synon konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore. Kjo përputhshmëri është e shprehur në Statutin e UET, ku institucioni deklaron misionin e tij për të ofruar arsim të lartë cilësor dhe për të kontribuar në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe ndërlidhjes me tregun e punës. Në Planin Strategjik të UET 2021-2025, theksohet qartë objektivi për të përgatitur profesionistë të aftë dhe qytetarë të përgjegjshëm, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, duke ndërlidhur arsimin me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet socio-ekonomike. <i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA Final.pdf</i> <i>Vizita IAL</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është ndërtuar në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të Universitetit European të Tiranës (UET), si dhe në linjë me fushën e tij të veprimtarisë. Sipas dokumentit “Plani Strategjik i MP6IA”, ky program ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (DIT), në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës dhe është hapur në mbështetje të strategjisë institucionale të UET. Gjithashtu, “Plani Strategjik i UET 2021-2025” thekson si prioritet zhvillimin e programeve në përputhje me nevojat e tregut dhe

	<p>orientimin drejt fushave me ndikim për zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit.</p> <p><i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA Final.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Në bazë të dokumenteve të IAL, GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe me dokumentet themelore rregullatore të tij. Në dokumentin e posaçëm strategjik të programit, thuhet se ky është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore dhe në mbështetje të strategjisë institucionale të UET. Strategjia e UET thekson zhvillimin e fushave prioritare me ndikim në zhvillimin teknologjik, dixhitalizim dhe përgatitjen e profesionistëve për tregun e punës. Në dokumentin “Studimi për tregun e punës”, theksohet se ky program është konceptuar për të nxitur zhvillimin profesional dhe punësimin e të diplomuarve, në përputhje me dinamika të reja të tregut vendor dhe rajonal. Kjo qasje mbështetet edhe në përmbajtjen e planit mësimor, i cili pasqyron ndarje të qartë të veprimtarive formuese dhe kompetencave praktike që synon të zhvillojë.</p> <p>GVJ konstaton se programi është konceptuar dhe strukturuar në përputhje me drejtimet akademike të institucionit, si pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës dhe zhvillohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë. Programi është i organizuar si master profesional njëvjeçar me 60 ECTS, duke ndjekur struktura të përcaktuara nga Marrëveshja e Bolonjës dhe praktikat evropiane për kualifikimin e shpejtë të profesionistëve. GVJ vlerëson se aspektet akademike dhe të punësueshmërisë janë ndër objektivat thelbësorë të programit dhe të institucionit, të shprehura si në dokumentet strategjike, ashtu edhe në përmbajtjen konkrete të programit.</p> <p><i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA Final.pdf</i> <i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i> <i>Evidenca 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> RVB Vizita IAL</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është ndërtuar në përputhje me prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik të vendit, si dhe me tendencat globale për zhvillimin e shoqërisë dixhitale. Në dokumentin “Studimi për tregun e punës”, vihet në dukje se programi është ndërtuar në përputhje me kërkesat në rritje të tregut të punës për profile të specializuara në fushën e teknologjisë së informacionit. Kjo mbështetet edhe nga opinionet e Bordit të Tregut të Punës, i cili thekson rëndësinë e përgatitjes së kadrove të kualifikuara në TIK dhe sugjeron ndërthurjen e përmbajtjes teorike me komponentë praktikë, duke reflektuar kështu prirjet zhvillimore të tregut kombëtar dhe global.</p> <p>Në dokumentin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, UET paraqet bashkëpunime me institucione shtetërore, kompani të sektorit privat dhe organizata të tjera që mundësojnë zhvillimin praktik dhe integrimin e studentëve në tregun real të punës.</p> <p>Programi, siç përmendet edhe në Plani Strategjik i programit MP, synon të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve kombëtare në teknologji, duke u mbështetur në zhvillimet më të fundit globale dhe dokumente të politikave zhvillimore kombëtare.</p> <p><i>GVJ rekomandon që të vihet më shumë në pah ndikimi i projekteve të bashkëpunimit dhe partneriteteve me aktorë të jashtëm, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë dhe relevancës së programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA Final.pdf</i> <i>Evidenca 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> <i>Evidenca 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi UET në funksion të programit.pdf</i> RVB Vizita IAL: Takimi me përfaqësuesit e Departamentit</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Analiza e programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, të Universitetit European të Tiranës tregon përputhje të qartë me misionin institucional, strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe prirjet globale në fushën e teknologjisë. Programi është i ndërtuar mbi baza ligjore dhe strategjike, në harmoni me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. GVJ vlerëson strukturën njëvjeçare të programit dhe përmbajtjen e tij praktike, por rekomandon intensifikimin e promovimit të bashkëpunimeve me aktorë të jashtëm dhe përditësimin e</i></p>

	<i>vazhdueshëm të përmbajtjes në përputhje me zhvillimet e shpejta të fushës së IT-së.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (DIT), që funksionon në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës në Universitetin Europian të Tiranës (UET), siç përmendet në dokumentin Plani Strategjik i programit. Kjo strukturë është në përputhje me fushën e programit dhe tregon se njësi bazë përgjegjëse ka profil akademik në drejtim të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Sipas dokumentit “Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB”, Tabela 12.5 reflekton qartë që në këtë program janë të angazhuar 7 pedagogë (4 PAE dhe 3 PAK), me formim në fushën e informatikës përfshirë mbulimin e lëndëve profesionale dhe teknike nga të cilët 4 janë me titullin Dr dhe 3 Msc. Nga dokumenti “CV e stafit akademik”, del që shumica e stafit ka eksperiencë në mësimdhënie të lëndëve të fushës së TI-së si programim, inxhinieri softuerike, aplikime kompjuterike dhe sisteme informacioni, si dhe përvoja të mëparshme në universitete të tjera.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takim me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit, GVJ u informua se një pjesë e stafit efektiv ka angazhime të qëndrueshme ndër vite dhe ka ndihmuar në hartimin dhe zhvillimin e programit. U theksua gjithashtu sfida për gjetjen e stafit të kualifikuar në fushën e teknologjisë së informacionit për shkak të konkurrencës së lartë në tregun e punës, gjë që është një fenomen i zakonshëm në këtë fushë në nivel kombëtar.</p> <p><i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA_Final.pdf</i> <i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidenca 20. CV e stafit akademik te programit.pdf</i> RVB</p>

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p><i>Vizita IAL</i></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstaton se fusha e studimit të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse, Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Në dokumentin “Plani Strategjik i MP6IA”, theksohet që programi është konceptuar në përputhje me misionin dhe kompetencat e njësisë përkatëse akademike, duke u bazuar në ekspertizën që ekziston në fushën e teknologjisë së informacionit dhe nevojat për tregun e punës.</p> <p>Përputhshmëria me fushën akademike dhe kërkimore të stafit të angazhuar në këtë program evidentohet në dokumentin “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit”, ku për secilin anëtar jepen temat kërkimore në përputhje me lëndët e ofruara në program.</p> <p>Në “Tabelat përmbledhëse për RVB”, programi përshkruhet si pjesë e fushës së Teknologjisë së Informacionit, duke reflektuar lidhjen e përmbajtjes me emërtimin dhe profilin institucional të njësisë që e ofron.</p> <p><i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA_Final.pdf</i> <i>Evidenca 43. Të dhëna mbi kerkimin shkencor të stafit – Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> <i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse, që është Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës pranë UET.</p> <p>Në dokumentin “Plani Strategjik i MP6IA” theksohet që programi mbështetet në kapacitetet ekzistuese të departamentit dhe pasqyron përputhjen me objektivat dhe prioritetet akademike dhe kërkimore të tij. Kjo përputhshmëri përforcohet nga përmbajtja e planit mësimor, ku lëndët mbulojnë fusha të teknologjisë së informacionit, duke reflektuar qartë orientimin akademik të njësisë që e ofron. Gjithashtu, dokumenti “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit” tregon se temat kërkimore të stafit të angazhuar në program mbulojnë drejtpërdrejt fushat që përbëjnë përmbajtjen e programit,</p>

	<p>duke garantuar një lidhje të qëndrueshme ndërmjet kompetencave kërkimore të njësisë dhe profilit të programit.</p> <p>Në këtë rast, programi nuk është ndërdisiplinor në kuptimin e bashkëpunimit të strukturave të ndryshme për mbulim tematik, por zhvillohet brenda njësisë që ka kapacitetet për të garantuar mbulim të plotë të fushës së tij akademike.</p> <p><i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA Final.pdf</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i> <i>Evidenca 43. Të dhëna mbi kerkimin shkencor të stafit – Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> <i>Vizita IAL</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>GVJ konstaton se ky program nuk është jashtë profilit të institucionit, për pasojë ekspertiza në mbarëvajtjen e tij mbulohet nga vetë IAL.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, GVJ konstaton se, ndonëse në dokumentin “Projekte Aktive” paraqiten iniciativa të ndryshme në nivel institucional, nuk rezultojnë të ketë projekte të lidhura drejtpërdrejt me programin Master Profesional në “Informatikë të Aplikuar” me profile. Gjatë vizitës në IAL, Përgjegjësja e Departamentit pohoi se studentët e këtij programi nuk kanë qenë të përfshirë në këto projekte. Gjithashtu, nuk u identifikuan trajnime të strukturuar profesionale pas diplomimit në bashkëpunim me punëdhënësit. Në dokumentin “Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit”, paraqiten disa partneritete me universitete dhe institucione të huaja, si dhe bashkëpunime në kuadër të projekteve Erasmus+ dhe SIGMA Agile. Megjithatë, këto marrëveshje nuk përmbajnë të dhëna të specifikuar për angazhimin e diplomuarve të këtij programi në trajnim profesional të mëtejshëm apo përfshirjen e drejtpërdrejtë të punëdhënësve në këtë proces. Gjatë vizitës në institucion, nuk u paraqitën evidencat shtesë që lidhen me organizimin sistematik të trajnimeve pas përfundimit të studimeve, në koordinim me punëdhënësit apo për nevojat e tregut të punës.</p>



	<p><i>GVJ rekomandon që të ndërmerren hapa për ndërtimin dhe dokumentimin e trajnimeve profesionale për të diplomuarit në bashkëpunim me sektorin privat, duke reflektuar kështu angazhimin e institucionit për zhvillimin profesional të vazhduar dhe përputhjen me nevojat e tregut.</i></p> <p><i>Evidenca 34. Marreveshje bashkepunimi - lista UET.pdf</i> <i>Evidenca 28.6. Projekte Aktive.pdf</i> <i>Vizita në LAL</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse, Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, si pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Struktura organizative dhe përmbajtja e programit reflektojnë qartë profilin dhe ekspertizën e njësisë që e ofron, siç dëshkohet në dokumentet strategjike dhe në temat kërkimore të stafit akademik. Programi zhvillohet brenda një fushe të specializuar që mbulohet nga vetë institucioni, pa pasur nevojë për mbështetje nga institucione të tjera partnere. Megjithatë, mungesa e trajnimeve profesionale të strukturuar pas diplomimit dhe mospërfshirja e studentëve të programit në projekte të drejtpërdrejta përbëjnë një aspekt që kërkon përmirësim. GVJ rekomandon që të ndërmerren hapa konkretë për të rritur përfshirjen e studentëve në aktivitete praktike dhe trajnime të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion dhe nga takimi me stafin PAE/PAK, GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, mbështetet nga lëndë dhe staf të cilat mbulohen dhe nga departamente të tjera. Kështu përmendim që, përveç vetë departamentit “Informatikë dhe Teknologji”, përfshihen në procesin mësimor dhe Qendra për</p>

<p>nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit, Departamenti “Menaxhim dhe Marketing” etj. Nga kjo ndërthurje kuptojmë një marrëdhënie të mirë ndërinstitucionale në funksion të plotësimit të programit master.</p> <p>Bazuar në Statutin UET, Rregullore UET, shihen të përcaktuara me detaje roli dhe detyrat e Dekanit, Zv. Dekanit, Përgjegjësit të njësisë bazë, Përgjegjësit të grupit mësimor, Përgjegjësit të punës kërkimore shkencore, Personelit akademik, etj.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidence 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin “Marreveshje bashkëpunimi - lista UET”, GVJ konstaton se institucioni ka vendosur një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të ndryshëm të tregut. Konkretisht, rezulton se janë në fuqi dhjetëra marrëveshje me universitete dhe qendra kërkimore ndërkombëtare, përfshirë institucione nga Gjermania, Italia, Austria, Franca, Lituania, Qipro, Belgjika, Kosova, Bosnja e Hercegovina etj. Këto bashkëpunime krijojnë mundësi reale për mobilitet, projekte të përbashkëta, si dhe përfshirje në aktivitete akademike me ndikim ndërkombëtar.</p> <p>Po ashtu, sipas dokumentacionit të paraqitur nga IAL, janë dorëzuar edhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase si Infosoft Systems, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Kompania “The Headhunter”, Intesa SanPaolo Bank, që krijojnë mundësi për shkëmbime përvoja, praktika profesionale dhe bashkëpunime të mëtejshme në zhvillimin e kurrikulës, në përputhje me nevojat e tregut.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, u konfirmua përfshirja e institucionit në shumë projekte, si dhe angazhimin për të rritur rolin e bashkëpunimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, por u vu re mungesa e projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë në këtë program studimi.</p> <p>GVJ vlerëson që marrëveshjet e bashkëpunimit dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe sugjerojnë që ato të shfrytëzohen në mënyrë më të drejtpërdrejtë për përfshirjen e studentëve në aktivitete praktike, projekte dhe mobilitet, si dhe të</p>

	<p>dokumentohen përfitimet konkrete në funksion të objektivave të programit.</p> <p><i>Evidenca 34. Marreveshje bashkepunimi - lista UET.pdf</i> <i>Vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ evidenton se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione, organizata profesionale dhe biznese të ndryshme (dokumenti “Marreveshje bashkepunimi - lista UET”) që përfshijnë si objektiv realizimin e praktikave profesionale, mbikëqyrjen e tyre dhe bashkëpunimin për trajnime apo angazhime të tjera praktike. Siç theksohet edhe në RVB, marrëveshjet kanë natyrë institucionale ose fakulteti, por nga dokumenti “Monitorimi i ecurisë së studentëve - MP në “Informatikë e Aplikuar” vërehet se një pjesë e studentëve kanë kryer praktika në kompani partnere, duke konfirmuar zbatimin praktik të komponentit të parashikuar në planin mësimor.</p> <p>Gjithashtu, në dokumentin “Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese” përfshihet moduli i praktikës profesionale, ndërsa gjatë vizitës në institucion u sqarua që praktika zhvillohet si në auditor, ashtu edhe në kompani, në dy faza. Përmes “Bordit të Tregut të Punës DIT”, evidentohet ekzistenca e një strukture konsultative për lidhjen me tregun e punës, megjithëse mungojnë raportime të detajuara për ndikimin konkret të këtij bordi në menaxhimin e praktikave apo bashkëpunimin me punëdhënësit.</p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i> <i>Evidenca 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre – MP Informatikë e Aplikuar (Tabela 23).pdf</i> <i>Evidenca 12.1. Bordi i tregut të Punës DIT.pdf</i> <i>Evidenca 34. Marreveshje bashkepunimi - lista UET.pdf</i> <i>RVB</i> <i>Vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit, nuk rezulton të ketë një raport të mirëfilltë dhe periodik analitik që të përmbledhë përfitimet konkrete nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Edhe pse përmenden bashkëpunime të ndryshme në dokumentin “Marreveshje bashkëpunimi - lista UET” dhe në disa përmbledhje të tjera institucionale (si p.sh. analiza e departamentit) këto dokumente nuk ofrojnë analiza të detajuara, të strukturuar dhe</p>



	<p>periodike mbi ndikimin e marrëveshjeve në cilësinë e realizimit të programit të studimit, siç kërkon kriteri në fjalë.</p> <p>Përfundimisht, në një fragment të dokumentit “Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese” përmendet ndonjë bashkëpunim në kalendarin e aktiviteteve, por nuk përbën një raport të dedikuar për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Si përfundim, <i>GVJ konstaton se mungojnë në dokumentacion pjesët analitike specifike dhe periodike me indikatorë matës të përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të zbatimit konkret të programit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon përmirësimin e raporteve si “Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese”, duke përfshirë në to edhe indikatorë të qartë dhe reflektime mbi ndikimin e bashkëpunimeve në realizimin e objektivave formues dhe profesionalë të programit. Gjithashtu, sugjeron institucionalizimin e një raportimi periodik analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të zhvillimit të programit.</i></p> <p><i>Evidenca 34. Marreveshje bashkepunimi - lista UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet nga vizita në institucion, GVJ vlerëson se institucioni ka ndërtuar një strukturë funksionale të bashkëpunimit të brendshëm për hartimin dhe mbarëvajtjen e programit Master në “Informatikë e Aplikuar” me profile, duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet njërive përkatëse. Gjithashtu, është evidentuar një rrjet i gjerë marrëdhëniesh bashkëpunimi me institucione vendase dhe të huaja, të cilat përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të programit në aspektin praktik dhe ndërkombëtar. Megjithatë, mungesa e raporteve të mirëfillta analitike dhe periodike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit paraqet një boshllëk në dokumentimin dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në realizimin konkret të objektivave të programit. Institucioni inkurajohet të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe të raportimit për të reflektuar në mënyrë të qartë dhe të matshme rezultatet e bashkëpunimeve në funksion të cilësisë së programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura e programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi në arsimin e lartë, si dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në planin mësimor janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, numri i krediteve për secilën prej tyre dhe ndarja sipas semestrave, duke përfshirë komponentë të detyrueshëm, me zgjedhje dhe praktikë profesionale, në përputhje me strukturën standarde të një programi 1-vjeçar me 60 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i> <i>Evidenca 54.7. Urdher Nr.251, date 14.06.2013 Per akreditimin e MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese”, rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është ndërtuar në mënyrë të tillë që të ofrojë njohuri të përparuara, si dhe të zhvillojë kompetenca teknike dhe profesionale të aplikuara në fushën e teknologjisë së informacionit. Në dokument përshkruhet qartë qëllimi i programit për të përgatitur studentët për të kuptuar dhe zbatuar parimet e thelluara të IT-së, në mënyrë që të përballen me situata dhe probleme të ndërlikuara në mjediset reale të punës. Gjithashtu, në këtë dokument identifikohen qartë pozicionet potenciale të punës për të diplomuarit, të cilat përfshijnë një spektër të gjerë rolesh, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Specialist i Sistemeve IT

<p>për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Specialist i rrjetave kompjuterike • Zhvillues softuer • Analist i të dhënave • Administrator i bazave të të dhënave • Menaxher i Projekteve IT • Analist i sistemeve • Specialist i sigurisë kibernetike • Analist i biznesit • Menaxher BI • etj <p>Këto pozicione reflektojnë përputhjen midis përmbajtjes së programit dhe kërkesave të tregut të punës, duke dëshmuar që programi synon jo vetëm njohuritë teorike dhe kuptimin kritik të fushës, por edhe aftësimin praktik dhe profesional për fusha të specializuara.</p> <p>GVJ vlerëson se përmbajtja, struktura dhe rezultatet e të nxënit të parashikuara në programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, përputhen me objektivat e këtij kriteri, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave të avancuara dhe të transferueshme për një larmi profesionesh në sektorin e TIK-ut.</p> <p><i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese”, rezulton se në programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, janë të përcaktuara qartë si ngarkesa në kredite, ashtu edhe format përkatëse të veprimtarive për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse.</p> <p>Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Praktika profesionale, e kategorizuar si një njësi formuese e tipologjisë D (lëndë plotësuese), është e integruar në semestrin e parë të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” dhe mbart një ngarkesë prej 6 kreditesh ECTS. Kjo praktikë përfshin një kombinim të përvojës në auditor dhe në ambient pune, ku studentët zhvillojnë kompetenca praktike në bashkëpunim me kompani të fushës së teknologjisë së informacionit. Puna e praktikës konvertohet në 150 orë gjithsej, nga të cilat 128 orë realizohen në auditor dhe 22 orë si punë e pavarur që

	<p>përfshin përgatitjen e raportit dhe vetëreflektimin mbi eksperiencën.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekti i diplomës, i klasifikuar si një komponent i tipologjisë E (detyrim përmbyllës), është i shpërndarë në të dy semestrat dhe përfaqëson fazën përmbyllëse të programit. Ky projekt përbëhet nga një temë profesionale ose kërkimore që ndërmerret nën udhëzimin e një pedagogu udhëheqës dhe i mundëson studentit të aplikojë njohuritë dhe aftësitë e fituara në mënyrë të pavarur ose provim formimi. Ngarkesa në kredite për këtë komponent është 12 ECTS dhe përkthehet në gjithsej 300 orë pune, nga të cilat 20 orë konsultime në auditor dhe 280 orë punë e pavarur për përgatitjen e projektit final. <p>Të dyja këto komponentë janë të renditura në strukturën zyrtare të planit mësimor dhe përfaqësojnë veprimtari të detyrueshme për përfundimin e programit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe të Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p><i>GVJ rekomandon që zhvillimi i praktikës profesionale të kalojë në semestrin e dytë të programit, pasi në këtë fazë studentët kanë përfunduar pjesën më të madhe të lëndëve dhe kanë fituar njohuri më të thelluara, që do të mundësojnë një përvojë praktike më të efektshme.</i> Po ashtu, sugjerohet që në dokumentacionin përkatës të shtohet një përshkrim i qartë mbi arsyetimin e ndarjes së projektit të diplomës në dy semestra, për të siguruar transparencë dhe koherencë të brendshme në strukturën e programit.</p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i></p> <p><i>Vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm për këtë program studimi.</p>

<p>organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, zhvillohet në një institucion privat të arsimit të lartë (UET) pa status të veçantë, ndaj ky kriter nuk është i aplikueshëm për këtë rast.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ nuk ka konstatuar ndonjë program që ofrohet në të njëjtën fushë studimi, e të ketë të njëjtën emërtesë me ngjashmëri në nivel 70%.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin</p>	<p>Bazuar në RVB, grupi i punës shprehet se “... për programin e ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Informatikë e</p>



<p>përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Aplikuar me profile, UET ka propozuar kodin 71MP-0619-S, me argumentimin: bazuar në kurrikulën dhe rrezultatet e të nxënit të tij, fusha e programit të studimit sipas ISCED-F 2013: Teknologji informacioni dhe komunikimi të pa klasifikuara diku tjetër. Ndërkohe pritet nga Ministria Përgjegjëse për arsimin, të gjitha kodet e programeve për të gjitha IAL.</p> <p>Bazuar në dokumentacion “Shkresë UET, datë 31.03.2023 Propozimet për kodifikimin e programeve të studimit”, institucioni kthen përgjigje Ministrisë së Arsimit dhe Sportit mbi propozimet e bëra për kodifikimet e programeve të studimit, por mungon dokumentacioni bashkëlidhur për të verifikuar sugjerimet e tij.</p> <p>Bazuar në këtë informacion GVJ sugjeron intensifikim të komunikimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për të kuptuar statusin e dokumentit të dorëzuar. Është e rëndësishme që UET të jetë proaktiv në këtë proces për të përshpejtuar miratimin.</p> <p><i>Evidence 31.3: <u>31.3. Shkresë UET, datë 31.03.2023 Propozimet për kodifikimin e programeve të studimit.pdf</u></i> RVB</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në të dhënat e analizuar nga GVJ, nuk rezulton që programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, të jetë një program i përbashkët i zhvilluar në bashkëpunim me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë, vendas apo të huaj. Në asnjë nga dokumentet e vlerësuara nuk paraqiten marrëveshje të posaçme apo akte rregullatore që të dëshmojnë statusin e një programi të përbashkët sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p> <p>Megjithëse UET ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të huaja dhe vendase, referuar “Marrëveshje bashkëpunimi - lista UET”, këto marrëveshje nuk përfshijnë ofrimin e përbashkët të këtij programi konkret studimi.</p> <p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, pasi programi nuk është konceptuar apo ofruar si një program i përbashkët sipas legjislacionit përkatës.</p> <p><i>Evidenca 34. <u>Marrëveshje bashkëpunimi - lista UET.pdf</u></i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe respekton strukturën e një programi 60 ECTS sipas standardeve të BE-së. Elementet</i></p>



	<p><i>përbërëse të programit, përfshirë ngarkesën në kredite, praktikën profesionale dhe projektin përmyllës, janë të përcaktuara qartë. Programi synon zhvillimin e kompetencave të avancuara dhe aftësive të transferueshme për një gamë të gjerë profesionesh në fushën e teknologjisë së informacionit. Në përgjithësi, struktura dhe përmbajtja e programit janë të mbështetura nga dokumentacioni përkatës dhe përputhen me kërkesat e Standardit II.1.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2			
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton që: referuar “URDHER Nr.529, date 04.09.2018 Për hapjen e FIJA në UET”, departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 529, datë 04.09.2018, zhvillon të gjitha veprimtaritë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p>Në dokumentin “Statuti i UET_Organigrama aktuale”, përmendet qartë përbërja e njësive bazë të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Në këtë dokument thuhet se fakulteti përfshin: Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë, Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe Qendrën për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit. Kjo strukturë është në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet institucionale për organizimin e njësive bazë në një fakultet universitar.</p> <p>Referuar RVB dhe “Të dhënat tabelore për personelin akademik të Fakultetit dhe Departamentit që e ofron këtë program studimi (Aneks Tabelat 1, 2)”, paraqiten si më poshtë:</p>		
		2023-2024	2024-2025

Kualifikimi i stafit akademik të Fakultetit	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	4	2	2	1
Prof. Asoc.	4	3	4	1
Dr/Phd	12	13	13	10
Msc.	20	34	27	24
Gjithsej	40	52	46	36

Të dhënat e stafit të Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, për 3 vitet e fundit akademike, janë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	-	1	-	-	-
Prof. Asoc.	1	2	1	3	1	1
Dr/Phd	7	6	6	7	7	6
Msc.	9	18	13	22	17	13
Gjithsej	18	26	21	32	25	20

Kjo tregon se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, sipas VKM Nr. 418, pika xi dhe pika xii, i përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf

Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela 1, 2).pdf

Evidenca 54.2. URDHER Nr.529,date 04.09.2018 Për hapjen E FIIA në UET.pdf


Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe të shprehur në RVB, konstatohet nga GVJ që për zhvillimin e

<p>programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>praktikave profesionale angazhon personel ndihmës akademik, pedagog të brendshëm i departamentit. Referuar Tabelat përmbledhëse për Aneks (Tabela 7), reflekton dy asistentë PAE me Msc.</p> <p><i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i> <i>Evidenca: RVB</i> <i>Vizita IAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet, pasi njësia bazë përgjegjëse për programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, ka përcaktuar qartësisht rolin e koordinorit të programit të studimit. Në dokumentin “Vendimi i Dekanatit për koordinorët e programeve” përcaktohet emërimi i koordinorëve për secilin program studimi në kuadër të njësive përkatëse. Ky dokument formalizon përgjegjësinë e individëve të caktuar për monitorimin dhe zhvillimin e programeve akademike, duke përfshirë ndjekjen e përmbajtjes mësimore, cilësisë së mësimdhënies, si dhe praktikave profesionale.</p> <p>Funksioni i koordinorit është gjithashtu i përshkruar në mënyrë të tërthortë në dokumente të tjera si rregullorja e programit të studimit dhe plani i veprimit i KSBC, ku roli i tij konsiderohet si ndërmjetës midis departamentit dhe strukturave të tjera të institucionit, duke ndihmuar në përmirësimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të programit.</p> <p><i>Evidenca 36.1.Vendim dekanati për koordinorët e programeve.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se njësia bazë përgjegjëse për programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile përmbush kërkesat e standardit II.2, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e cilësisë. Fakulteti dhe departamenti përkatës janë të strukturuar në përputhje me kriteret ligjore, ndërsa përbërja dhe kualifikimet e stafit akademik të angazhuar i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në VKM nr. 418. Për realizimin e praktikave profesionale është angazhuar personel akademik i brendshëm, duke garantuar zhvillimin e tyre në përputhje me objektivat e programit. Gjithashtu, është emëruar koordinor i</p>

	<i>programit, roli i të cilit është formalizuar dhe i përkufizuar qartë në dokumentacionin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se njësiti përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Këto gjenden në dokumentat e referuara më poshtë. Një pjesë e konsiderueshme e këtij informacioni gjendet dhe në faqen zyrtare online të IAL.</p> <p>Dokumentacioni i referuar përmban të gjitha të dhënat mbi strukturën organizative të institucionit (Statuti dhe organigrama), rregulloret e brendshme që përcaktojnë mënyrën e funksionimit të programeve dhe njësive akademike, planin strategjik të programit, planin mësimor dhe syllabuset përkatëse të lëndëve, duke mundësuar transparencë dhe qartësi të plotë mbi organizimin, përmbajtjen dhe objektivat formuese të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA Final.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.pdf</i> <i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i> <i>Vizita IAL</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është i strukturuar dhe i dokumentuar në përputhje me kërkesat e këtij</p>



<p>informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>kriteri. Në dokumentin “Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese”, paraqitet një plan mësimor i detajuar, ku janë përfshirë elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura semestrare: Programi është 1-vjeçar dhe i ndarë në dy semestra akademikë. Në secilin semestër është planifikuar një grup lëndësh, duke respektuar ngarkesën prej 30 ECTS për semestër. - Tipologjia e veprimtarive: Lëndët kategorizohen sipas tipologjive A, B, C, D dhe E (detyrueshme, me zgjedhje, praktika dhe detyrime përmbyllëse), siç parashikohet në udhëzimet standarde të arsimit të lartë. - Ngarkesa mësimore (ECTS): Çdo lëndë është e shoqëruar me numrin përkatës të krediteve ECTS, që kontribuon në totalin prej 60 ECTS për programin. - Orët në auditor/jashtë auditorit: Për secilën lëndë jepet ndarja e ngarkesës orare midis orëve në auditor dhe punës së pavarur të studentit. Për shembull: Lënda “Kriptografia dhe Ethical Hacking” ka 6 ECTS, që përkthehen në 150 orë gjithsej, ku 64 orë janë në auditor dhe 84 janë punë e pavarur. Projekti i diplomës (detyrim përmbyllës - tipologjia E) mbart 12 ECTS, që përkthehen në 250 orë, nga të cilat 20 orë janë konsultime në auditor dhe 230 orë punë e pavarur. <p>Kjo strukturë garanton një organizim të balancuar midis komponentëve teorikë dhe praktikë, si dhe i ofron studentit një pamje të qartë të ngarkesës dhe përmbytjes së programit.</p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ ve re se, programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, përmban informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me:</p> <p>1. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit. Këto janë të detajuara në “Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve”, ku përcaktohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kushtet e pranimit sipas nivelit të studimit, - Procedurat e aplikimit, - Dokumentet e nevojshme, - Peshat e kriterëve të vlerësimit për përzgjedhje. <p>Rregullorja e UET dhe Rregullorja e programit të studimit përmendin se pranimi realizohet në bazë të diplomës së ciklit të parë dhe kriterëve shtesë të përcaktuara nga njësia përkatëse.</p>

	<p>2. Transferimi i studimeve dhe njohja e krediteve, “Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin” jep qartësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedurat për transferim brenda apo jashtë institucionit, - Parimet për ekuivalentimin e krediteve të mëparshme, - Komisionet dhe afatet për shqyrtimin e kërkesave. <p>3. Ekuivalentimi i studimeve, “Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin” përcakton edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Praktikat për njohjen e mësimave të mëparshme, - Procedurat për aplikimin dhe vendimmarrjen për ekuivalentime, - Përfshirjen e studentëve në rastet kur kreditë janë pjesë e mobilitetit akademik. <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf</i> <i>Evidenca 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstatoi se për secilën lëndë të planit mësimor janë të përfshira informacionet bazë të kërkuara për përmbushjen e këtij kriteri. Syllabuset përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Titullin e lëndës dhe kodin përkatës. - Vëllimin në kredite ECTS. - Objektivat e lëndës. - Përmbajtjen tematike dhe ndarjen javore të temave. - Llojin e aktivitetit formues (leksion, seminar, laborator). - Metodën e mësimdhënies dhe vlerësimit. - Orët në auditor dhe orët e punës së pavarur për çdo komponent. <p>Syllabuset pasqyrojnë qartë elementët brenda dhe jashtë auditorit për çdo lëndë, në përputhje me kërkesat e formateve të miratuara institucionalisht. Po ashtu, specifikohen dhe komponentët praktikë kur aplikohen, si laboratorë dhe punë projektsh.</p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i> Vizita IAL</p>

<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p><i>RVB</i></p> <p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njësisë bazë dhe kryesore se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, i nënshtrohet përditësimeve periodike në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat institucionale për sigurimin e cilësisë akademike.</p> <p>Elementët kryesorë që përmbushin kriterin janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedura institucionale për ndryshimin e kurrikulës është përshkruar në dokumentin “Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Tabela 11)”, ku specifikohen qartë hapat që ndjekin njësitë akademike për të inicuar dhe miratuar ndryshime, si dhe përfshirja e aktorëve institucionalë (njësia bazë, Këshilli i Fakultetit, Senati Akademik). - Vendimi i Senatit Akademik Nr. 05, datë 20.09.2022, vërteton që janë ndërmarrë ndryshime në kurrikula në masën nën 20% për disa programe të studimit, përfshirë edhe atë në MP në “Informatikë të Aplikuar” me profile, duke provuar që përditësimet janë bërë sipas rregullave dhe janë miratuar nga - “Plani i Veprimit KSBC”, përmend detyrimin për rishikimin periodik të programeve dhe përmirësimin e tyre mbi bazën e rekomandimeve të brendshme dhe të vlerësimit të jashtëm. <p>Aktualisht, dosja e dokumentacionit në gjuhën angleze për programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, përmban vetëm disa elemente thelbësorë, përkatësisht: Statutin dhe organigramën institucionale, rregulloren e programit, si dhe kurrikulën dhe planin mësimor. Megjithatë, përmbajtja e plotë e programit të studimit në anglisht mbetet e paplotë, pasi mungojnë dokumente të rëndësishme si syllabuset e lëndëve, përshkrimi i kompetencave të fituara, modeli i suplementit të diplomës dhe një përmbledhje zyrtare e programit në gjuhën angleze.</p> <p><i>GVJ rekomandon plotësimin e dosjes me këto dokumente sa më parë për të përmbushur kërkesat e transparencës dhe ndërkombëtarizimit.</i></p> <p><i>Evidenca: <u>52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Tabela 11).pdf</u></i></p>
--	---

	<p><i>Evidenca: 54.8.2. Vendim i Senatit Nr. 05, date 20.09.2022 Per miratimin e ndryshimeve ne kurrikulat e programeve nen 20 per qind.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 2.1. Statuti i UET Organigrama aktuale anglisht.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7.1. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (anglisht).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14.1. Kurrikula e programit MP Informatikë e Aplikuar (anglisht).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14.3. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (anglisht).pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe informacionet e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se programi Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, është i strukturuar dhe dokumentuar në përputhje me objektivat formuese të ciklit të dytë. Programi paraqet qartësisht organizimin akademik, përmbajtjen e planit mësimor, të dhënat mbi ngarkesën mësimore, kriteret e pranimit dhe transferimit, si dhe informacionin e plotë mbi syllabuset dhe komponentët e formimit brenda/jashtë auditorit. Gjithashtu, ekziston një mekanizëm institucional për përditësimin e kurrikulës, ndonëse dokumentacioni në gjuhën angleze dhe evidenca e arkivimit vjetor nuk rezultojnë të dokumentuara plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, është strukturuar në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi është me kohë të plotë dhe ka një kohëzgjatje prej një viti akademik, të ndarë në dy semestra me nga afërsisht 30 ECTS secili, për një total prej 60 kreditesh ECTS, siç kërkohet për programet e ciklit të dytë profesional. Ngarkesa mësimore është e organizuar në përputhje me

	<p>tipologjitë standarde të veprimtarive formuese (A, B, C, D, E), duke përfshirë komponentë teorikë, praktikë dhe detyrime përmbyllëse.</p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është strukturuar në përputhje me objektivat formues dhe rezultatet e pritshme të të nxënit të ciklit të dytë të studimeve. Programi është 1-vjeçar dhe i ndarë në dy semestra, me nga rreth 30 ECTS për çdo semestër, duke përbushur ngarkesën totale prej 60 ECTS, sipas kërkesave ligjore dhe të Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve.</p> <p>Ngarkesa e lëndëve në përgjithësi është 6 ECTS, përveç lëndës Menaxhim Rrjetash Kompjuterike që ka 10 ECTS dhe lëndës Aplikimi i Sistemit të Informacionit që ka 8 ECTS. Të dyja janë lëndët e tipologjisë B - përgatitje për disiplinën shkencore. Lënda me më shumë kredite është “Projekti i Diplomës”, e cila i përket tipologjisë E (detyrim përmbyllës) dhe mbart 12 ECTS, që përkthehet në një ngarkesë totale prej 300 orësh, nga të cilat 20 orë janë në auditor dhe 280 orë punë e pavarur.</p> <p>Lëndët janë të shoqëruara me përshkrime të detajuara në syllabuse, përfshirë objektivat, rezultatet e të nxënit, temat dhe metodat e mësimdhënies/vlerësimit. Kjo strukturë përbajtësore dhe kredituese siguron përputhjen midis përbajtjes akademike dhe nevojave të tregut të punës, duke i pajisur studentët me kompetenca të avancuara në teknologjitë e informimit, inteligjencën artificiale dhe analitikën e të dhënave në kontekste të biznesit.</p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në</p>	<p>Bazuar në RVB, “...programi i studimit lëndët, shpërndarja e krediteve si dhe raporti i teorisë me praktikën janë në përputhje me</p>

<p>përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>profilin e programit Master profesional. ... raporti pothuajse i balancuar, 1:1 midis orëve teorike dhe atyre praktike... “</p> <p>Nga dokumenti “Plani mësimor i programit_MP Informatikë e Aplikuar (shqip)” me profile, del qartë që shpërndarja e orëve për secilën lëndë është e strukturuar në mënyrë që të realizojë një raport të ekuilibruar ndërmjet komponentëve teorikë dhe praktikë. P.sh.:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikimi i Sistemeve të Informacionit <ul style="list-style-type: none"> - Leksione: 28 orë në auditor / 34.5 orë punë e pavarur - Seminare: 8 orë / 31 jashtë - Laborator: 6 orë në auditor / 7 orë jashtë - Kontroll i vazhdueshëm: 22 orë në auditor / 23 orë jashtë 2. Menaxhim i riskut në IT <ul style="list-style-type: none"> - Leksione: 28 orë / 34.5 jashtë - Seminare: 14 orë / 36 jashtë - Kontroll i vazhdueshëm: 18 orë / 20 jashtë 3. Kriptografia dhe Ethical Hacking <ul style="list-style-type: none"> - Leksione: 28 orë / 34.5 jashtë - Seminare: 8 orë / 22 jashtë - Laborator: 6 orë / 7 jashtë - Kontroll i vazhdueshëm: 22 orë / 23 jashtë <p>Kjo përmbledhje e të dhënave tregon që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Orët në auditor për leksione (teori) janë zakonisht 28 orë - Orët në auditor për komponentët praktikë (seminare, laboratorë, kontroll i vazhdueshëm) variojnë nga 34 (lëndët me 6 ECTS) deri në 44 orë (për më tepër) - Punë jashtë auditorit për teorinë është ~34.5 orë - Punë jashtë auditorit për praktikën varion ndërmjet 66 dhe 82 orë <p>Ky raport i shpërndarjes së ngarkesës mësimore vërteton orientimin praktik të programit dhe angazhimin për zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve, siç kërkohet për një program të ciklit të dytë me profil Master Profesional. Struktura reflekton një qasje të përputhshme me praktikën më të mira të arsimit të lartë, duke siguruar formim të thelluar në aspektin aplikativ të fushës së teknologjisë së informacionit.</p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit është i ndarë sipas veprimtarive formuese A, B, C, D dhe E, siç parashikohet nga</p>

<p>raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>kuadri ligjor i arsimit të lartë. Kjo ndarje gjendet në dokumentin “Plani mësimor i programit”, ku për çdo lëndë janë përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngarkesa në orë leksionesh dhe seminare/laboratorësh; - Përbërja e krediteve ECTS sipas kontributit të veprimtarive të ndryshme në formimin e studentit; - Lëndët me karakter teorik dhe ato me theks praktik. <p>Programi demonstroi një raport të balancuar mes komponentëve teorikë dhe praktikë, duke siguruar që studentët të përvetësojnë njohuri themelore dhe aftësi të aplikueshme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe biznesit. Lëndë si “Kriptografia dhe Ethical Hacking”, “Menaxhim i riskut në IT”, etj ofrojnë kombinim të leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe kontrollit të vazhdueshëm, gjë që tregon për strukturim të qartë për arritjen e objektivave formues të programit.</p> <p>Ndërkohë, prezenca e praktikave profesionale dhe projektit të diplomës në semestrin e dytë (Tipologjia D dhe E) tregon se programi ka integruar komponentë të përshtatshëm për transferueshmëri të njohurive dhe ndihmon në përgatitjen për punësim, ashtu siç theksohet edhe në dokumentacion, kjo strukturë mbështet edhe mobilitetin e mundshëm të studentëve, duke respektuar parimet e krahasueshmërisë me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i></p> <p>RVB</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Sipas RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar, Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë ka vendosur si praktikë përditësimin periodik të literaturës bazë dhe të detyrueshme të programit të studimit, në fillim të çdo semestri. Në përzgjedhjen e literaturës, jepet përparësi teksteve të botuara nga shtëpi botuese të njohura ndërkombëtare si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, si dhe botues të tjerë të mirënjohur si Sage, Routledge, Pearson dhe Elsevier, që garantojnë standard të lartë akademik dhe përmbajtje bashkëkohore.</p> <p>Megjithatë, GVJ konstaton se, pavarësisht vlerës së literaturës së përzgjedhur, ekziston problematika e përditësimit të literaturës bazë në syllabus-et e lëndëve, konkretisht vihet re se një pjesë e literaturës është e tejkualuar kohërisht, përtej pragut të rekomanduar</p>


	<p>prej 5 vitesh. Kjo vlen veçanërisht për fusha me zhvillim të shpejtë, si në rastin e lëndës “Aplikim i Sistemeve të Informacionit”, Menaxhim i Proceseve të biznesit, Kriptografia dhe Ethical Hacking, etj, ku tekstet bazë janë përzgjedhur të jenë para vitit 2020. Në këtë kuadër, <i>GVJ rekomandon përditësimin e teksteve për çdo lëndë. Kjo do të kontribuonte në rritjen e transparencës, cilësisë akademike dhe përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p> <p><i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit Master Profesional “Informatikë e Aplikuar” me profile, garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, në përputhje me objektivat formuese dhe me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Kuadri Kombëtar dhe Evropian i Kualifikimeve për ciklin e dytë të studimeve.</p> <p>Në dokumentin “Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip)”, programi është strukturuar në mënyrë që mbulon aspekte thelbësore të fushës së teknologjisë së informacionit dhe aplikimeve të saj në biznes, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve të informacionit në kontekste organizative - Sigurinë kibernetike dhe etikën digjitale - Analizën dhe menaxhimin e të dhënave - Aftësi praktike në zhvillimin e softuerëve dhe zbatimin e teknologjive bashkëkohore <p>Për më tepër, vlerë të shtuar programit i japin edhe disa lëndë me orientim drejt menaxhimit të biznesit, si “Menaxhimi i Proceseve të Biznesit” dhe “Menaxhimi i Riskut në IT”, të cilat kontribuojnë në formimin e një profili hibrid: teknik dhe menaxherial. Këto lëndë pasurojnë kompetencat ndërdisiplinore të studentëve dhe i përgatisin ata për role të integruara në tregun e punës, ku kërkohet njohja e teknologjisë në funksion të optimizimit të proceseve të biznesit dhe të menaxhimit të rreziqeve.</p> <p>Syllabuset e lëndëve të përfshira në program pasqyrojnë objektiva mësimorë të qartë, të ndarë sipas rezultateve të të nxënësve: në komponentë të njohurive teorike, aftësive praktike dhe kompetencave të përgjithshme profesionale. Veprimtaritë formuese</p>

	<p>janë të strukturuar në mënyrë të balancuar në teori dhe praktikë (leksione, seminare, laboratorë, detyra, projekte), dhe përfshijnë gjithashtu praktikën profesionale dhe projektin e diplomës si elemente integruese.</p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p>Vizita IAL RVB</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe RVB, programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, synon të pajisë studentët me aftësi të aplikueshme direkt në tregun e punës, përmes një strukturë të balancuar midis përmbajtjes teorike dhe praktikës profesionale.</p> <p>Ndërkohë, lidhjet e krijuara me aktorët e jashtëm përmes subjekteve bashkëpunuese për praktikat profesionale (<i>Evidenca 32 dhe 32.3</i>) kontribuojnë në lehtësimin e tranzicionit drejt punësimit pas diplomimit. Praktikrat dhe trajnimet profesionale janë të integruara në planin mësimor si komponentë detyrues, duke e forcuar më tej këtë orientim.</p> <p>Në përputhje me legjislacionin shqiptar për Arsimin e Lartë (<i>Ligji Nr. 80/2015</i>), diplomat Master Profesional nuk krijojnë automatikisht të drejtën për vijimin e studimeve në ciklin e tretë (doktoraturë). Megjithatë, studentët mund të vijnë studimet në Master Shkencor ose mund të ndjekin kualifikime të mëtejshme përmes çertifikimeve profesionale dhe specializimeve të tjera të lidhura me profilin e tyre, sipas interesit dhe nevojave të tregut.</p> <p><i>Evidenca 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Master Profesional Informatikë e Aplikuar (Tabela 9).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikrat profesionale (Aneks Tabela 5).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32.3 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikrat profesionale 2023-24.pdf</i></p> <p>RVB</p>




Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se struktura dhe organizimi i programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, janë në përputhje të plotë me objektivat formues dhe nivelin e kualifikimit të parashikuar në Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve për ciklin e dytë. Programi shfaq një ndarje të qartë sipas veprimtarive formuese dhe ofron një raport të balancuar midis përmbajtjes teorike dhe praktike, në përputhje me profilin profesional të synuar. Përmbajtja e lëndëve dhe struktura kredituese janë të përshtatura me nevojat e tregut të punës dhe sigurojnë përfitimin e aftësive ndërdisiplinore në fushën e IT-së dhe biznesit. Megjithëse vërehet nevoja për përditësim më të rregullt të literaturës në disa lëndë, programi në tërësi garanton përfitimin e kompetencave të synuara dhe ofron mundësi reale për punësim apo zhvillim të mëtejshëm profesional për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti është i përkushtuar për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Statuti i UET, neni 30, pika 30.4, parashikon se çdo program studimi konsultohet në mënyrë të herëpashershme me Bordet e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Në këtë kontekst, një shembull konkret i zbatimit të kësaj praktike është organizimi i një focus grupi me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës pranë Departamentit, ku u shqyrtuan në mënyrë të drejtëpërdrejtë kurrikulat e programeve të ciklit të dytë. Pjesëmarrësit dhanë opinione dhe sugjerime për përmirësimin e përmbajtjes mësimore, me theks të veçantë tek nevoja për të forcuar komponentin praktik. Ata vlerësuan gjithashtu përgatitjen e studentëve dhe shprehën interes për punësimin e tyre, duke konfirmuar kështu përputhshmërinë ndërmjet programit dhe kërkesave reale të tregut të punës. Kjo tregon që mekanizmat e



	<p>përfshirjes së aktorëve të jashtëm janë funksionale dhe ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e mëtejshëm të programit.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> RVB Vizita IAL</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni ka të formalizuara mekanizmat për përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të programeve të studimit. Këta mekanizma shfaqen në disa forma:</p> <p>Së pari, përfaqësimi i studentëve në strukturat vendimmarrëse akademike sigurohet përmes Këshillit të Studentëve, i cili, sipas Statutit të UET (<i>Neni 51.5</i>), ka të drejtën të shprehë mendime dhe të propozojë përmirësime edhe për programet e studimit. Kjo dëshmon për një angazhim institucional në përfshirjen e studentëve aktivë në vendimmarrje.</p> <p>Së dyti, përfshirja e ALUMNI-t në procesin e përmirësimit të programeve evidentohet në “Studimin për Tregun e Punës”, ku është organizuar një fokus grup me Bordin e Tregut të Punës. Sipas RVB, pjesë e këtij grupi kanë qenë edhe alumni të programit, të cilët kanë ndarë përvojat dhe sugjerimet e tyre mbi përputhshmërinë e programit me kërkesat e tregut të punës. Komentet e tyre kanë ndihmuar në identifikimin e nevojës për rritjen e komponentit praktik në disa lëndë të ciklit të dytë, përfshirë Masterin Profesional në Informatikë të Aplikuar.</p> <p>Së treti, sipas RVB, departamenti organizon rregullisht mbledhje të hapura me studentët aktivë, të paktën një herë në muaj. Këto mbledhje ofrojnë një hapësirë të strukturuar ku studentët mund të paraqesin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të përmbajtjes dhe cilësisë së programit të studimit dhe më gjerë, Një format procesverbali të mbledhjeve ku studentët janë të përfshirë gjendet edhe në dokumentin “Mbledhje e hapur me studentët”</p> <p>Pra UET ka treguar përkushtim të vazhdueshëm ndaj rrjeteve të ALUMNI. Ky përkushtim është i dokumentuar në Planin Strategjik 2015–2020, nën seksionin “Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore”, <i>pika 3</i>.</p> <p>GVJ vëren se këto rrjete funksionojnë edhe janë aktivisht të përfshira në strukturat konsultuese dhe drejtuese të institucionit, si dhe në aktivitete zhvillimore.</p>

	<p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidenca 12.5. Mbledhje e hapur me studentët.pdf</i> RVB Vizita IAL</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është ndërtuar në mënyrë që të përgjigjet drejtpërdrejtë nevojave të tregut të punës për kualifikimin e specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit, një nga prioritetet kyçe për zhvillimin ekonomik të vendit. Zhvillimi i këtij programi është mbështetur jo vetëm në analizën e kërkesave të tregut, por edhe në sugjerimet e vazhdueshme të grupit Alumni dhe Bordit të Tregut të Punës, të cilët kanë ofruar rekomandime konkrete për përmbajtjen dhe orientimin praktik të programit, referuar “Studimi për tregun e punës”.</p> <p>Gjithashtu, programe si Panairi i Punës apo Programi 500+, përfaqësojnë mekanizma të institucionalizuar të bashkëpunimit të qëndrueshëm me kompanitë më të mëdha në vend, përmes të cilëve UET merr informacion të drejtpërdrejtë mbi nevojat aktuale të tregut të punës dhe zhvillimet në sektorë të ndryshëm, duke i reflektuar ato në mënyrë të qëndrueshme në përmirësimin, përditësimin dhe përshtatjen e programeve të studimit. Megjithatë nuk ka ndonjë dokument i cili vërteton impaktin e drejtpërdrejtë të këtyre projekteve mbi programin e studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon hartimin dhe dorëzimin e një dokumenti që vërteton impaktin e drejtpërdrejtë të tyre mbi përmbajtjen e programit.</i></p> <p><i>Evidenca 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> <i>Evidenca: 12.3. PANAIRI I PUNES.pdf</i> <i>Evidenca: https://uet.edu.al/en/programi-500/</i> RVB Vizita IAL</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni demonstroi një përfshirje të dokumentuar të studentëve dhe aktorëve të tregut të punës në procesin e hartimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Përmes mekanizmave si Këshilli i Studentëve, rrjetet Alumni, konsultimet me Bordin e Tregut të Punës dhe bashkëpunime të institucionalizuara si Programi 500+ dhe Panairi i Punës, UET siguron që programet të</i></p>



	<i>reflektojnë zhvillimet aktuale dhe të jenë në përputhje me kërkesat reale të tregut. Megjithatë ka mungesë dokumentacioni i cili vërteton impaktin e drejtpërdrejtë të këtyre mekanizmave mbi programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, përcakton objektiva të qarta lidhur me zhvillimin profesional të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit, veçanërisht për aplikimin praktik të dijes në sektorin publik dhe privat. Edhe pse theksi i programit qëndron më shumë te formimi profesional sesa kërkimi shkencor, dokumente si Statuti i UET dhe RVB tregojnë se objektivat e programit janë në përputhje me qëllimet e përgjithshme të institucionit për të nxitur zhvillimin dhe përhapjen e njohurive nëpërmjet angazhimit të stafit dhe studentëve në projekte, trajnime dhe angazhime të drejtpërdrejta me tregun e punës.</p> <p>Në mënyrë të tërthortë, lidhja me kërkimin shkencor pasqyrohet në përfshirjen e literaturës të përditësuar, në synimin për të zhvilluar kompetenca analitike dhe në mbështetjen e ideve për publikime dhe prezantime, siç përmendet në Rregulloren e programit.</p> <p><i>GVJ konstaton se mungojnë dokumente të posaçme që të përcaktojnë drejtime kërkimore të qarta brenda programit apo projektet shkencore të lidhura drejtpërdrejt me të.</i></p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.pdf</i> RVB</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, ky kriter mbështetet në disa elemente të funksionimit të Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, i cili jo vetëm që organizon dhe administron procesin mësimor, por edhe mbështet veprimtarinë kërkimore në përputhje me fushën e studimit dhe duke respektuar

<p>respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>lirinë akademike të stafit, “Statuti UET, Neni 14.2, Neni 15.2, Neni 15.2.1”.</p> <p>Gjatë takimeve u nënvizua se personeli akademik ka liri të plotë në zgjedhjen e metodave të mësimdhënies dhe të kërkimit, si dhe në përfshirjen në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Liria akademike është gjithashtu e garantuar në përputhje me Statutin e UET, Neni 7.3.</p> <p>Departamenti zhvillon dhe bashkërendon veprimtari të rregullta për mbështetjen e kërkimit shkencor, përmes angazhimit në publikime, pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe projekte të financuara. Gjithashtu, evidenca të tjera tregojnë për përfshirjen e stafit në botime, projekte bashkëpunimi me industrinë dhe trajnime që i shërbejnë jo vetëm zhvillimit profesional, por edhe përditësimit të përmbajtjes së lëndëve në përputhje me zhvillimet teknologjike.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 28.8. Lista e projekteve stafi nga Departamenti i përfshirë në to.pdf</i> <i>Evidenca 43. Të dhëna mbi kerkimin shkencor të stafit – Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, ofron një bazë të përshtatshme që mundëson dhe nxit angazhimin e studentëve në projekte me natyrë praktike dhe kërkimore, edhe pse, për shkak të vetë natyrës së programit profesional, theksi është më shumë në zbatimin e njohurive sesa në kërkimin akademik të mirëfilltë.</p> <p>Referuar “DSSH Junior 2021-2024”, studentët e programeve të nivelit të dytë mund të paraqitin punimet e tyre në një forum i cili zhvillohet çdo vit nga UET. Sipas RVB, punimet e përzgjedhura si më të mirat botohen në revistën shkencore të njësisë kryesore “Ingenious”. Studentët e ciklit të dytë gjithashtu angazhohen në tema praktike në kuadër të tezës së diplomimit. Këto tema kanë shpesh një karakter kërkimor-aplikativ dhe trajtojnë problematika të lidhura me teknologjinë e informacionit, që lidhen ngushtë me sektorin privat dhe me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu, përmes bashkëpunimeve të institucionalizuara si Programi 500+ dhe Panairi i Punës, studentët përfshihen në aktivitete që synojnë aplikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të tyre, përmes praktikave profesionale, projekteve të përbashkëta me kompanitë partnere dhe përmes kontaktit me</p>

	<p>ekspertë të fushës. Këto mekanizma krijojnë hapësira ku studentët mund të përfitojnë jo vetëm përvojë praktike, por edhe të zhvillojnë aftësi kërkimore në fushën e IT-së dhe zgjidhjes së problemeve reale.</p> <p>GVJ konstaton se: Pavarsisht këtyre studentët e këtij programi nuk janë pjesëmarrës në këto aktivitete. Për të siguruar përfshirjen aktive të studentëve të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, në aktivitete kërkimore dhe projekte praktike, GVJ rekomandon se institucioni duhet të ndërmarrë hapa konkretë, si: Integrimi i kërkimit praktik në kurrikulë, Mbështetje me mentorim dhe trajnime shtesë, etj.</p> <p><i>Evidenca 12.3. PANAIRI I PUNES.pdf</i> <i>Evidenca 55.1.. DSSH Junior 2021-2024.pdf</i> Evidenca: https://uet.edu.al/en/programi-500/ RVB Vizita IAL</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin financiar të vënë në dispozicion, rezulton se institucioni i arsimit të lartë UET siguron një mbështetje të strukturuar dhe të qëndrueshme financiare për aktivitetet akademike dhe kërkimore të njësisë bazë. Kjo mbështetje konfirmohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasqyrave të auditimit të pavarur për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023, të cilat tregojnë menaxhim financiar të rregullt dhe performancë pozitive. Këto raporte evidentojnë që “European Education Initiative sh.p.k.”, entiteti ligjor që mbulon UET, operon me transparencë dhe siguri financiare, duke krijuar kushtet për të investuar në zhvillimin akademik dhe kërkimor. - Dokumenti “Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)” paraqet të ardhura nga veprimtari të ndryshme të lidhura me mësimdhënien, projektet, trajnimet, bashkëpunimet me sektorin privat dhe fondet e mbledhura përmes aktiviteteve të jashtme. Këto të ardhura menaxhohen nga institucionet përkatëse brenda UET për të mbështetur projektet akademike dhe kërkimore, në funksion të misionit institucional dhe zhvillimit profesional të stafit dhe studentëve. - Për më tepër, ekzistojnë projekte dhe nisma si Programi 500+ dhe Panairi i Punës, të cilat jo vetëm që forcojnë lidhjen me tregun e punës, por krijojnë edhe mundësi të reja

	<p>për financim dhe bashkëpunim në projekte me natyrë kërkimore-aplikuese.</p> <p>Ashtu sic përmendet edhe në RVB, aktiviteti shkencor financohet nga një sistem i dyfishtë: burimet e brendshme dhe financimet nga jashtë.</p> <p><i>Evidenca 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 50.1. Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 50.2. Pasqyrat Financiare 2021 me shënime.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 50.3. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 50.4 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, garanton një nivel të kënaqshëm orientimi në fushën e kërkimit dhe zhvillimit profesional, duke reflektuar objektivat e institucionit për përfshirjen e stafit dhe studentëve në aktivitete me natyrë praktike dhe kërkimore. Edhe pse programi fokusohet kryesisht në formimin profesional, ekzistojnë mekanizma dhe struktura që nxisin përfshirjen në projekte, publikime dhe bashkëpunime me sektorin privat. Departamenti respekton lirinë akademike dhe mbështet kërkimin përmes burimeve të brendshme dhe fondeve të jashtme, ndërkohë që për studentët krijohen mundësi për angazhim praktik dhe kërkimor, megjithëse kërkohet rritje e pjesëmarrjes së tyre. Në tërësi, standardi vlerësohet si i përmbushur në mënyrë funksionale dhe me potencial për përmirësim të mëtejshëm.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të	Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, nuk ka struktura të dedikuara për kërkimin shkencor në kuptimin tradicional akademik, por institucioni dhe njësia bazë kanë ndërmarrë disa hapa për të mbështetur nisma kërkimore dhe për të forcuar bashkëpunimet me struktura të tjera kërkimore apo profesionale.



<p>programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>“Strategjia e Kërkimit Shkencor 2021-2025”, përcakton objektiva që synojnë zhvillimin e kërkimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional. Ajo përmend qartë mbështetjen për grupet kërkimore dhe bashkëpunimin me qendra dhe rrjete kërkimore, kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>“Lista e projekteve” ku është përfshirë stafi akademik i Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, përfshin projekte me karakter shkencor dhe bashkëpunues me sektorin privat, të cilat mundësojnë integrimin e stafit në veprimtari që ndikojnë edhe në përmbajtjen e programeve të studimit.</p> <p>“Të dhënat mbi kërkimin shkencor të stafit” tregojnë për pjesëmarrje në publikime, konferenca dhe projekte që lidhen me teknologjinë dhe informatikën e aplikuar.</p> <p>Përmes Projekteve si: Programi 500+ dhe Panairi i Punës, UET krijon mundësi për bashkëpunim me kompani dhe aktorë të sektorit privat, duke nxitur bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve praktike që kanë komponent kërkimor-aplikativ.</p> <p>Bazuar në pasqyrat financiare për vitet akademike 2020-2023, gjendet informacion mbi mbështetjen që bën institucioni mbi aktivitete të ndryshme studimore dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Strategjia për kërkimin shkencor dhe funksionimi i strukturave institucionale mbështesin koordinimin e aktiviteteve kërkimore në kuadër të objektivave të përgjithshme të institucionit. Këto evidenca tregojnë se, megjithëse programi është me natyrë profesionale, ekziston një orientim institucional për të mbështetur aktivitetin kërkimor dhe për të përfshirë departamentin dhe programin në nisma që kontribuojnë në zhvillimin e kërkimit dhe bashkëpunimeve me struktura të tjera kërkimore.</p> <p><i>Evidenca 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidenca 28.8. Lista e projekteve stafi nga Departamenti i përfshirë në to.pdf</i> <i>Evidenca 43. Të dhëna mbi kerkimin shkencor të stafit - Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> <i>Evidenca : https://uet.edu.al/en/programi-500/</i> <i>Evidenca 12.3. PANAIRI I PUNES.pdf</i> <i>Evidenca 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).pdf</i> <i>Evidenca 50.4 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, tregon përpjekje të</p>

<p>përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>qëndrueshme për të përfshirë personelin akademik dhe studentët në analiza dhe projekte me natyrë kërkimore (“DSSH Junior 2021-2024”). Personeli akademik është i angazhuar në projekte të financuara, bashkëpunime me industrinë dhe publikime që trajtojnë tema të lidhura ngushtë me praktikën dhe zhvillimet teknologjike (“Lista e projekteve” dhe “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit”). Këto iniciativa ofrojnë jo vetëm zhvillim profesional për stafin, por edhe një bazë reale për përfshirjen e studentëve në projekte me komponent kërkimor-aplikativ.</p> <p>Gjithashtu, nga analiza e dokumenteve, RVB dhe gjatë vizitës në IAL, konstatohet se drejtuesit e njësisë bazë dhe të strukturave të tjera institucionale (si Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit) inkurajojnë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe studimore, përmes forumit vjetor DSSH Junior, angazhimit në temat e diplomës me karakter praktik dhe bashkëpunimeve me kompani partnere (“Panairi i Punës”, “programi-500+” etj). GVJ konstaton se: aktualisht përfshirja e studentëve në këto iniciativa është pjesërisht e kufizuar, megjithse ekzistojnë mekanizma dhe praktika të cilat mund të përforcohen dhe institucionalizohen më tej.</p> <p><i>Evidenca 55.1. DSSH Junior 2021-2024.pdf</i> <i>Evidenca 28.8. Lista e projekteve stafi nga Departamenti i përfshirë në to.pdf</i> <i>Evidenca 43. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit - Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> <i>Evidenca 12.3. PANAIRI I PUNES.pdf</i> <i>Evidenca: https://uet.edu.al/en/programi-500/</i> RVB Vizita IAL</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Në kuadër të programit njësia përgjegjëse ka ndërmarrë hapa për të organizuar aktivitete të rregullta që kontribuojnë në formimin profesional dhe kërkimor të studentëve dhe personelit akademik. Aktiviteti më domethënës në këtë drejtim është forumi shkencor “DSSH Junior 2021-2024”, i cili organizohet çdo vit nga njësia kryesore dhe shërben si një platformë për prezantimin e punimeve kërkimore të studentëve dhe stafit. Studentët e ciklit të dytë ftohen të dorëzojnë punime që shqyrtohen nga një komision dhe ato më të mirat përzgjidhen për botim në revistën “Ingenious”. Kjo iniciativë shërben si motivim për studentët dhe si një mënyrë për të ndërlidhur procesin e mësimdhënies me kërkimin shkencor, duke i dhënë vlerë praktike dhe akademike angazhimit të tyre. Pavarësisht kësaj ashtu</p>



	<p>siç u theksua edhe gjatë vizitës në IAL, studentët e këtij programi studimi nuk janë pjesëmarrës në këtë forum me punimet e tyre.</p> <p>Në të njëjtën linjë, përmes Panairit të Punës dhe Programit 500+, institucioni organizon evente që, edhe pse kryesisht të fokusuara në praktika dhe punësim, përfshijnë komponentë informues dhe prezantues për risitë dhe zhvillimet në fushën e IT-së, të cilat kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të programit. Këto aktivitete krijojnë ura të rëndësishme ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat, duke i ekspozuar studentët dhe stafin ndaj praktikave aktuale në treg.</p> <p><i>Evidenca 55.1. DSSH Junior 2021-2024.pdf</i> <i>Evidenca 12.3. PANAIRI I PUNES.pdf</i> Evidenca: https://uet.edu.al/en/programi-500/ Evidenca: https://uet.edu.al/ingenious/?_gl=1%2A1wmyx6g%2A_ga%2AMTgxNDgxMjc1OC4xNzUwNTkyNTM4%2A_ga_KK6Y9EP7PC%2A_czE3NTA3Mzg2MzMkbzYkZzEkdDE3NTA3Mzg3NzAkajE2JGwwJGgw%2A_ga_68DG2WV7O2%2AczE3NTA3Mzg2MzOkbzUkZzEkdDE3NTA3Mzg3NzAkajE2JGwwJGgw&_ga=2.65728870.915741250.1750592539-1814812758.1750592538 RVB Vizita IAL</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Në bazë të të dhënave të paraqitura në dokumentin “Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Tabela 21)”, vërehet një tendencë në rënie e numrit të studentëve të regjistruar në programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, duke kaluar nga 34 studentë në vitin 2019–2020, në 4 studentë në vitin 2024–2025. Kjo prire rënëse reflekton preferencat në rritje të studentëve drejt programeve të Masterit Shkencor, gjë që u theksua edhe gjatë takimeve.</p> <p>Megjithatë, programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, plotëson një nevojë specifike të tregut të punës për profesionistë të kualifikuar, që përfitojnë njohuri të specializuara dhe aftësi praktike të menjëhershme të aplikueshme në sektorin publik dhe privat. Kjo përputhje me kërkesat e tregut është mbështetur edhe nga kontributi i Bordit të Tregut të Punës, të cilët kanë dhënë sugjerime për përmbajtjen e moduleve dhe kanë ndihmuar në përshtatjen e tyre me zhvillimet teknologjike dhe nevojat konkrete të industrisë (Evidenca 17: Studimi për Tregun e Punës).</p>

	<p>Në këtë kontekst, edhe pse rënia e regjistrimeve mund të ngrëjë shqetësime për atraktivitetin afatgjatë të programit, struktura dhe orientimi i tij mbetet i justifikuar dhe i nevojshëm për një pjesë të synuar të tregut të punës. Përmirësimi i mekanizmave të promovimit, qartësimi i vlerës së shtuar të programit në raport me nevojat konkrete të sektorëve të teknologjisë së informacionit, si dhe mbështetja institucionale për orientimin e studentëve në fazën pasuniversitare, mund të ndihmojnë në rritjen e atraktivitetit dhe frekuentimit të këtij programi në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Tabela 21).pdf</i> <i>Evidenca 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Referuar RVB ky kriter është cilësuar si N/A dhe GVJ nuk disponon dokumenta për të vërtetuar ndryshe.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Referuar RVB ky kriter është cilësuar si N/A dhe GVJ nuk disponon dokumenta për të vërtetuar ndryshe.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, përpiket të garantojë njohuri të thelluara dhe të lidhet me komponentët e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit, ndonëse me kufizime për shkak të vetë natyrës profesionale të programit. Institucioni dhe njësia bazë kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë forcimin e aktivitetit kërkimor dhe bashkëpunimit me sektorin privat dhe struktura të tjera kërkimore, si dhe ofrojnë mundësi për</i></p>

	<i>angazhimin e studentëve në projekte aplikative. Gjithashtu, organizohen aktivitete që kontribuojnë në arritjen e objektivave të programit, megjithëse përfshirja e drejtpërdrejtë e studentëve në to mbetet ende e kufizuar. Programi është konceptuar për të përgatitur profesionistë të orientuar drejt praktikës dhe të aftë për të operuar në tregun kombëtar e ndërkombëtar të punës, edhe pse sfidat lidhur me numrin e ulët të regjistrimeve kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme në promovim dhe përshtatje të mëtejshme të strukturës së tij me kërkesat e kohës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet t pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion, rezulton se procesi mësimor në programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, zhvillohet përmes një kombinimi të formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përfshirë leksionet, seminarët, format leksion/seminar, detyrat praktike dhe të kursit, si dhe praktikat profesionale dhe punimin e diplomës apo provimin përfundimtar. Syllabusët tregojnë se vlerësimi i njohurive nuk kufizohet vetëm te provimi final, por realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë semestrit, duke krijuar mundësi që studentët të identifikojnë dhe të adresojnë mangësitë e tyre përpara përfundimit të periudhës mësimore. Gjithashtu, institucioni organizon leksione të hapura me

	<p>pjesëmarrjen e ekspertëve nga fusha e teknologjisë së informacionit dhe përfaqësues të kompanive partnere, të cilat kontribuojnë në pasurimin e përvojës akademike dhe profesionale të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i> <i>Evidenca: https://uet.edu.al/?s=leksion+i+hapur</i> RVB Vizita në IAL</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion, rezulton se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, ofron një kombinim të formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë: leksione, ushtrime praktike në klasë, prezantime nga studentët, projekte individuale dhe në grup, raste studimi, zgjidhje problemesh, puna laboratorike, mësim i orientuar drejt problemit, konsultime. Këto forma pasqyrohen qartë në syllabus-et e lëndëve, ku përveç provimit final, vlerësimi është i shpërndarë gjatë gjithë semestrit, duke krijuar mundësi për ndjekje të vazhdueshme të progresit të studentëve.</p> <p>Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, në seancën e takimit me studentët nuk kishte pjesëmarrje fizike nga asnjëri prej tyre; GVJ pati mundësi të lidhej vetëm online me një studente, e cila gjithsesi shprehu kënaqësi për cilësinë e mësimdhënies. Kjo sugjeron një angazhim të dobët të drejtpërdrejtë të studentëve në aktivitetet institucionale, edhe pse format e mësimdhënies të përdorura në program duket se përmbushin kërkesat akademike dhe mbështesin të nxënit aktiv.</p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i> RVB Vizita IAL</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Sipas RVB, sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion lidhet ngushtë me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik, përmes trajnimeve të strukturuar në përputhje me nivelin dhe gradën shkencore të secilit pedagog. Institucioni synon program trajnimi të strukturuar për stafin akademik, ku tentohet jo vetëm përmirësimi i kompetencave të kërkimit, por edhe përforcimin e aftësive didaktike dhe pedagogjike.</p>

	<p>Institucioni ofron certifikime të rregullta në fusha si: mësimdhënia, kërkimi shkencor, drejtimi i grupeve kërkimore dhe menaxhimi akademik, të cilat janë të detyrueshme për pozicionet përkatëse (“Lista e trajnimeve profesionale”).</p> <p>Për më tepër, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se infrastruktura mbështetëse (sallat e leksioneve, biblioteka, pajisjet IT) është në përputhje me standardet moderne të mësimdhënies dhe mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibël pedagogjike, të përshtatshme për objektivat e programit dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu, institucioni në mënyre periodike bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe të ftuar, i cili vlerësohet nga autoriteti drejtues dhe nga studentët. Raportet e performancës ndihmojnë në identifikimin e fushave për përmirësim dhe në zhvillimin profesional të mëtejshëm të stafit si dhe vlen si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit. Raporte të kësaj natyre janë venë në dispozicion për GVJ.</p> <p><i>Evidenca 33. Lista e trajnimeve profesionale .pdf</i> <i>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik - 2022.pdf</i> <i>Evidenca 30.16. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.pdf</i> RVB Vizita në IAL</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të fushës. Kjo mbështetet në CV-të e anëtarëve të stafit, të cilët kanë tituj akademikë dhe grada shkencore, si dhe përvojë të konsiderueshme në sektorin privat dhe në projekte të aplikuara në fushën e teknologjisë së informacionit. Ky kombinim i formimit akademik me përvojën praktike u jep atyre kapacitete të plota për të shpjeguar koncepte komplekse në mënyrë të kuptueshme dhe të aplikueshme.</p> <p>Përveç kësaj, syllabus-et e lëndëve tregojnë përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënieje, përfshirë: diskutime interaktive në grup, zgjidhje të rasteve studimore, punë në projekt dhe prezantime, të cilat nxisin mendimin kritik, kreativitetin dhe</p>

	<p>përgjegjshmërinë individuale të studentëve. Këto metoda janë në përputhje me filozofinë e mësimdhënies me studentin në qendër dhe ndihmojnë në ndërtimin e autonomisë në të nxënë.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në IAL, GVJ u informua për mbështetjen e vazhdueshme që stafi i jep studentëve nëpërmjet udhëheqjes në detyrat e kursit, projektet praktike dhe tezën e diplomës, si dhe për ndërtimin e një mjedisi respekti dhe bashkëpunimi të ndërsjellë midis stafit dhe studentëve. Edhe pse në takimin me studentët mori pjesë vetëm një studente në mënyrë online, ajo dha feedback pozitiv për cilësinë e mësimdhënies dhe qasjen mbështetëse të stafit akademik.</p> <p><i>Evidenca 20. CV e stafit akademik te programit.pdf</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i> RVB Vizita në IAL</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, angazhohet në vlerësimin dhe përmirësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies. Kjo arrihet përmes një sistemi të institucionalizuar që përfshin vlerësimin e performancës së stafit akademik nga studentët, mekanizëm i cili është pjesë e kompetencave të departamenteve, dekanëve dhe njësive menaxhuese (<i>Statuti UET, Neni 11</i>).</p> <p>Informacionet e mbledhura gjatë vizitës në IAL konfirmojnë se feedback-u i studentëve ka pasur ndikim konkret, deri në vendimmarrjen për vazhdimësinë e angazhimit të stafit në mësimdhënie. Ky fakt tregon se procesi i vlerësimit nuk është formal, por përdoret në mënyrë aktive për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu, studentët kanë mundësinë të japin sugjerime për përmirësimin e kurrikulës dhe përfshihen në strukturat përfaqësuese të institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke krijuar një sistem të dyanshëm komunikimi dhe reflektimi.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale_shqip.pdf</i> RVB Vizita në IAL</p>

Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.

Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstatohet se në UET funksionon Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), një strukturë institucionale e përhershme dhe funksionale, me rol qendror në monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të kurrikulave akademike. Ky komision, i ngritur me vendim të Senatit Akademik (*Evidenca 30.4*), ka një metodologji të qartë veprimi dhe ushtron vlerësim periodik të proceseve mësimore dhe vlerësimeve përmes raportimeve të strukturuar mbi provimet (*Evidenca 30.5, 30.6*), syllabuset (*Evidenca 30.9, 30.12*), dhe fokus-grupet me studentët (*Evidenca 30.13, 30.15*).

Gjatë vizitës në IAL, GVJ vërejtë se përfaqësues të njësisë bazë (Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë) janë aktivë në përmirësimin e metodave të mësimdhënies, duke zbatuar teknika bashkëkohore dhe duke përfshirë komponentë praktike, interaktive dhe me bazë diskutimi në procesin mësimor. Kjo përforcohet nga përmbajtja e syllabus-eve, të cilat përmbajnë qartë referenca për metoda të ndryshme didaktike si: zgjidhja e rasteve, puna në grup, projektet praktike dhe prezantimet me gojë. Referuar RVB dhe dokumentit “Lista e trajnimeve profesionale”, në kuadër të zhvillimit profesional të stafit akademik, institucioni ka ndërmarrë një sërë trajnimesh të vazhdueshme. Këto përfshijnë tematika të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor, drejtimin akademik dhe menaxhimin institucional. Trajnimet zhvillohen në formate të ndryshme, duke përfshirë edhe aktivitetet vjetore si “Staff Development Day” apo “Back to Work”, të cilat promovojnë përditësimin e njohurive dhe ndarjen e praktikave të mira ndërmjet stafit.

Bazuar në këtë kuadër institucional dhe aktivitetet përkatëse, GVJ vlerëson se struktura të tilla si KSBC, bashkë me ndërhyrjet dhe përfshirjen e vazhdueshme të autoriteteve drejtuese dhe akademike, përbëjnë një sistem funksional që mbështet përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit.

Evidencat: 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf
Evidenca 30.5. Metodologjia e punës së KSBC Provimet.pdf
Evidenca 30.6. Format raporti për kontrollin e provimeve.pdf
Evidenca 30.9. Metodologjia e punës së KSBC Silabuset.pdf
Evidenca 30.12. Shembull Relacioni i KSBC mbi silabuset DIT FIIA.pdf

	<p><i>Evidenca 30.13. Metodologjia e punës së KSBC Fokus Grup.pdf</i> <i>Evidenca 30.15. Shpërndarja e raportit dhe ekstrakti i raportit i fokus grupeve.pdf</i> <i>Evidenca 33. Lista e trajnimeve profesionale .pdf</i> RVB Vizita IAL</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, në UET përmbush në mënyrë të kënaqshme kërkesat për ofrimin e një procesi të mirëstrukturuar të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me në qendër studentin. Institucioni aplikon një gamë të gjerë metodash didaktike të kombinuara me vlerësim të vazhdueshëm, mbështet zhvillimin profesional të stafit akademik përmes trajnimeve të rregullta dhe promovon një kulturë të reflektimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm përmes strukturave të dedikuara si KSBC. Pavarësisht disa mangësive në angazhimin aktiv të studentëve në aktivitete institucionale, evidencat tregojnë se instituti ofron një mjedis akademik të përshtatshëm dhe fleksibël që mbështet aftësimin profesional dhe përmbushjen e objektivave të programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, konstatohet se kriteret dhe mënyrat e vlerësimit për programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, janë të përcaktuara në mënyrë të qartë. Ato përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura paraprakisht studentëve.</p> <p>1. Rregullore UET, Kreu V shpreh se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi bëhet me pikë nga 0–100, të cilat konvertohen në nota nga 4–10 dhe me germa nga F në A. Nota kaluese është nga 5 deri në 10 përkatësisht nga E në A (Neni 23) - Vlerësimi bazohet në kontroll të vazhdueshëm ku: <ul style="list-style-type: none"> • Tipologjia I: 40% provimi final, 60% dy detyra praktike.

	<ul style="list-style-type: none"> • Tipologjia II: 40% provimi final, 30% provim ndërmjetës, 20% detyrë kursi, 10% pjesëmarrje në seminare. <i>Neni 24</i> <p>2. Rregullore e programit të studimit MP në 'Informatikë e Aplikuar' me profile, pika 5, shpreh se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format dhe kriteret e vlerësimit përcaktohen në programin e lëndës dhe u komunikohen studentëve paraprakisht. Vlerësimi mund të bëhet me provim, ese, projekte apo forma të tjera. Nota jepet në pikë (0–100) dhe kthehet në notë numerike (4–10) dhe germa (F–A). <i>(Pika 5.1)</i> - Vlerësimi bazohet në kontroll të vazhdueshëm dhe përfshin: 30% provim ndërmjetës, 10% diskutim, 20% detyrë kursi ose dy detyra praktike, 40% provim final. <i>(Pika 5.2)</i> <p>3. Gjithashtu, syllabuset e çdo lënde specifikojnë qartë format dhe peshat përkatëse të vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar, duke e bërë procesin transparent për studentët. Në çdo syllabus është përcaktuar forma e vlerësimit: 30% provim ndërmjetës, 10% diskutim, 20% detyrë kursi ose dy detyra praktike, 40% provim final.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) monitoron përputhshmërinë midis përmbajtjes së silabuseve dhe rregullave institucionale për vlerësimin, siç dokumentohet në raportet e KSBC mbi syllabus-et.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i> <i>Evidenca 30.12. Shembull Relacioni i KSBC mbi silabuset DIT FIIA.pdf</i> <i>Vizita IAL</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në informacionet e përfshira në Rregulloren e Programit të Studimit, kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve përcaktohen qartë në syllabuset e lëndëve, të cilat u shpërndahen studentëve në fillim të çdo semestri. Këto syllabuset e përfshijnë metodologjinë e kontrollit dhe përbërësit e vlerësimit, si provimet, detyrat praktike, detyrat e kursit, diskutimet dhe projekte të ndryshme.</p>

<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas RVB-së, studentët njihen që në fillim të semestrit me të gjitha komponentët vlerësues dhe afatet përkatëse për realizimin e tyre. Përveç komunikimit gjatë orëve të para të mësimit nga titullari i lëndës, ky informacion vendoset edhe në platformën LMS, si dhe njoftohet me email nga koordinatorja e departamentit.</p> <p>Gjithashtu, “Rregullore e programit të studimit MP në Informatikë e Aplikuar” me profile, në pikat 3.1.2 dhe 3.1.4 përforcon këtë praktikë, duke përcaktuar se syllabus-et (programet e lëndëve) vihen në dispozicion të studentëve në fillim të çdo semestri, ruhen në bibliotekë dhe mund të publikohen edhe në formë broshure.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në dokumentin e RVB, shprehet që vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxiti studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit; - Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim; - Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. <p>Në Rregulloren e UET parashikohen forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive, me qëllim që pedagogu të mund të zgjedhë atë që i përshtatet më mirë natyrës së lëndës dhe evidenton më mirë rezultatet e synuara të të nxëniet, të ndara këto sipas tipologjive të lëndëve. Për lëndët e Tipologjisë I janë 2 forma vlerësimi, kurse për lëndët e Tipologjisë II janë 4 forma të ndryshme vlerësimi. Sipas pikës 16.5, lëndët ndahen në 2 tipologji: a. Lëndë të Tipologjisë I konsiderohen lëndët me karakter kryesisht praktik/aplikativ. b. Lëndë të Tipologjisë II konsiderohen lëndët me karakter kryesisht teorik. Kjo ndarje mendojmë që i jep mundësinë studentit që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>


63

	<i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> RVB Vizita IAL			
Konkluzione	GVJ e vlerëson standartin të plotësuar, pasi institucioni ka miratuar dhe zbaton rregullore të qarta dhe procedura të strukturuar për testimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Këto rregulla janë të dokumentuara në rregulloren institucionale dhe atë të programit të studimit, përfshihen në syllabus-et e lëndëve dhe i komunikohen studentëve në fillim të çdo semestri. Vlerësimi është i diferencuar sipas tipologjisë së lëndës dhe realizohet në formë të ndryshme, që përfshijnë kontroll të vazhdueshëm dhe komponentë të shumtë vlerësimi, duke krijuar mundësi për një matje më gjithëpërfshirëse dhe objektive të kompetencave të fituara nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në informacionin e përfshirë në syllabus-et e lëndëve dhe në përmbajtjen e “Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar” me profile, vlerësimi i studentëve bazohet në disa komponentë të shpërndarë gjatë gjithë semestrit. Këto përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - provimin e ndërmjetëm (i planifikuar zakonisht në javën e 7-të ose të 8-të) - angazhimin në diskutimet javore në seminare - realizimin e detyrave të kursit apo ushtrimeve praktike - si dhe provimin përfundimtar. <p>Kjo strukturë vlerësimi, e shtrirë në kohë dhe e kombinuar me formë të ndryshme, përbën për GVJ një tregues të rëndësishëm të angazhimit të vazhdueshëm dhe të ndjekjes së progresit të studentëve gjatë gjithë periudhës mësimore.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p>

	<i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Referuar RVB-së dhe të dhënave të mbledhura gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka ndërmarrë një sërë masash për të rritur transparencën dhe integritetin në procesin e vlerësimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, institucioni bashkëpunon me AADF (Albanian-American Development Foundation) për promovimin dhe implementimin e një sistemi të ri elektronik të vlerësimit - "Clean Score", i cili tashmë është aplikuar në disa lëndë në programet e nivelit Bachelor dhe Master. - Së dyti, për të parandaluar rastet e plagjiaturës, përdoret sistemi Turnitin, i cili është i integruar në procesin e dorëzimit dhe kontrollit të detyrave. - Së fundi, për të garantuar paanësi gjatë vlerësimit të provimeve finale, është në fuqi një sistem anonimizimi përmes përdorimit të barkodeve, të cilat vendosen në tezat e studentëve para nisjes së provimit. Këto masa dëshmojnë për një angazhim të qëndrueshëm institucional në drejtim të zbatimit të sistemeve moderne dhe të besueshme të vlerësimit. <p><i>RVB</i> <i>Vizita IAL</i></p>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Referuar RVB dhe vizitës në IAL, theksohet se mënyra e vlerësimit është e paraqitur në syllabusin e secilës prej lëndëve të programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile dhe se vlerësimi bëhet në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatore të Fakultetit të Informatikës.</p> <p><i>RVB</i> <i>Vizita IAL</i></p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Institucioni ka të përcaktuara qartë procedura për mënyrën e vlerësimit dhe dhënien e feedback-ut, në funksion të ndihmës dhe përmirësimit të studentit. Rregullorja e UET, neni 27 pika 8, përcakton se "Vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve". Gjithashtu, në rast kërkesë nga studenti, pedagogu ka detyrimin të japë shpjegime mbi mënyrën e vlerësimit dhe të ofrojë koment/feedback për përmirësim.</p>

	<p>Sipas pikës 5.3.4 të Rregullores së programit të studimit MP në “Informatikë e Aplikuar” me profile, Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit dhe firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Kjo procedurë ndihmon në rritjen e objektivitetit dhe besueshmërisë në procesin e vlerësimit.</p> <p>Formati i tezës së provimit përfundimtar përmban në fund një seksion të veçantë për komentet e pedagogut mbi përgjigjet e studentit, si dhe tabelën e detajuar të vlerësimit për çdo pyetje, duke siguruar transparencë dhe qartësi në përbërjen e notës përfundimtare.</p> <p>Për më tepër, në rastet kur studentët kanë paqartësi apo ankesa lidhur me vlerësimin, institucioni ndjek një procedurë të miratuar për shqyrtimin e ankesave, duke ngritur një komision me 3 anëtarë, i cili merr vendim me shumicë të thjeshtë pas shqyrtimit të provimit. Sipas RVB, çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të caktuar nga përgjegjësi i departamentit, çka përforcon seriozitetin dhe integritetin e procesit të vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 7.4. Formatit i tezës së provimit përfundimtar.pdf</i> RVB Vizita në IAL</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Rregullore e UET, Neni 33 Plagjiatura dhe kopjimi, pikat 33.1 - 33.3) GVJ konstaton që IAL ka të rregulluar rastet e evidentuara të plagjiaturës së esseve dhe diplomave, apo kopjimit në detyra. Kështu, plagjiatura e provuar në paraqitjen e esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese. Kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit dhe studentit vlerësohet me notën 4 (katër). Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studentit paralajmërohet për përjashtim nga Universiteti.</p>



	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar ne RVB, GVJ u njoh dhe me programin Turnitin, të cilin IAL e ka vënë në dispozicion të gjithë stafit akademik dhe drejtues, për kontrollet e plagjiaturës.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> RVB Vizita në IAL</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas Rregullores së UET, <i>Neni 27, pika 4</i>, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, e cila ruan anonimatit e studentit deri në korrigjimin e tezave nga pedagogu i lëndës. Kjo përcaktohet edhe në rregulloren e programit, <i>pika 5.3.3</i>, ku thuhet se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Më tej, sipas dokumentit “Rregullore e Programit Master”, <i>pika 5.3.5</i>, dhe dokumentit “Rregullore UET”, <i>Neni 27, pika 9</i>, thuhet se dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese.</p> <p>Sipas RVB, vlerësimi për komponentët e tjerë të lëndës duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. Jo vetëm provimi përfundimtar, por edhe detyra e kursit apo esse-ja përbëjnë komponentë të vlerësimit të lëndës, të cilat gjithashtu rregullohen në dokumentin “Rregullore e Programit Master”, <i>pika 5.6</i>.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Përmbushja e Kriterit 7 vërtetohet nëpërmjet një kuadri të qartë rregullator dhe praktikash institucionale që garantojnë të drejtat e studentëve për t’u njohur me rezultatet e vlerësimit dhe për të kërkuar rivlerësim nëse vlerësimi konsiderohet i padrejtë. Sipas Rregullores së UET, <i>Neni 32</i>, studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të pikëve të marra në ndonjë prej komponentëve të vlerësimit, pas konsumimit të procedurës sqaruese me pedagogun. Në këtë rast, Përgjegjësi i Departamentit (ose Dekani, nëse pedagogu është vetë përgjegjësi) ngre një komision me 3 anëtarë, i cili shqyrton ankesën dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë.</p>



	<p>Ky vlerësim është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar.</p> <p>Po ashtu, sipas Rregullores së Programit Master, <i>pikat 5.7.1 dhe 5.7.2</i>, përcaktohet se studenti mund të parashtojë kërkesë me shkrim për rivlerësim për çdo komponent të vlerësimit (provim ndërmjetës, detyrë kursi, provim final), dhe komisioni i ngritur shqyrton kërkesën dhe merr vendim përfundimtar.</p> <p>Sipas RVB-së, studentët informohen në kohë reale për rezultatet e tyre përmes sistemit elektronik, ndërsa për seancat sqaruese dhe procedurat e mëtejshme marrin njoftime nga koordinatori dhe programi. Ky sistem garanton transparencë, të drejtë ankese dhe trajtim të paanshëm të çdo kontestimi nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ, vë re se institucioni ka përcaktuar një procedurë të qartë dhe transparente për trajtimin e kërkesave dhe ankimeve nga studentët në lidhje me vlerësimet e marra. Ashtu sic u përmend edhe në kriterin më sipër, sipas <i>pikës 5.7.2</i> të Rregullores së Programit Master, nëse një student konsideron se vlerësimi i dhënë nga pedagogu nuk është korrekt, ai mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim. Pas marrjes së kërkesës, ngrihet një komision i përbërë nga tre anëtarë, i cili shqyrton ankesën dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vendimi i komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar.</p> <p>Gjithashtu, të gjitha dokumentet përkatëse të procesit – përfshirë procesverbalet e vlerësimit - firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, si dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, duke garantuar dokumentim dhe ruajtje institucionale të procedurës. Kjo praktikë siguron transparencë për palët e përfshira dhe gjurmueshmëri të plotë të çdo vendimarrjeje të marrë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> RVB</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Standardi III.3 reflekton një qasje të strukturuar dhe transparente të institucionit ndaj procesit të vlerësimit të studentëve, duke u</i></p>

	<i>mbështetur në parime të meritës, paanësisë dhe integritetit akademik. Vlerësimi kryhet gjatë gjithë vitit përmes komponentëve të shpërndarë dhe metodave të ndryshme, ndërkohë që janë zbatuar mekanizma elektronikë që rrisin transparencën dhe parandalojnë abuzimet. Institucioni ka procedura të qarta për trajtimin e ankesave dhe rivlerësimeve, të cilat dokumentohen dhe arkivohen, duke garantuar të drejtat e studentëve dhe respektimin e rregullave institucionale në çdo hap të procesit të vlerësimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, garanton zhvillimin e njohurive të avancuara dhe thellimin e kompetencave profesionale dhe aplikative të studentëve. Sipas dokumentit “Rregullore e Programit Master Profesional”, programi ka për qëllim pajisjen e studentëve me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohuri dhe koncepte themelore të fushës së informatikës dhe profileve të saj, - aftësi në funksion të profesionit dhe përgatitjes për tregun e punës, - si dhe formim qytetar të përgjithshëm dhe ndërdisiplinor. <p>Detyrat e kursit, projektet, prezantimet dhe përdorimi i literaturës në gjuhë të huaj, veçanërisht anglisht, ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe bashkëpunimit në grup. Këto elementë ndihmojnë gjithashtu në identifikimin dhe vlerësimin e kompetencave individuale të studentëve dhe përmirësimin e ndërveprimit me pedagogët.</p> <p>GVJ vlerëson se programi arrin në mënyrë të kënaqshme të integrojë komponentë që synojnë zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta shkencore, duke përmbushur kështu kërkesat e këtij kriteri.</p>



	<p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe në kompetenca të komunikimit, ndërveprimit dhe punës në grup.</p> <p>Sipas RVB-së, përmes lëndëve të programit, studentëve u ofrohen njohuri të avancuara mbi përdorimin e teknologjive dhe sistemeve të informacionit në organizata, duke u mundësuar të kuptojnë dimensionet teknike, organizative dhe menaxheriale të këtyre sistemeve.</p> <p>Gjithashtu, detyrat e kursit, projektet e realizuara në grup dhe përdorimi i literaturës ndihmëse në gjuhë të huaj (anglisht) shërbejnë si mjet për të nxitur aftësitë e komunikimit, bashkëpunimit dhe ndërveprimit, si dhe për të forcuar kapacitetet individuale të studentëve në analizë, prezantim dhe shkëmbim idesh. Këto forma të punës pedagogjike ndihmojnë edhe në vlerësimin e kompetencave të përfuara nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> <p>Programi, përmes qasjes ndërdisiplinore dhe metodave të ndryshme të mësimdhënies, kontribuon në zhvillimin e balancuar të aftësive teknologjike, humane dhe sociale, në përputhje me natyrën profesionale të tij.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i> RVB</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre,</p>	<p>Sipas RVB, pedagogu, një javë para provimit, bën përsëritje për temat e trajtuara dhe ndalet në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, duke dhënë orientimet e nevojshme për përgatitjen e studentëve në provim. Ai mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t’u përvetësuar nga studentët. Gjithashtu, në dispozicion të studentëve janë edhe konsultat përpara provimit, si dhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p> <p>Ky komunikim mes pedagogut dhe studentëve, qartësimi i detajeve të ndryshme të lëndës dhe gjithë procesi mësimor u vërtetua edhe nga vizita në institucion, ku studentët u shprehën mjaft të kënaqur.</p>

<p>si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Ky proces ndihmon gjithashtu studentët të përgatiten më mirë për detyrimet përmbyllëse të programit, duke ndërtuar mbi kompetencat e fituara në secilën lëndë.</p> <p><i>RVB</i> <i>Vizita IAL</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se, në programin Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, lëndë të caktuara zhvillohen në laboratorët e informatikës, ku studentët kanë mundësi të zbatojnë në mënyrë praktike njohuritë e fituara në leksione. Kjo realizohet sidomos në lëndët që kërkojnë aftësi të avancuara teknike dhe përdorimin e software-ve specifike (<i>Vizita IAL</i>).</p> <p>Praktika profesionale përbën një komponent të rëndësishëm të programit dhe zhvillohet në institucione partnere, në pozicione sa më pranë fushës së studimit, me synimin për të rritur aftësitë profesionale dhe për të lehtësuar integrimin në tregun e punës.</p> <p>Sipas RVB-së dhe siç u konstatua edhe gjatë vizitës në IAL, metoda si puna në grup dhe diskutimet janë praktika të zakonshme në procesin mësimor të UET. Ato ndihmojnë në përvetësimin më të thelluar të përmbajtjes teorike dhe në zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit e zgjidhjes së problemeve.</p> <p>Programi mësimor ka krijuar gjithashtu një klimë të favorshme për zhvillimin e ideve inovative, falë natyrës së tij aplikative dhe orientimit drejt zgjidhjeve praktike në fushën e teknologjisë së informacionit. Megjithëse programi nuk ka në fokus kërkimin shkencor të avancuar, IAL i adreson këto mundësi në programe të tjera, të cilat studentët mund t'i ndjekin pas përfundimit të këtij cikli studimi.</p> <p>Studentët gjithashtu inkurajohen të përfshihen në projekte mobiliteti si Erasmus+, dhe mbështeten nga institucioni për pjesëmarrje në këto projekte. Zyra e projekteve të UET ka rezultuar veçanërisht aktive dhe efikase në promovimin e këtyre mundësive, duke përforcuar ndërkombëtarizimin dhe ndërlidhjen e studentëve me tregun evropian të arsimit dhe punës.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>RVB</i> <i>Vizita IAL</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni e përmbush këtë kriter përmes një sërë mekanizmash të strukturuar që nxisin përfshirjen e personelit</p>

<p>realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>akademik në zhvillimin e orëve të hapura dhe seminareve jashtë kornizës së ngushtë të mësimdhënies. Në fillim të çdo viti akademik, miratohet dhe publikohet kalendari i aktiviteteve akademike, i cili përfshin leksione të hapura, trajnime, forume, workshope dhe aktivitete të tjera që synojnë të ekspozojnë studentët ndaj zhvillimeve më të fundit në fushat shkencore dhe teknologjike të lidhura me programin e studimit.</p> <p>Këto aktivitete realizohen nga personeli efektiv dhe me kontratë, si pjesë e angazhimit të tyre në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Aktivitetet zhvillohen jo vetëm në ambjentet e institucionit, por edhe në bashkëpunim me partnerë të jashtëm.</p> <p>Gjithashtu, në faqen zyrtare të institucionit dhe përmes platformave të komunikimit institucional publikohen në mënyrë të rregullt njoftime për leksione të hapura mbi tema bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit, si intelijenca artificiale, siguria kibernetike, zhvillimi i aplikacioneve, etj. Këto leksione, të mbajtura nga pedagogë të brendshëm ose ekspertë të ftuar, shërbejnë si burim shtesë i të nxënit dhe zhvillimit profesional të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 56. Kalendari i aktiviteteve 2022-2023.pdf</i> <i>Evidenca: https://uet.edu.al/?s=leksion+i+hapur</i> RVB Vizita IAL</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ndërmerr nisma për të nxitur zhvillimin e ideve inovative dhe të projekteve kërkimore nga studentët, edhe pse natyra profesionale e programit Master “Informatikë e Aplikuar” me profile, nuk ka si qëllim të drejtpërdrejtë zhvillimin e kërkimit shkencor të avancuar, sikurse ndodh në programet Master Shkencor ose të Doktoraturës. Megjithatë, ekzistojnë mundësi reale për studentët për t’u përfshirë në iniciativa kërkimore ose projekte me karakter inovativ.</p> <p>Sipas të dhënave të prezantuara në RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës në IAL, institucioni stimulon pjesëmarrjen e studentëve në projektet ndërkombëtare Erasmus+, të cilat shpesh përfshijnë komponentë kërkimi, shkëmbime përvoja dhe zhvillim profesional në kontekste inovative. Përveç kësaj, përmes Zyrës së Projekteve, studentët kanë akses në informacion dhe mbështetje për të qenë pjesë e aplikimeve në projektet e financuara, duke pasur mundësi të përfshihen në aktivitete që forcojnë kompetencat e tyre kërkimore dhe inovative.</p>

	<p><i>RVB</i> <i>Vizita IAL</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, përmbush në mënyrë të kënaqshme kërkesat e Standardit III.4, duke garantuar zhvillimin e njohurive të avancuara, përvetësimin e aftësive profesionale dhe përfshirjen e elementeve që mbështesin kompetenca të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe punës në grup. Aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore, përfshirja e literaturës në gjuhë të huaj, puna në laboratorë dhe praktikat profesionale dëshmojnë një qasje të orientuar drejt kompetencave. Po ashtu, përmes leksioneve të hapura, forumeve dhe mundësive për përfshirje në projekte si Erasmus+, institucioni nxit ndërveprimin me zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjisë dhe mbështet idetë inovative të studentëve, edhe pse aktivitetet kërkimore mbeten të kufizuara për shkak të natyrës profesionale të programit. Gjithsesi, GVJ sugjeron rritjen e mëtejshme të mundësive për përfshirjen aktive të studentëve të këtij programi në këto iniciativa.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se, institucioni i ka të përcaktuara qartë dhe në mënyrë të detajuar procedurat për detyrimet përmbyllëse të studentëve të programit Master Profesional, të cilat janë të dokumentuara në "Rregulloren e Programit të Studimit MP në Informatikë e Aplikuar" me profile, në "Rregulloren e UET" dhe në dokumentin "B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit". Studentët informohen që në fillim të vitit akademik mbi mënyrën e diplomimit, që mund të realizohet përmes një provimi përfundimtar ose një punimi diplome me karakter praktik, aplikativ apo konsulence.</p> <p>Në rregulloret përkatëse përshkruhen qartë format e diplomimit, procedurat për përzgjedhjen e temës dhe roli i pedagogut</p>

	<p>udhëheqës, kalendari i seancave metodologjike dhe afatet për mbrojtje, si dhe rregullat për paraqitje të përsëritur në rast të moskalimit. Rregullorja e përgjithshme e UET përfshin gjithashtu mënyrën e lëshimit dhe tërheqjes së diplomës.</p> <p>Dokumenti “B.II” përforcon më tej këto udhëzime duke specifikuar natyrën profesionale të punimit të diplomës, kërkesat për përmbajtjen, volumin në fjalë, numrin minimal të burimeve, metodologjinë empirike dhe aftësitë e transferueshme që duhet të demonstrojë studenti.</p> <p>Sipas RVB-së, vendimmarrja për formën e diplomimit bëhet nga departamenti në bazë të mesatares së ciklit të parë, në përputhje me kohëzgjatjen njëvjeçare të programit dhe karakterin e tij profesional. Kjo tregon se procedura është jo vetëm e parashikuar dhe e strukturuar, por edhe e bërë publike dhe transparente për studentët, në përputhje të plotë me kërkesën e këtij kriteri.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i></p> <p>RVB</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik në programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile asistojnë në mënyrë aktive studentët në përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse, duke vënë në dispozicion informacionet dhe materialet e nevojshme.</p> <p>Sipas RVB-së dhe Rregulloreve në dispozicion, studentët realizojnë një punim diplome në formën e një rasti studimor, krahasues ose projekti kërkimor (për studentët me mesatare mbi 7.5), ose i nënshtrohen një provimi përfundimtar, të lidhur me profilin përkatës të studimit.</p> <p>Departamenti, në këtë kuadër, ofron dokumentacion udhëzues për mënyrën e përmbushjes së detyrimeve përmbyllëse, sipas përcaktimeve në rregullore. Gjithashtu, gjatë semestrit të dytë, zhvillohen seanca metodologjike të strukturuar, të cilat synojnë të udhëzojnë dhe mbështesin studentët në hartimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës apo përgatitjen për provimin përfundimtar.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p>

	<p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i></p> <p><i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar dokumentave rregullatore dhe të dhënave të përfshira në RVB, përcaktohet se komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar ka në fokus testimin e kompetencave të fituara gjatë gjithë programit. Sipas Rregullores së Programit të Studimit, <i>neni 8</i>, studentët diplomohen ose me punim diplome, ose me provim të përgjithshëm formimi, i cili përfaqëson një testim të njohurive të fituara në mënyrë të integruar nga të gjitha lëndët/modulet me rëndësi dhe peshë specifike.</p> <p>Ky vlerësim final strukturohet si rast studimor kompleks, siç parashikohet edhe në dokumentin “B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”, ku theksohet se për programet Master Profesional, provimi përfundimtar synon të verifikojë aftësinë për të zbatuar dijet në një kontekst praktik e profesional.</p> <p>Për më tepër, RVB sqaron se për këtë program me natyrë njëvjeçare dhe me fokus aplikativ, ritestimi i thjeshtë teorik është konsideruar i papërshtatshëm. Prandaj, provimi është projektuar për të vlerësuar aftësitë praktike dhe zbatimin e njohurive në situata reale, në përputhje me profilin dhe qëllimin profesional të programit.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i></p> <p><i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e</p>	<p>Institucioni garanton mbështetjen e studentëve nga personeli akademik dhe udhëheqësit e diplomës gjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit përfundimtar.</p> <p>Sipas dokumentit “B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”, përcaktimi i temave të diplomës për programet Master Profesional fillon me konsultimin e Bordit të Tregut të Punës, i cili propozon tematika me interes praktik dhe aplikativ. Më pas, personeli akademik deklaron fushat e tij të ekspertizës dhe ofron tema për të cilat është i gatshëm të marrë përsipër udhëheqjen, duke u krijuar studentëve mundësinë për të zgjedhur në përputhje me interesat dhe objektivat profesionale.</p>

<p>rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët plotësojnë formularin e aplikimit në konsultim me një pedagog dhe dorëzimi i këtij formulari brenda afateve të shpallura është i domosdoshëm për të vijuar me procesin. Në të gjitha fazat, institucioni vë në dispozicion asistencë të vazhdueshme nga udhëheqësi, i cili luan një rol kyç për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - orientimin në përzgjedhjen e temës dhe objektit të studimit, - ndërtimin e hipotezave dhe strukturës së punimit, - mbështetjen metodologjike dhe ndihmën për përpunimin e rezultateve. <p>Gjithashtu, udhëheqësi është përgjegjës për garantimin e cilësisë së punimit dhe vendos nëse ai është i plotë për t'u paraqitur para komisionit të mbrojtjes.</p> <p>Ky proces mbështetet edhe nga zhvillimi i seancave metodologjike gjatë semestrit të dytë, ku trajtohen çështje të rëndësishme për përmbajtjen dhe metodologjinë shkencore të punës. Udhëheqësit kanë përgjegjësi jo vetëm për mbikëqyrjen akademike, por edhe për miratimin përfundimtar të dorëzimit të punimit.</p> <p>Sipas RVB, institucioni siguron për studentët qasje në mjedise të dedikuara (bibliotekë, laboratorë, programe softuerike), për të mbështetur punën praktike dhe kërkimore në funksion të diplomimit. Po ashtu, në rastet kur studenti nuk ndjek një temë diplome, ai i nënshtrohet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, i cili ka gjithashtu karakter aplikativ dhe kërkon nga studenti të zhvillojë një projekt të lidhur ngushtë me profilin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i></p> <p><i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit mbi infrastrukturën, UET vë në dispozicion të studentëve të programit Master Profesional të gjitha kapacitetet e tij logjistike dhe infrastrukture, përfshirë bibliotekën, laboratorët, sallat e mësimit dhe ambientet e tjera ndihmëse, të cilat janë të aksesueshme edhe jashtë orarit zyrtar të mësimit, kur studentët kërkojnë t'i përdorin për zhvillimin e projekteve, praktikave apo për përgatitjen e diplomës.</p> <p>Bazuar në RVB, studentët kanë gjithashtu mundësinë të përfitojnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit që UET ka me aktorë të</p>


	<p>ndryshëm të tregut të punës, duke i asistuar ata në kryerjen e matjeve, analizave apo kërkimeve në terren, në përputhje me temën dhe profilin e studimit të tyre. Këto bashkëpunime krijojnë mundësi reale që studentët të zhvillojnë komponentin praktik dhe aplikativ të studimeve, siç kërkohet nga natyra e programeve Master Profesional.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit - Rr. "Xhanfize Keko".pdf</i></p> <p><i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, si "Rregullorja e Programit të Studimit MP në Informatikë e Aplikuar" me profile dhe "Rregullorja e UET", konfirmohet se mbrojtja e diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar përbëjnë forma të detyrimeve përmbyllëse të studentit. Megjithëse në dokumentin "B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit" jepen udhëzime të detajuara mbi ndërtimin e punimit dhe procedurat për përgatitjen e tij, nuk gjendet një referencë eksplicite që të përcaktojë se vlerësimi përfundimtar i studentit përkthehet në notë.</p> <p>Megjithatë, bazuar në nenin 39 të Rregullores së UET, ku mbrojtja e diplomës përshkruhet si detyrimi përfundimtar për diplomimin, si dhe në praktikat standarde të dokumentuara në sistemin e vlerësimit të institucionit (nota mesatare, certifikata e notave, suplementi i diplomës etj.), mund të konkludohet se vlerësimi përfundimtar formalizohet me një notë, e cila bëhet pjesë e dokumentacionit të studentit dhe pasqyrohet në sistemin e menaxhimit akademik.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në</p>	<p>Institucioni e përmbush Kriterin 7 përmes përcaktimeve të qarta në Rregulloren e UET, <i>Neni 41</i>, ku specifikohet se studentit që ka përmbushur të gjitha kërkesat e programit të studimit dhe detyrimet ndaj institucionit, pajiset me diplomën dhe suplementin përkatës, të nënshkruar nga Rektori dhe Dekani i Fakultetit. Përpara lëshimit të diplomës zyrtare, institucioni lëshon një vërtetim për diplomimin, të shoqëruar me certifikatën e notave.</p>



<p>dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Po në të njëjtin nen (41.3), thuhet se në rast humbjeje ose dëmtimi të diplomës, nuk lëshohet dublikatë, por vetëm lista zyrtare e notave, e cila është e barasvlershme me diplomën, dhe nënshkruhet nga autoritetet përkatëse, duke u vërtetuar me vulën zyrtare të institucionit. Kjo garanton se studentit i vihet në dispozicion dokumentacioni zyrtar për përfundimin e studimeve. Sipas dokumentit “E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore”, pika E.1.5.7, përcaktohet se Sekretari i Përgjithshëm përgatit vërtetime, lista notash dhe kopje të suplementit të diplomës, bazuar në kërkesat individuale të studentëve, duke siguruar përmbushjen e nevojave dokumentare të tyre në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas RVB, vizites se kryer në institucion dhe dokumentit “E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore”, GVJ konstatoi që institucioni ruan duke magazinuar për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse ato kërkohen. Nga depozitimet përkatëse të dokumentacioneve mund të gjendet në çdo moment një kopje respektive duke verifikuar zbatimin e rregullores në çdo pike.</p> <p><i>Evidenca 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i> RVB Vizita IAL</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton një procedurë të qartë, të dokumentuar dhe të strukturuar për detyrimet përmbyllëse të studentëve të programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Rregulloret përkatëse, udhëzuesit mbi punimin e diplomës dhe evidencat nga vizita në IAL dëshmojnë se studentët informohen në kohë, marrin mbështetje të vazhdueshme nga personeli akademik dhe ndihmohen në të gjitha fazat e diplomimit apo provimit përfundimtar. Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e projektit aplikativ, garanton vlerësimin me notë, pajis studentin me dokumentacionin përfundimtar (diplomë, suplement, listë notash), dhe ruan të dhënat në përputhje me</p>

	<i>legjislacionin. Këto tregojnë një sistem funksional, tërësisht të përputhshëm me kërkesat e këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Referuar dokumentacionit si dhe vizitës në IAL, studentët e programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, zhvillojnë tema të caktuara në ambjentet laboratorike të institucionit. Për tu ambjentuar dhe me mjedisin real të punës, ata zhvillojnë dhe praktikat profesionale në formën e internship pranë institucioneve, me të cilët IAL ka marrëveshje. <i>Evidenca 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - DIT.pdf</i> <i>Evidenca 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi UET në funksion të programit.pdf</i> <i>Vizita IAL</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Pranë institucioneve ku studentët akordohen për të kryer praktikat, ata njihen me format dhe teknologjitë e përdorura në tregun e punës shqiptar, me qëllim përfitimin sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale që lidhen me këtë fushë në të cilën ata po studiojnë, si dhe për të orientuar dhe kualifikimin e tyre profesional përtej studimeve të ciklit të dytë. <i>Evidenca 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - DIT.pdf</i> <i>Evidenca 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi UET në funksion të programit.pdf</i> <i>RVB</i> <i>Vizita IAL</i>
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë	GVJ konstaton që lënda “Praktika Profesionale” është e përfshirë në planin mësimor të programit me vlerën e 6 krediteve ECTS, çka tregon ekuivalentimin e saj të qartë në kredite. Sipas pikës 7 të



<p>studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Rregullores së Programit Master Profesional, përcaktohen rregullat që shoqërojnë zhvillimin e praktikave, duke garantuar strukturë dhe mbikëqyrje gjatë realizimit të tyre.</p> <p>Gjithashtu, neni 34, pika 2 e Rregullores së UET thekson se praktikat profesionale vlerësohen me notë, në të njëjtën mënyrë si detyrimet e tjera akademike, dhe vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni. Kjo tregon se praktikat janë të dokumentuara dhe të vlerësuara në mënyrë formale, në përputhje me kërkesën e kriterit për dokumentim të posaçëm dhe vlerësim nga trajnerët apo strukturat përgjegjëse.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> 14.2. Plani mësimor i programit_MP Informatikë e Aplikuar (shqip)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni zbaton në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar praktikat profesionale si pjesë integrale e programit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Praktikant realizohen si në mjediset laboratorike të institucionit, ashtu edhe në institucionet partnere, duke i ekspozuar studentët ndaj teknologjive dhe praktikave aktuale të tregut të punës. Ekuivalentimi i praktikës me kredite (6 ECTS), rregullimi përmes dokumentacionit rregullator dhe vlerësimi i saj nga komisioni i posaçëm, dëshmojnë përmbushjen e të tre kriterëve të këtij standardi në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe objektivat formues të programit profesional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
--	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------	-----------------

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Referuar materialit të vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UET, konstatojmë se departamenti përgjegjës për këtë program studimi mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënië. Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar, kjo referuar evidencës së të dhënave tabelare. Stafii akademik efektiv dhe me kontratë, i angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike është si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> <th colspan="2">2024-2025</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>6</td> <td>4</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>Përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertiza akademike dhe kërkimore të pedagogut, përvojës në fushën e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	1	-	-	-	Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-	Dr/Phd	4	-	5	1	4	2	Msc.	1	4	1	4	2	3	Gjithsej	6	4	7	5	6	5
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	1	-	1	-	-	-																																											
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-																																											
Dr/Phd	4	-	5	1	4	2																																											
Msc.	1	4	1	4	2	3																																											
Gjithsej	6	4	7	5	6	5																																											
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në</p>	<p>GVJ konstaton, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UET se universiteti ka një rregullore në të cilën përcaktohet procedura e ndarjes së ngarkesës. Bazuar në tabelën 12, Tabelat Përmbledhëse për Aneks, për programin e studimit Master Profesional në</p>																																																

<p>përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>“Informatikë të Aplikuar” me profile, ngarkesa e orëve mësimore për 3 vitet e fundit akademike është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="603 427 1390 707"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>811</td> <td>525</td> <td>286</td> <td>65% / 35 %</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>741</td> <td>455</td> <td>286</td> <td>61% / 39%</td> </tr> <tr> <td>2024-2025</td> <td>621</td> <td>423</td> <td>198</td> <td>68% / 32%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>GVJ rekomandon, duhet të përmbushet kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	811	525	286	65% / 35 %	2023-2024	741	455	286	61% / 39%	2024-2025	621	423	198	68% / 32%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2022-2023	811	525	286	65% / 35 %																	
2023-2024	741	455	286	61% / 39%																	
2024-2025	621	423	198	68% / 32%																	
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UET, GVJ konstaton se UET ka kontrata pune me secilin punonjës të stafit akademik PAE dhe PAK. Çdo fillim viti zyra e burimeve njerëzore në bashkëpunim me departamentin dhe fakultetin përgjegjës për programim Master Profesional në "Informatike të Aplikuar" me profile, përditësojnë listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punës, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, cv, diploma, kualifikime etj.</p> <p>Kohëzgjatja e kontratës së punës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm ishin me kohë zgjatje të ndryshme, sipas specifikave dhe kategorive të ligjit në fuqi, përkatësisht me kohëzgjatje të pa përcaktuar, njëvjeçare, semestrale etj. Rinovimi i kontratës bëhet në bazë të performancës dhe vlerësimit cilësor në fushën e mësimdhënies, punës kërkimore, si dhe duke kontribuar në mbështetjen dhe zhvillimin e institucionit.</p> <p><i>Evidenca 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf</i> <i>Evidenca 11.1. Shembull thirrje për staf akademik.pdf</i></p>																				
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe</p>	<p>Bazuar në RVB-në e paraqitur nga UET dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave pranë UET, GVJ konstaton se në procedurën e ndjekur nga Universiteti Europian të Tiranës për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik janë plotësisht të</p>																				

<p>specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>përfshirë departamenti i njësisë bazë, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës dhe kritereve të përgjithshme dhe të posaçme për plotësimin e vakancës/vakancave në përputhje me modulet dhe përmbajtjen e programit dhe kualifikimin e personelit të kërkuar.</p> <p><i>Evidenca 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf</i> <i>Evidenca 11.1. Shembull thirrje për staf akademik.pdf</i> <i>Evidenca 11.2. Formulari i planifikimit të ngarkesës nga departamenti.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion por dhe bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstatoi se UET garanton përfshirjen e stafit akademik në orët laboratorike si dhe zyrën e IT, stafi i të cilit merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore. Kjo zyrë ndihon si në mbështetje të programit mësimor, ashtu edhe me çështje të infrastrukturës që IAL zotëron dhe menaxhon për orët praktike të lëndëve.</p> <p><i>Evidenca 1. RVB_MP Informatike e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ zgjidhi në mënyre të rastësishme dosje të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm nga ku konstaton se nga zyra e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) të angazhuar me programin Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile dhe janë krijuar dosje personeli për secilin prej tyre. Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore u vlerësuan dosjet e personelit akademik të tre anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. GVJ konstaton se nga kjo zyrë janë mbajtur dhe ruajtur të dhëna për angazhimin e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) në programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile.</p> <p><i>Evidenca 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf</i> <i>Evidenca 44.1. Format dosje staf akademik me kohë të plotë.pdf</i> <i>Evidenca 44.2. Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme.pdf</i></p>



<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar evidencave dhe takimeve ne Institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që institucioni ka një sërë marrëveshesh me biznese, kompani, apo institucione publike, të cilat synojnë të realizojnë kryerjen e praktikave profesionale të studentëve dhe jo vetëm.</p> <p>Punimi i diplomës është gjithashtu një proces i mirëmenaxhuar nga institucioni, ku një pjesë të semestrit të dytë studentët ndjekin dhe seanca informuese në lidhje me metodologjitë e ndjekura në implementimin dhe shkrimin e diplomës</p> <p><i><u>Evidenca 34. Marreveshje bashkepunimi - lista UET.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 34.1. Marreveshje bashkepunimi UET në funksion të programit.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 34.2. Memorandum Bashkëpunimi Atria Studio.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 34.3. Memorandum Bashkepunimi H&S Projekt 05.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 34.4. Memorandum Bashkëpunimi UET dhe ATD.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 34.5. Memorandum Bashkëpunimi UET dhe ITAL Costruzioni.pdf</u></i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Kurikula e programit të studimit MP në “Informatikë e Aplikuar” me profile, ka në përbërjen e saj edhe Praktikën Profesionale sipas ngarkesës së përcaktuar në Ligjin e Arsimit të Lartë. Si përmendur edhe më lart, UET ka një sërë marrëveshesh, qëllimi dhe objektivat e të cilave kanë në fokus realizimin e objektivave të programve të studimeve për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore apo organizimin e trajnimeve profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit.</p> <p>Sipas RVB, kompanitë që janë anëtare të Bordeve të Punës pranë Departamenteve në UET, janë shprehur të hapura në bashkëpunim për internship-et, bordet e punës, leksionet e hapura dhe vizitat në kompani. Në këtë dokument shprehet se Universiteti do të vijojë orientimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me strategjitë për zhvillimin kombëtar, duke mos e përjashtuar mundësinë e përditësimit të kurrikulave. Ky proces përfshin plotësimin e formularëve të praktikës së studentëve, formularit të vetëvlerësimit dhe raportit përfundimtar. GVJ e vlerëson pozitive këtë praktikë.</p> <p><i><u>Evidenca 14. Kurrikula e programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</u></i> <i><u>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</u></i></p>

	<p><u>Evidenca 1. RVB MP Informatike e Aplikuar.pdf</u> <u>Evidenca 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5).pdf</u> <u>Evidenca 32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf</u> <u>Evidenca 32.2. B-I-4 Formulari i vëtvleresimit te praktikës (nga Studenti).pdf</u> <u>Evidenca 32.3 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale 2023-24.pdf</u></p>		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, përmbush standardet në përputhje me fushën e programit të studimit. Ajo që vihet re nga tabela përmbledhëse është se kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës nuk përmbushet plotësisht.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, por edhe bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, në funksion të veprimtarisë mësimdhënëse. Auditorët e vënë në dispozicion për pjesën teorike të programit të studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, janë të kapaciteteve të ndryshme dhe të pajisur me kompjuter, videoprojektor dhe dërrasë interaktive. Secili mjedis disponon ajrosjen, ndriçimin e duhur dhe ajër të kondicionuar.</p> <p>Sipas dokumentacionit janë 14 salla leksionesh, 18 salla seminaresh dhe 7 laboratorë informatike.</p> <p><u>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko".pdf</u></p>

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin në funksion të veprimtarisë mësidhënëse, bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe takimet ne Institucion. Auditorët, klasa, laboratorët, biblioteka, sallat e leximit, si dhe ambientet e tjera në funksion të mësimdhënies-mësimnxënies në programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, janë të pajisura me pajisje elektronike (kompjuter, videoprojektor, dërrasë interaktive, pajisje fotokopjimi dhe printimi) dhe janë të mbështetura me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Katër salla laboratorësh të pajisur me kompjuter (mbi 30 kompjutera) me akses në intranet dhe internet. • Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë akses të plotë në rrjetin LAN dhe Wi-Fi të Universitetit • Kompjutera me performancë të lartë dhe me softëare përkatës të instaluar, në ambjentet laboratorike për programin e studimit: • Biblioteka fizike dhe Në burime elektronike biblioteka ka akses në katër platforma elektronike të cilat janë: 1. SAGE 2. EBSCO 3. Edëard Elgar Publishing 4. ASTM Compass <p>Të gjitha ambientet mbështeten nga infrastruktura qëndrore dhe e hostuar TIK që administrohen të gjitha nga personeli TI i Universitetit European të Tiranës.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "European të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, 7 laboratorë me videoprojektor, dërrasë interaktive, pajisje fotokopjimi dhe printimi, si dhe mbi 30 kompjutera për secilin laborator, me akses në intranet dhe internet, të cilat mirëmbahen nga personeli IT i Universitetit European të Tiranës dhe programet përditësohen sipas kërkesës nga departamentet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin European të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion 7</p>

<p>teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>laboratorë me mbi 30 kompjutera secili me akses në një rrjet të përbashkët dhe internet. Në kompjuterat me performancë të lartë të laboratorëve janë të instaluara programet e nevojshme që përdoren për disa lëndë të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ofron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Përveç infrastrukturës së tij, në funksion dhe mbështetje të garantimit të mjedisëve të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale e programit të studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, bashkëpunon në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara të bashkëpunimit me disa institucione dhe organizata. Studentët e këtij programi studimi Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" janë akomoduar dhe kanë zhvilluar praktikat mësimore pranë institucioneve dhe organizatave bashkëpunuese.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p> <p><i>32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5).pdf</i></p> <p><i>34. Marrëveshje bashkëpunimi - lista UET.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se UET disponon mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve dhe në përmbudhje të programit të studimit janë salat e leksioneve, seminareve dhe laboratorëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

87



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ mundi të shihte nga afër ambjentet e Bibliotekës së UET. U konstatua literatura në dispozicion të studentit në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore të Masterit Profesional “Informatikë e Aplikuar” me profile. Sipas RVB, Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. Biblioteka është abonuar në libraritë elektronike: SAGE, EBSCO, Edward Elgar Publishing dhe ASTM Compass. Sipas RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion (Rregullore Mësimorë e Programit Master Profesional) si dhe takimit me Përgjegjësen e Departamentit. Departamenti i Informatikës dhe Teknologjise përditëson në mënyrë periodike literaturën bazë dhe të detyrueshme të programit të studimit. Këto ndryshime bëhen në fillim të secilit semestër. Pavarësisht titujve të vendosur në syllabus-et e lëndëve përkatëse, të cilët janë tekste mjaft të mira në vetvete, GVJ konstaton që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Literatura e cituar nën seksionet: a. Literatura bazë e detyrueshme, dhe b. Literatura e rekomanduar, nuk ndjek në mënyrë konsistente të njëjtin standard referimi (p.sh. APA style, apo të tjerë).</i> • <i>Në disa nga literaturat e përdorura në syllabuse vitet e botimit janë mbi 5 vite më parë, pra më herët se 2020 dhe në gjuhën anglize.</i> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45. Inventari i teksteve në Bibilotekë për fushën e programit të studimit Informatike e Aplikuar .pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve me stafin akademik por edhe me Përgjegjësen e Departamentit, GVJ konstaton se çdo fillim viti akademik, përgjegjësi i njësisë bazë dhe koordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me pedagogët e lëndës sugjerojnë dhe përditësojnë syllabuset e lëndëve.</p>

	<p><i>Evidenca: 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45.3. Shembull procedure blerje literature.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që biblioteka është e lokalizuar në godinën e veçantë C, me një sipërfaqe 300 m², në dispozicion dhe të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, gjatë orarit 09:00-20:00, nga e hëna deri të premten dhe të shtunën 09:00-17:00. Biblioteka mund ta shfrytëzohet si sallë leximi për literaturën fizike, studentët dhe është e pajisur me kompjutera dhe akses të pakufizuar në internet, nëpërmjet të cilëve studentët mund të aksesojnë bibliotekat online SAGE, EBSCO, Edward Elgar Publishing dhe ASTM Compass, në të cilat UET është abonuar. Te gjitha këto informacione janë siguruar nga takimet në Institucion dhe dokumentat e dorëzuar nga GVB.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se në bibliotekën e institucionit disponohet për programet e studimit, një koleksion librash me literaturë fizike në shqip dhe gjuhë të huaj në një fond prej 406 libra për programin e studimit MP në “Informatikë e Aplikuar” me profile, shumica në gjuhën angleze, si dhe cikli i leksioneve në shqip për pjesën më të madhe të lëndëve në gjuhën angleze, të programit të studimit. Literatura e programit të studimit azhurnohet nëpërmjet kërkesës dhe plotësimit të formularit përkatës për blerjen e literaturës në bibliotekë, si dhe aksesit në bibliotekat online të abonuara nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45. Inventari i teksteve në Bibilotekë për fushën e programit të studimit Informatike e Aplikuar .pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45.3. Shembull procedure blerje literature.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa</p>	<p>UET ka krijuar kushte të barabarta dhe pa pagesë për studentët e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, duke ofruar shërbim falas dhe me akses të</p>

<p>pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>barabartë në katalogun e librave elektronik të bibliotekës, shumica në gjuhë të huaj dhe bibliotekat online të abonuar nga institucioni të listuara më lart. Ambjentet e bibliotekës fizike janë të aksesueshme sipas orarit zyrtar pa pagesë, mjafton të paraqesin kartën e studentit. E njëjta gjë vlen edhe për bibliotekën online dhe platformat që UET disponon për studentët e tij. Këto informacione gjenden në evidencat e dorëzuara dhe takimet në Institutin.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "European të Tiranës", GVJ konstaton se biblioteka është e pajisur me pajisjet dhe programet kompjuterike nëpërmjet të cilëve studentët shfrytëzojnë pa kufizime katalogun e librave elektronik të bibliotekës fizike dhe bibliotekat online të abonuar nga institucioni të përmendura më lartë. Gjithashtu u konstatua nga takimet se biblioteka ka hapësirën e duhur për të mundësuar një përdorim eficient të burimeve që biblioteka ofron.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin “European të Tiranës”, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve shërbimet e bibliotekës çdo ditë gjatë orarit 09:00-20:00, nga e hëna deri të premten dhe të shtunën 09:00-17:00.</p> <p><i>Evidenca 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i> <i>Evidenca 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online</p>	<p>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit të studimit Master Profesional në ‘Informatike të Aplikuar’ me profile, çdo fillim viti akademik zhvillojnë procedurën për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online përmes një kërkesë të departamentit bazuar në kërkesat e stafit.</p> <p><i>Evidenca 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf</i> <i>Evidenca 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë.pdf</i></p>

nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<i>Evidenca 45.3. Shembull procedure blerje literature.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literature bazë dhe ajo ndihmëse. Literatura ofrohet në formatin elektronik dhe ose në formatin fizik, si fondi fizik në bibliotekë, mund të përdoret nga studentët për të marrë njohuritë e duhura sipas kurikulës së ofruar. Biblioteka disponon të gjitha kushtet e nevojshme për studentët e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile dhe përditësohet në mënyrë të përsëritur sipas kërkesave të depozituara në Departament.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon të pasurohet literatura me botime brenda 5 viteve të fundit si dhe atë në gjuhën Shqip në fushat e duhura.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin European të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni disponon dhe ka në përdorim sistemin UMIS nëpërmjet të cilit menaxhohet informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre, në të gjithë programet e studimit, përfshirë dhe në programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Ky sistem mundëson gjenerimin e raporteve dhe informacioneve të nevojshme lidhur me aktivitetin e studentëve.



	<p><i>Evidenca 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf</i> <i>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit, një zgjidhje sharepoint për të administruar informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, të personelit ndihmës akademik dhe/apo personelit administrativ dhe partnerëve të përfshirë në realizimin e programit. Ky informacion bazohet në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës,</p> <p><i>Evidenca 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf</i> <i>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vuri re nga takimet dhe dokumentacioni i dorëzuar nga GVB, se institucioni përdor një sistem të përshtatur, mbi zgjidhjen sharepoint, për administrimin e dokumentacionit të institucionit në lidhje me programin e studimit. Ai gjithashtu përdor një sistem/aplikacion intranetit të brendshëm, nëpërmjet së cilës mundësohet administrimi i informacionit sipas hierarkisë dhe roleve të autorizuara, të përshtatur për përdorimin nga stafi administrativ, akademik dhe ndihmësakademik. Ndërkohë institucioni për administrimin e informacionit dhe literaturës së lëndëve të personelit akademik dhe të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile ka vënë në përdorim sistemin UET LMS, që ka të regjistruar dhe të përditësuar informacionin e nevojshëm për lëndët e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, për çdo semestër, akses në literaturën e lëndëve, si dhe pedagogët përgjegjës për lëndët.</p> <p><i>Evidenca 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf</i> <i>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe takimet fizike në UET, GVJ konstaton se institucioni ka në funksion të plotë dy platforma/sisteme LMS dhe UMIS për realizimin dhe administrimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet stafit akademik, personelit administrativ dhe studentëve. Sistemi i menaxhimit me platformat e integruara LMS ose UMIS mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve</p>

	<p>në mënyrë të saktë, në çdo kohë dhe në distancë. Në platformën LMS organizohet dhe administrohet procesi, materialet dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve nga pedagogu në funksion të zhvillimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Informacioni administrohet në formë të personalizuar për çdo përdorues, pedagog apo student.</p> <p><u><i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton që institucioni monitoron në kohë reale aktivitetin akademik dhe administrativ nëpërmjet përdorimit të sistemeve/platformave UMIS dhe UET LMS, që mundësojnë raportime individuale dhe në kohë reale për/nga organet drejtuese dhe titullarët. Sekretaria mësimore gjeneron në kohë reale, raporte individuale për secilën lëndë për organet drejtuese dhe titullarët. <i>Grupi GVJ nuk ka evidencë në lidhje me raportimet individuale</i></p> <p><u><i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka në funksion platformën e faqes zyrtare web, një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, fakulteteve, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, ato të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i publikuar azhurohet në mënyrë të vazhduar dhe në dy gjuhë.(gjuha shqipe dhe angleze).</p> <p><u><i>Evidenca 47. Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës.pdf</i></u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET disponon sistem menaxhimi të dedikuar, nëpërmjet të cilëve administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me stafin dhe student, si UMIS dhe UET LMS. E gjithë procedura akademike dhe administrative realizohet përmes këtyre sistemeve. Këto sisteme sigurojnë akses për të gjithë personelin akademik dhe studentët e programit të studimit.</i></p>

	<i>GVJ rekomandon që të shtohen evidence në lidhje me raportimet individuale të këtyre sistemeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe atë të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni në bazë të buxhetimit financiar të miratuar çdo vit, përcakton çdo vit një raport në lidhje me pasqyrat financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Institucioni ka hartuar raportin financiar në lidhje me koston për secilin program studimi, për çdo vit akademik dhe ka regjistruar dhe ruajtur të dhëna krahasuese për ecurinë dhe vazhdimësinë financiare të institucionit, për vitet 2020-2023, duke mundësuar identifikimin e komponentëve kryesore që ndikojnë në performancën e institucionit dhe që garantojnë qëndrueshmëri dhe rezultate financiare për institucionin. Institucioni ka burim kryesor financimi tarifat për dhe gjatë shkollimit, aktivitetet e tjera tregtare si: qeradhënie, parkim etj. Vihet re në raportin e paraqitur për financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare dhe RVB e dorëzuar nga GVB të programit të studimit për vitet 2020-2023 të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, se pjesa më e madhe e të ardhurave nga pagesat e studentëve, kontributit të granteve për kërkim shkencor siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj dhe aktiviteteve tregtare, shkon për shpenzime të pagave të personelit akademik, koston për student, mbarëvajtjes së mjediseve etj.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidenca 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1).pdf</i> <i>Evidenca 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).pdf (2021-2023)</i> <i>Evidenca 50.1. Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf</i></p>


	<p><u>Evidenca 50.2. Pasqyrat Financiare 2021 me shënime.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 50.3. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 50.4 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni harton planin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare në përputhje me standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit.</p> <p>Institucioni harton pasqyra financiare në transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe plani financiar i paraqitur për financimin e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, parashikon financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe infrastrukturës mbështetëse të procesit mësimor, detyrimet financiare të institucionit, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij të listuar në evidencat bashkangjitur.</p> <p><u>Evidenca 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1).pdf</u></p> <p><u>Evidenca 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2).pdf (2021-2023)</u></p> <p><u>Evidenca 50.1. Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 50.2. Pasqyrat Financiare 2021 me shënime.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 50.3. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 50.4 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka kryer auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2020-2023, nga një auditues ligjor i pavarur, sipas raportit vjetor në lidhje me transparencën financiare që paraqesin aspektet materiale dhe pozicionin financiar të kësaj shoqërie. Eksperti ka përgatitur raportin përkatës që depozitohet pranë QKB-së, konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare. Nga audituesi është nxjerrë konkluzioni se pasqyrat financiare paraqesin drejt aspektet materiale dhe pozicionin financiar të kësaj shoqërie, performancën</p>

	<p>financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara në Shqipëri.</p> <p><i>Evidenca 50.5. RAPORT AUDITIMI 2020.PDF</i> <i>Evidenca 50.6. Raport auditimi viti 2021.pdf</i> <i>Evidenca 50.7. RAPORT AUDITIMI 2022.PDF</i> <i>Evidenca 50.8. RAPORT AUDITIMI 2023.PDF</i></p>		
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në informacionin e mbledhur gjatë takimeve në Institucion, UET në fillim të çdo viti harton buxhetin vjetor, çdo njësi drejtuese informohet në lidhje me realizimin e buxhetit të vitit paraardhës.		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet pasqyrave financiare të raportuara për vitet 2020-2023, të çertifikuara dhe nga audituesi ligjor i autorizuar ka patur burim të të ardhurave të institucionit pagesat nga tarifat për dhe gjatë studimit, grantet për kërkim dhe kontratat dhe kontratatve të shërbimit të lidhura. Plan buxheti hartohet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga aksionerët, zbatimi faktik i të cilit i ngarkohet administratorit dhe zyrës së financës. Të gjitha veprimet janë të rregulluara nëpërmjet autorizimit nga administratori i zyrës financiare për kryerjen e veprimeve vetëm nëpërmjet sistemit bankar.		
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se në UET, çdo fillim viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përfshihen kërkesat dhe nevojat e njësisë bazë dhe programit të studimit. Të ardhurat për këtë program studimi bazohen kryesisht në tarifat e studentëve, grantet vendase apo të huaj dhe kontratatve të shërbimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin European të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura që duhet të ndjekë për programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, nga hyrja në dalje dhe që janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe të përcaktuara në Statusin dhe Rregulloren e Institucionit, rregulloren e Fakultetit, si dhe rregulloren e veçantë të Programit të studimit. Programi i studimit MP në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është i organizuar me 60 kredite formimi dhe gjuha e zhvillimit të programit është gjuha shqipe. Bazuar në politikat dhe procedurat e zbatuara, Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit nga hyrja në dalje.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik i MP6IA Final.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura për të garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe studentët e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, që mbështeten në Statusin e Institucionit, Rregulloren e e Universitetit European të Tiranës, si dhe rregulloren Mësimore e Programit të Studimit. Kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për studentët e programit të studimit, por edhe për kandidatët.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p>



	<i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se Institucioni nuk aplikon kritere shtesë në programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, përvec atyre të parashikuara në ligj dhe të shprehura në Dokumentin D.I.</p> <p><i>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve.pdf</i></p>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>GVJ konfirmon se në zbatim të politikave dhe procedurave, Institucioni ka përdorur një sërë mjetesh dhe metodash bashkëkohore për publikimin e kritereve dhe procedurave të aplikimit, pranimi dhe regjistrimit të studentëve, procesit të vlerësimit të dijeve si dhe diplomimit të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Kriteret dhe procedura e aplikimit janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, në fushatat informuese mediatike të zhvilluara në shkolla të mesme të ndryshme jo vetëm të Tiranës, broshurat informuese (Guida UET), si dhe gjatë procesit të informimit dhe këshillimit në zyrat përkatëse në Institucion. <i>Sipas RVB dhe takimeve të realizuara në UET, nuk gjenden të dhëna nëse këto rezultate të vlerësimit të programit të studimit bëhen publike nga Institucioni, në Web apo në forma të tjera, sipas rekomandimit.</i></p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve.pdf</i> <i>Evidenca [http://uet.edu.al/neë/si-te-aplikojme/].</i></p>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni	GVJ konstatoi nga vizitat në IAL dhe evidencat se institucioni përpara fillimit të vitit për programin e studimit MP në

<p>informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>“Informatikë e Aplikuar” me profile, ka informuar dhe udhëzuar publikun dhe studentët e interesuar për kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në programin e studimit nëpërmjet informimit në faqen web të institucionit, fushata informuese në shkollat e mesme jo vetëm në Tiranë, fushat publicitare në televizione, broshurave të informimit(GUIDA UET), si dhe informimit të publikut të interesuar dhe në zyrat dhe ambientet e institucionit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf</i> <i>Evidenca 51. Politika e marketingut të programeve të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat se përpara fillimit të çdo viti akademik se institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit në Web, në broshurën informuese, fushatat mediatike dhe gjatë këshillimit në institucione sipas Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe të pakicave kombëtare.</p> <p><i>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi se në fillim të çdo viti akademik, UET informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në përputhshmëri me Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> <p><i>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në IAL se UET ka përcaktuar politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë bazuar në Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS. IAL ofron bursa të plota ose të pjesshme studimi, mbi bazën e disa kriterëve përgjedhjeje duke u ardhur në ndihmë shtresave në nevojë dhe jo vetëm.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se UET harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MP</p>



	në "Informatikë e Aplikuar" me profile. Universiteti përdor faqen zyrtare të web-it sipas komunikimit gjithëpërfshirës. UET përkrah politika dhe procedura për regjistrimin e studentëve në këtë program, studentëve Shqiptarë, të huaj etj. Gjithashtu IAL ofron bursa për kategori të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ konstaton gjatë vizitave në IAL dhe dokumentave të dorëzuar se për programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile, institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Në javën e parë të orientimit të organizuar nga fakulteti, gjatë orientimit dhe prezantimit të syllabus-it të lëndës, nga çdo pedagog, në javën e parë të mësimin. Gjithashtu informacion në lidhje me procedurat e transferimit dhe përparimit nga një vit në tjetrin, IAL i ka të parashikuara në rregulloret dhe aktet rregullatore.</p> <p><i>Evidenca 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 10.5. Kalendari akademik 2024-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14.2. Plani mësimor i programit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni, ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose

<p>mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>studimeve të pjesshme në rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "European të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit të studimit, për infrastrukturën në dispozicion të programit, në javën e orientimit dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabus-it përkatës ku paraqitet ky informacion.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin European të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka të përcaktuar në rregulloren universitetit, të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile dhe programin mësimor procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit, e cila organizohet si punim diplome ose provim i përgjithshëm formimi.</p> <p><i>Evidenca 10.5. Kalendari akademik 2024-2025.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka të përcaktuar në rregulloren universitetit, të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile dhe programin mësimor, procedurat e informimit të të interesuarve. Çdo fillim viti akademik dhe në formë periodike, institucioni informon të interesuarit për programin e studimit. Mund të përmendim</p>

për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	zhvillimin e ditëve të hapura, broshurat, mediat online dhe jo vetëm. Edhe pse procesi i informimit duket sipas evidencave të realizohet, <i>përsëri vihet re një numër i ulët i regjistrimeve, këto të dhëna nga takimet me stafin dhe Përgjegjësën e Departamentit, por edhe tabelës përmbledhëse të regjistrimeve.</i> <i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i>								
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UET përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale, ambientet e IAL, broshurave, medias online dhe jo vetëm, ditëve të hapura dhe takimeve nëpër institucionet e arsimit të mesëm. Sipas takimeve me stafin akademik, Përgjegjësën e Departamentit dhe në bazë të evidencave të dorëzuara, vihet re një kërkesë e ulët në regjistrime, vit pas viti.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, si dhe për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtarisë formuese. Ata informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Përveç këshillimit me stafin akademik, në momentin që interesohen për programet e studimit dhe kontakteve me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, në javën e parë të orientimit, në zbatim të rregullores së programit të studimit, krahas prezantimit të të gjithë elementëve të programit të studimit nga përgjegjësi i departamentit të njesisë bazë dhe stafi akademik, realizohet prezantimi i

	<p>objektivave, njohuritë dhe aftësitë që do të fitohen nga secila lëndë. Në javën e parë të mësimit në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë formuese të parashikuara. Me këtë informacion studentët njihen dhe në faqen zyrtare të informacionit, broshurave informuese (<i>Guida UET</i>) dhe syllabus-et e lëndëve.</p> <p><u><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></u> <u><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 51. Politika e marketingut të programeve të studimit.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 10.5. Kalendari akademik 2024-2025.pdf</i></u> <u><i>Evidenca 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe fletëpalosje/ udhëzues për lëndët/modulet, kurrikulën dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion gjendet në rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu informacioni gjendet edhe në syllabus-et e kurseve të programit të studimit.</p> <p><u><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></u> <u><i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyra Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit është struktura që zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e programit të studimit Master Profesional “Informatikë e Aplikuar” për tregun e punës nëpërmjet Bordeve të tregut të punës, organizimit të panairëve të punës dhe aktiviteteve me partnerë dhe aktorë nga tregu i punës. Studentët udhëzohen dhe kanë përfituar nga marrëveshjet me institucione private dhe shtetërore për praktika mësimore dhe janë ftuar dhe në trajnime dhe aktivitete të përbashkëta të realizuara. Në mënyrë të vazhdueshme studentët e programit të studimit janë informuar për mundësi të ndryshme punësimi me email dhe janë mbështetur dhe</p>



	<p>këshilluar për përgatitjen e CV, letrave të motivimit, përgatitjen për intervistë punësimi.</p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i> <i>Evidenca 12.1. Bordi i tregut të Punës DIT.pdf</i> <i>Evidenca 12.3. PANAIRI I PUNES.pdf</i> <i>Evidenca 32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf</i> <i>Evidenca 33. Lista e trajnimeve profesionale .pdf</i> <i>Evidenca 34. Marreveshje bashkëpunimi - lista UET.pdf</i> <i>Evidenca 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - DIT.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Që në javën e parë të orientimit studentët njihen nga departamenti. Në mënyrë specifike koordinatori i departamentit ka detyrë informimin e vazhdueshëm dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e programit mësimor, logjistikës, infrastrukturës së programit të studimit. Çdo ndryshim apo përditësim u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Nga ana tjetër çdo informacion mbi procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, njoftohen përmes postës elektronike dhe sistemit UET LMS.</p> <p><i>Evidenca 36.1. Vendim dekanati për koordinatorët e programeve.pdf</i> <i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i> <i>Evidenca 10.5. Kalendari akademik 2024-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se Informacioni mbi programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, është lehtësisht i aksesueshëm nga çdo student i këtij programi, nëpërmjet platformës Learning management System(LMS) në UET, ku studentët kanë mundësi të gjejnë materialet përkatëse në të gjitha lëndët, në të cilat janë regjistruar si dhe ndërveprojnë lehtësisht me stafin pedagogjik për çdo</p>

	paqartësi. Kjo platformë është përshtatur si aplikacion mobile dhe aksesohet në distancë nga studentët.			
	<i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i> <i>Evidenca Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf</i> <i>Evidenca 46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UET ka struktura të mirëpërcaktuara në mbështetje të studentëve. Në UET zhvillohet java e orientimit, ku studentët njihen me ambientet, programin, personelin përgjegjës etj. Gjithashtu studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore të institucionit mbahen dhe regjistrohen të dhëna vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile. Të dhënat për numrin e studentëve të diplomuar si më poshtë: Viti 2019-2020 janë 34 studentë të diplomuar gjithsej, viti 2020-2021 janë 17 studentë të diplomuar në total, viti 2021-2022 janë 16 studentë në total, viti 2022-2023 janë 12 studentë të diplomuar në total dhe viti 2023-2024 janë 10 studentë të diplomuar. <i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RYB Informatikë e Aplikuar.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar deri në diplomimin e tyre, në programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile. Në këtë program studimi janë regjistruar këta studentë si më poshtë:

<p>tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>2020-2021 23 studentë në total 2021-2022 17 studentë në total 2022-2023 13 studentë në total 2023-2024 9 studentë në total 2024-2025 4 studentë në total</p> <p>Ai gjithashtu disponon të dhëna për studentët të cilët kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër .</p> <p><i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i> <i>Vizita në Sekretarinë Mësimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore për menaxhimin e informacionit të brendshëm përdor sistemin e menaxhimit të informacionit të universitetit (UMIS) që është një program ku ruhen, administrohen dhe përpunohen të gjitha të dhënat e studentëve, përfshirë dhe rezultatet e ecurisë në programin e studimit, gjenerimin e raporteve të ndryshme statistikore. Këto të dhëna dhe raporte shërbejnë për administrimin e aktiviteteve e institucionit sipas roleve dhe aksesit të autorizuar.</p> <p><i>Evidenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i> <i>Evidenca 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni zhvillon kontrole periodike pranë gjithë njësive përgjegjëse si fakultetet, departamentet, sekretaritë mësimore, njësitë administrative, etj., ku vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe programet e studimit. Procedura e kontrollit bazohet në rregulloren e programit të studimit, sekretarisë mësimore etj.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, të dhëna mbi punësimin e tyre dhe tregues të tjerë që lidhen me ndjekjen e studentëve dhe masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në kuadër të masave për përmirësimin e treguesve të</p>

<p>cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>punësimit të studentëve Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit e cila ndjek karrierën dhe punësimin e studentëve në vazhdimësi mban kontakte me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre, vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre – MP Informatikë e Aplikuar (Tabela 23).pdf</i> <i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i> <i>Evidenca 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> <i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se UET mban statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit deri në diplomimin e tyre si dhe transferimet dhe larimet nga programi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit, ku specifikohet qartë përfshirja, angazhimi, si dhe roli i Këshillit studentor, përfshirja dhe angazhimi i përfaqësuesve të studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të institucionit si Senati Akademik, Dekanat, KSBC Mbledhjet e hapura dhe focus grupet.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregulloret e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i></p>



	<p><u>Evidenca 12.5. Mbledhje e hapur me studentët.pdf</u> <u>Evidenca 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf</u> <u>Evidenca 30.13. Metodologjia e punës së KSBC Fokus Grup.pdf</u> <u>Evidenca 30.14. Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve.pdf</u> <u>Evidenca 30.15. Shpërndarja e raportit dhe ekstrakt raporti i fokus grupeve.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka garantuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse e këshilluese nëpërmjet përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit. Studentët përfaqësohen përkatësisht në senatin akademik, komisionet e përhershme, këshillin e etikës dhe në Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC).</p> <p><u>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</u> <u>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</u> <u>Evidenca 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf</u> <u>Evidenca 30.13. Metodologjia e punës së KSBC Fokus Grup.pdf</u> <u>Evidenca 30.15. Shpërndarja e raportit dhe ekstrakt raporti i fokus grupeve.pdf</u> <u>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</u> <u>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se në këtë program studimi, Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, se është realizuar proces i rishikimit dhe përmirësimit deri në 20 % të këtij programi studimi me Vendimin e Senatit Akademik Nr.5 të datës 20.09.2022, që është dërguar për njohje pranë MAS sipas përcaktimeve ligjore për miratimin e ndryshimeve në kurikulën e programit.</p> <p><u>Evidenca 54.8.2. Vendim i Senatit Nr. 05, date 20.09.2022 Per miratimin e ndryshimeve ne kurrikulat e programeve nen 20 per qind.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së</p>	<p>Sipas materialeve të dorëzuara dhe takimeve në Institucion, GVJ konstaton se UET u mundëson studentëve së pari vënien në dispozicion dhe informimin mbi kriteret dhe procesin e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, Master Profesional në</p>

<p>procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>“Informatikë e Aplikuar” me profile, në javën e informimit dhe gjatë javës së parë të mësimit për çdo lëndë. Studentëve ju mundësohet nëpërmjet procedurave të rregulluara, e drejta e barazisë dhe transparencës në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, si dhe mundësisë së ankimimit të rezultatit, kërkesës për rishikim të tij.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar (shqip).pdf</i> <i>Evidenca 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët online.pdf</i> <i>Evidenca 40.1. Shembuj Vlerësimi nga studentët online.pdf</i> <i>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi në përfundim të vlerësimit se studentët janë të përfaqësuar në UET dhe këto janë të rregulluara edhe në procedurat dhe aktet rregullative. Sugjerimet e tyre merren në konsideratë nga organet respective.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedura të veçanta, të përcaktuara që në rregulloren e institucionit, si dhe ka ngritur njësinë përgjegjëse për informimin dhe në shërbim të studentëve, që është Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (ZKKKS) me objektiva dhe detyra të mirëpërcaktuara. Qëllimi është informimi dhe mbështetja e studentëve, për procesin mësimor, praktikat profesionale, orientim në punësim pas diplomimit etj.</p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i></p>

	<p><i>Evidenca 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se ZKKKS funksionon tërësisht në mbështetje të informimit, këshillimit, ndjekjes së përparimit të studentëve dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit, Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Krahas saj institucioni zhvillon këshillimin e karrierës në gjimnaze dhe panaire, ku përveç këshillimit për programet e studimit, ofrohet informacioni për jetën studentore, aktivitetet e ndryshme që zhvillohen gjatë vitit akademik në UET, tarifave edhe modaliteteve të pagesës, si dhe bursat e ofruara nga UET. Më tej me regjistrimin e studentëve në programin e studimit, ky proces ndiqet nga ZKKKS. Një nga programet me interes që prezantohet nga ZKKKS është programi ERASMUS+ dhe mobiliteti në universitetet e tjera me të cilat universiteti ka bashkëpunim.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32.1. Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet ZKKKS ofron shërbimin e këshillimit të karrierës dhe kujdesin ndaj studentit, në bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen studentore kanë mbështetur studentët në mënyrë të vazhduar, duke i orientuar qoftë në drejtim të përfundimit me sukses të procesit mësimor, por dhe në orientimin dhe zgjedhjen e praktikës profesionale, si dhe orientimin në tregun dhe vendet e lira të punës, mbështetjen dhe këshillimin e nevojshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen për intervistë. Krahas kësaj zyre ofrohet tutoriati dhe këshillimi akademik për studentët nga personeli akademik. Nga kjo zyrë janë krijuar kontakte dhe institucioni ka lidhur marrëveshje me kompani private dhe institucione shtetërore në funksion të praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit të studentëve. Ndërkohë ZKKKS ka udhëzuar dhe mbështetur</p>

<p>tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>studentët mbi mundësitë e mobilitetit me projektin ERASMUS+ dhe projektet e tjera të institucionit, si dhe mundësitë e punësimit me Biznesin.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 28.1. Rregullore per shkembimet studentore Erasmus dhe diploma te dyfishta.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 28.2. Vendim Senati Nr.Prot 19 Date 19.10.2021 Miratimi i rregullores per shkembimet studentore Erasmus Plus.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>ZKKKS, si pjesë e detyrave të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar në programin e studimit, duke grumbulluar, përpunuar dhe regjistruar të dhëna mbi punësimin dhe cilësinë e punësimit të tyre në raport me programin e studimeve. Institucioni ka bashkëpunim të vazhdueshëm me tregun e punës në funksion të sugjerimeve për përmirësimet e nevojshme të ofertës akademike të institucionit për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve teknologjike në vend e jashtë.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UET u ofron studentëve këshillim karriere nëpërmjet ZKKKS, e cila mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikat profesionale, tregune e punës, diplomimin etj. ZKKKS realizon orientim professional, këshillim individual ose në grup.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstaton se institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në Rregulloren e UET përshkruhen në mënyrë të detjuar mënyrat e hartimit të syllabus-eve, metodat e mësimdhënies, sistemi i kontrollit të dijeve, etj. Për të verifikuar implementimin e tyre, GVJ kontrolloi dhe programet e lëndëve, në të cilat saktësohen edhe me tepër se cilat metodologji do ndjekë lektori në leksion apo seminar. <i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në bazë të RVB, dokumentave të vënë në dispozicion, si dhe shpjegimeve të marra gjatë vizitës në IAL, konstatohet se institucioni zhvillon mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik. Këto mekanizma janë: <ul style="list-style-type: none"> • të drejtpërdrejta nëpërmjet asistimit në sallë nga strukturat e larta të njësisë bazë/kryesore; • vlerësimi nga studentët në fund të semestrit me anë të pyetësorëve online; • nëpërmjet një strukture studentore të quajtur focus-group; • vetëvlerësimi;

	<ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i Vlerësimit të Përformancës që ngrihet nga Rektori; • Leksione të hapura. <p><u>Evidenca 30.1 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 40.1. Shembuj Vlerësimi nga studentët online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik - 2022.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 3. Metodologjia e punës së KSBC Fokus Grup.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi që në IAL funksionon një sistem kompleks për menaxhimin e proceseve mësimore (mësimin, vlerësimin të lëndës, frekuentimit, etj) që përfshin dhe menaxhimin e vlerësimit të studentëve për secilën lëndë në fund të semestrit. Këto vlerësime janë jo vetëm për aspekte të mësimdhënies, por edhe në drejtimin e etikës së komunikimit, mbështetjes së studentëve si dhe mbarëvajtjes së përgjithshme të orës së mësimin dhe kërkesave të studentëve që lidhen me to. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh konkretisht me disa shembuj të vlerësimeve të pedagogëve. Studentët mund të shprehin mendimet apo ankesat e tyre edhe në mbledhjet e departamentit, ose me kërkesë drejtuar përgjegjësit të departamentit, si dhe në struktura të tjera, si ajo e Zyrës së Kujdesit të Studentit.</p> <p><u>Evidenca 30.1 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 40.1. Shembuj Vlerësimi nga studentët online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik - 2022.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 3. Metodologjia e punës së KSBC Fokus Grup.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në bazë të RVB, rezultatet e vlerësimit përpunohen nga KSBC, apo nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme.</p>

	<u>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</u>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>UET nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultatetve të marra nga pyetësorët analizon të dhënat duke patur në fokus: rritjen e vazhdueshme të cilësisë së drejtimit të UET, të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në UET, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore.</p> <p>Kontrolli periodik dhe shumëplanësh, që u evidentua të zhvillohej në institucion, bën që personeli akademik të mund të mësojë praktikat e mira, si në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, ashtu edhe në aspekte të tjera të punëve të tij brenda institucionit.</p> <p><u>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</u> <u>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</u></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstatoi nga dokumentat e dorëzuara dhe vizita në institucion se UET ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Studentët japin mendimet e tyre përmes pyetësorëve. KSBC dhe IT përpilojnë raportin dhe në bashkëpunim me Njësinë bazë dhe Fakultetin, ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit i bëhen me dije Përgjegjësit të Departamentit dhe Instancave më lart për të marrë masat e nevojshme.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	Institucioni harton dhe zbaton politika e duhura, duke ngritur struktura dhe procedura, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe ato rregullatore të institucionit. Misioni i arsimit të lartë është të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane. Struktura përgjegjëse e ngritur për këtë qëllim është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. KSBC është një

<p>aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>strukturë autonome dhe e perhershme në strukturën organizative të institucionit përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. KSBC është ngritur në nivel universiteti dhe anëtarët e tij propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit. Gjithashtu në UET është ngritur dhe është funksionale një strukturë tjetër që prej vitit 2016, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC) për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit.</p> <p><i><u>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale_shqip.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UET ka ngritur strukturën përgjegjëse, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që është një strukturë autonome, e perhershme dhe funksionale në strukturën organizative të institucionit. Kjo njësi zbaton strategjinë në funksion të objektivave të institucionit që ka në fokus kryesor përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë në këtë process ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të studentëve. KSBC monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike proceset mësimore e kërkimore në UET. Gjithashtu është ngritur Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC) për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. Për këtë qëllim institucioni ka hartuar dhe zbaton strategjinë, planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i><u>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</u></i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni në zbatim të statutit, planit strategjik dhe rregullore së tij ka anagazhuar përveç strukturave përgjegjëse dhe ato bashkëpunuese, si dhe instrumente efektive për sigurimin e cilësisë si: personelin akademik dhe ndihmës akademik, Bordet e Tregut të Punës, përfshirja në KSBC i një eksperti të jashtëm dhe përfaqësuesit të këshillit studentor. Universiteti Europian i Tiranës ka kaluar të dy format e procesit të akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 54.4. VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 "Për akreditimin e UET".pdf</i></p> <p><i>Evidenca 54.5. Certifikatë Akreditimi UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 54.6. OAA Certificate of Accreditation.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 54.7. Urdher Nr.251, date 14.06.2013 Per akreditimin e MP Informatikë e Aplikuar.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>UET përdor mekanizma për vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe kërkimit, duke pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë institucionale. Mbi bazën e rezultateve, Institucioni realizon promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UET përdor disa instrumenta dhe tregues për sigurimin e cilësisë. Ai përdor mjetet dhe teknikat për vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. KSBC dhe ZSC bashkëpunojnë me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Universiteti European të Tiranës ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një njësi të posaçme me funksion të përhershëm, e cila është funksionale dhe është përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e programeve të ciklit të dytë. Gjithashtu në UET është ngritur prej vitit 2016 dhe është funksionale një strukturë tjetër, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC) për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikave të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. Këto njësi përdorin mekanizma e procese të formalizuara të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e hërëpashershme të programit të studimeve të ciklit të dytë, përfshirë dhe Master Profesional “Informatikë e Aplikuar”, në zbatim të strategjisë, planit të veprimit dhe manualit të miratuar, sipas një plani kalendarik, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara.”. Dy herë në vit, organizohen në mënyrë anonimate, 2 javë para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetorët online studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi, përfshirë edhe programi i studimit Master Profesional “Informatikë e Aplikuar. NJBSC përgatit dhe vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar, raportin e vlerësimeve periodike në procesin e shqyrtimit, miratimit dhe mbikëqyrjes së programeve të studimit në rang institucional. Në fund të vitit njësia bazë për programin e studimit Master Profesional “Informatikë e Aplikuar” realizon procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së këtij programi studimi. Rezultatet e vlerësimit dhe sipas rasteve të identifikuar për përmirësim përkthehen në rekomandime për tu zbatuar dhe monitoruar më tej për përmirësimin dhe mbarëvajtjen e ecurisë së këtij program. Institucioni dokumenton rezultatet e vlerësimeve, të cilat i ka raportuar tek autoritetet përgjegjëse dhe vendimmarrëse të programit të studimit. Raporti i rezultateve të nxjerra nga procesi i</p>

	<p>monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen nga KSBC tek titullari i lëndës përgjegjësve të grup-lëndëve, drejtuesit të departamentit, dekani, së bashku me rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë KSBC.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e UET.pdf</i> <i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 37. Formatit i raportit të Vlerësimit të Syllabuseve.pdf</i> <i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i> <i>Evidenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 18. Adresimi i rekomandimeve nga akreditimi më i fundit MPIA.pdf</i> <i>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vevlerësimit të performancës së personelit akademik - 2022.pdf</i> <i>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studenteve Departamenti.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni për aktivitetet e monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit ka përgatitur raporte të cilat përmbajnë rezultatet e vlerësimit, masat e marra për adresimin e mangësive të identifikuara dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tyre. Këto rezultate në fund të procesit I komunikohen stafit dhe studentëve në lidhje me gjetjet.</p> <p><i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i> <i>Evidenca 37. Formatit i raportit të Vlerësimit të Syllabuseve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës,</p>	<p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente të vlerësimit të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, përfshirë dhe programin e studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. KSBC ka organizuar aktivitete për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor me mbështetjen e grupeve ad-hoc të ngritura pranë departamenteve.</p>



<p>kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Gjithashtu stafi i ri këshillohet, orientohet dhe njihet me praktikat më të mira për të qënë në përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p><i><u>Evidenca 37. Formati i raportit te Vlerësimit të Syllabuseve.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik - 2022.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>UET, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit ka përdorur metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të tilla si sondazhet për vlerësimin e mësimdhënies (lëndëve dhe pedagogëve) në programin e studimit, sondazhe të kurrikulës, infrastrukturës në dispozicion, si dhe intervista me studentët e programit të studimit. Raportet e rezultateve të vlerësimit u raportohen drejtuesve të institucionit, fakulteteve dhe rektoratit të institucionit, si dhe në mënyrë individuale i raportohen dhe personelit akademik pjesë e procesit të vlerësimit. Këto rezultate vlerësimi reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në fund të vitit akademik. Një fokus i veçantë i kushtohet intervistave me pedagogët gjatë procesit të vlerësimit të performancës së tyre.</p> <p><i><u>Evidenca 37. Formati i raportit te Vlerësimit të Syllabuseve.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik - 2022.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti.pdf</u></i> <i><u>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti.pdf</u></i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UET përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë akademike. Në fund të procesit përgatite raporti i vlerësimit. Raporti i rezultateve të nxjerra nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen nga KSBC tek titullari i lëndës përgjegjësve të grup-lëndëve, drejtuesit të departamentit, dekani, së bashku me rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë KSBC.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UET garanton që në zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile. Në KSBC janë angazhuar përveç personelit të brendshëm të institucionit, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i këshillit studentor. Ngritja e bordeve të tregut të punës dhe bashkëpunimi i KSBC me to ka ndikim pozitiv të vazhdueshëm në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit. Përfshirja e institucionit në projekte të ndryshme që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë, kanë impakt pozitiv që lidhet në mënyrë të veçantë përtej shkëmbimit të eksperiencave, njohurive nëpërmjet trajnimeve dhe vizitave studimore, me vlerësimin dhe përmirësimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve të përdorura nga IAL-të private për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i> <i>Evidenca 28.4 Projektet UET.pdf</i> <i>Evidenca 28.8. Lista e projekteve stafi nga Departamenti i përfshirë në to.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për KSBC, njësitë, personelin akademik, personelin administrativ, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, përfshirë Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, duke garantuar përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrave. Aktivitetet e planifikuara për vitin akademik 2019-2024 janë paraqitur në planin e veprimit të</p>

<p>studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>KSBC, janë në funksion të objektivave të strategjisë për sigurimin e brendshëm të Cilësisë, me objektiv madhor sigurimin e cilësisë të procesit mësimor në programin e studimit, Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, si dhe kërkohet pjesëmarrja aktive në propozimin, përcaktimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të modeleve vlerësuese sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për KSBC, njësitë, personelin akademik, personelin administrativ, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, përfshirë Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, duke garantuar përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrave. Aktivitetet e planifikuara janë paraqitur në planin e veprimit të KSBC, janë në funksion të objektivave të strategjisë për sigurimin e brendshëm të Cilësisë, me objektiv madhor sigurimin e cilësisë të procesit mësimor në programin e studimit, Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, si dhe kërkohet pjesëmarrja aktive në propozimin, përcaktimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të modeleve vlerësuese sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka përfshirë dhe aktivizuar në KSBC personel akademik të brendshëm nga të gjitha fakultetet, që nuk janë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET, si dhe një përfaqësues të këshillit studentor të përzgjedhur në një proces tërësisht transparent. Këta aktorë të brendshëm janë pjesëtar aktivë të procesit të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni dhe programi studimi në bashkëpunim dhe me njësinë bazë që mbulon programin e studimit. Ndërkohë përfshirja e ekspertit të jashtëm në proceset e vlerësimit është vetëm në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.</p> <p><i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC.pdf</i></p>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>UET ka përfshirë dhe aktivizuar në KSBC aktorë të brendshëm të cilët janë pjesëtar aktivë të procesit të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni dhe programi studimi në bashkëpunim dhe me njësinë bazë që mbulon programin e studimit. Ndërkohë përfshirja e ekspertit të jashtëm në proceset e vlerësimit është vetëm në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.</p> <p><i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UET operon me procedura të sigurimit të cilësisë që demonstrojnë transparencën dhe përgjegjësinë për të gjithë aktorët e saj. I gjithë personeli akademik dhe administrative ka në rol kyc në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm të KSBC dhe ZSC.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe strategji për organizimin dhe aktivitetet në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni. Në evidencat e dorëzuara për vitet 2022-2024 është paraqitur plani i veprimit të KSBC.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UET, pas përfundimit të procesit të vlerësimit ka përgatitur rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit, përfshirë dhe Master Profesional në “Informatikë e Aplikuar” me profile, që duke i konsideruar të dhëna sensitive dhe personale i ka ndarë përgjithësisht, në grupet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe në raste të veçanta kur të dhënat janë konsideruar se kanë një sensibilitet të lartë janë trajtuar nga strukturat drejtuese në takime individuale.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimi KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në raportet e përgatitura pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit, janë evidentuar një plan masash që duhet të ndërmerren nga grupet dhe aktorët e përfshirë dhe interesuar për të arritur objektivin e përmirësimit të mangësive të identifikuar. Rezultatet e vlerësimit të KSBC nga procesi i vlerësimit periodik janë përdorur jo vetëm për vlerësimin e procesit dhe identifikimin e problematikave, por edhe me objektiv marrjen e masave për përmirësimin e garantimin e cilësisë së brendshme të programeve të studimit. Sipas RVB, në mënyre periodike zhvillohen mbledhje departamenti ku diskutohet ecuria dhe problematikat e procesit mësimor dhe kur është e nevojshme sugjerohen masa për ndërhyje. Plani i masave hartohet në nivel Universiteti dhe miratohet nga Senati akademik në zbatim për vitin pasues. Disa nga masat e marra në drejtim të përmirësimit të cilësisë janë: trajnimet e vazhdueshme mbi metodat e sukseshme didaktike në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në aktivitete dhe projekte zhvilluese edhe jashtë institucionit.</p> <p><i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimi KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 30.12. Shembull Relacioni i KSBC mbi silabuset DIT FIIA.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të</p>	<p>UET ka vlerësuar dhe siguron monitorim të vazhdueshëm të procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. Janë marrë masa për rishikim dhe përmirësim të rregulloreve, kurikulës, syllabus-eve etj. Ky proces vlerësimi dhe monitorimi ka pasur objektiv kryesor sigurimin e efektivitetit dhe</p>

<p>cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>impaktit të masave të marra për përmirësimin e mangësive dhe problematikave të identifikuar gjatë procesit të vlerësimeve periodike dhe të sigurojë përmirësimin e cilësisë të programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 18. Adresimi i rekomandimeve nga akreditimi më i fundit MPIA.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti European të Tiranës, organizon veprimtari periodike duke përfshirë stafin akademik dhe studentët në proceset e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në KSBC dhe pjesëmarrjes në GVB ad-hoc të programeve të studimit në proces akreditimi, në javën e orientimit në fillim të vitit akademik dhe në mënyrë të tërthortë dhe me procesin e pyetësorëve të studentëve. Veprimtari periodike me studentët janë mbledhjet e Asamblesë së pedagogëve, trajnimet e ndryshme, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e tyre në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. <i>Rekomandohen veprimtari periodike për ti informuar në mënyrë të drejtpërdrejtë studentët për nevojën e ndërgjegjësimit të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programin e studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile.</i></p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i UET Organigrama aktuale shqip.pdf</i> <i>Evidenca 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidenca 30.3. Strategjia për sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 18. Adresimi i rekomandimeve nga akreditimi më i fundit MPIA.pdf</i> <i>Evidenca 38. Analiza DIT mbi arritjen e objektivave formuese.pdf</i> <i>Evidenca 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UET ka zyrën e KSBC e cila bashkëpunon me departamentin dhe fakultetet në procesin e përmirësimit të cilësisë</i></p>

	<i>sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjetura i bëhën me dije Departamentit dhe shprehen edhe në raportet periodike. Pjesë e këtyre strukturave janë edhe student të cilat informohen në lidhje me procesin. Rekomandohet të realizohen veprimtari periodike me studentët për të informuar në formë të drejtëpërdrejtë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Informatikë e Aplikuar”, me profile: a) Dizajn dhe zhvillim aplikimesh; b) Menaxhim të dhënash; c) Siguria e sistemeve të informacionit; d) Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është inovativ dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës (Standardi I.1, Kriteri 4)
2. Programi zhvillohet nga një njësi me kapacitet të provuar akademik, me përvojë të qëndrueshme në fushën përkatëse. (Standardi I.2, Kriteri 1, 2, 3)
3. Strukturë funksionale e bashkëpunimit të brendshëm, ka ndarje të qarta detyrash ndërmjet njësive dhe rol të mirëpërcaktuar të aktorëve institucionalë në funksion të programit. (Standardi I.3, Kriteri 1)
4. Rrjet i gjerë bashkëpunimesh me institucione dhe kompani. (Standardi I.3, Kriteri 2, 3)
5. Eksperienca dhe kualifikimi i stafit. (Standardi III.1, Kriteri 4)
6. Procedura të përcaktuara mirë për pranimin e studentëve. (Standardi II.3, Kriteri 3)
7. Mbështetje për zhvillim profesional dhe përfshirje në leksione të hapura me profesionistë të fushës: (Standardi III.1, Kriteri 1)
8. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor. (Standardi III.1, Kriteri 3) dhe (Standardi IV.2, Kriteri 1, Kriteri 3)
9. Rritja e bashkëpunimit dhe pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. (Standardi I.3, Kriteri 2)
10. Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik në funksion të metodave bashkëohore të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare. (Standardi IV.1, Kriteri 1)
11. Ofrimi i mbështetjes së studentëve me anë të bursave dhe programet e mobilitetit, ndërkombëtarizimit për ata me rezultate të larta apo pjesëmarrjes dhe trajnimit në aktivitete dhe trajnime profesionale të organizuara nga UET dhe organizata profesionale apo kompani private. (Standardi V.1, Kriteri 8)
12. Procedura, struktura dhe standarte të mirëorganizuara të cilat vijnë në ndihmë të rritjes së cilësisë së programit të studimit dhe në ndihmë të studentëve. (Standardi V.1, Kriteri 1; Standardi V.6, Kriteri 1)

Pika të dobëta

1. Mungesë e evidentimi dhe dokumentimi të ndikimit të projekteve dhe partneriteteve të jashtme në përmbajtjen e programit (Standardi I.1, Kriteri 4).

2. Mungesë raportesh analitike për përfitimet nga bashkëpunimet, nuk ka indikatorë të matshëm apo reflektime të dokumentuara. (Standardi I.3, Kriteri 4)
3. Literatura e përdorur në këtë program studimi më së shumti është në gjuhën angleze dhe nuk plotëson kushtin të jetë jo më shumë se e 5 viteve të fundit. (Standardi II.4, Kriteri 5 dhe Standarti IV.3, Kriteri 1)
4. Nga institucioni nuk janë bërë publike sipas rekomandimit, të dhënat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit. (Standarti V.1, Kriteri 4)
5. Nuk ekziston një raport vjetor në nivel Institucioni. (Standardi I.3, Kriteri 4)
6. GVJ rekomandon të merren masa në lidhje me rritjen e ngarkesës mësimore për stafin akademik PAE me të paktën 70% të ngarkesës mësimore. (Standardi IV.1, Kriteri 2)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon që të vihet më shumë në pah ndikimi i projekteve të bashkëpunimit dhe partneriteteve me aktorë të jashtëm, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë dhe relevancës së programit të studimit. (Standarti I.1, Kriteri 4)
2. GVJ rekomandon që të ndërmerren hapa për ndërtimin dhe dokumentimin e trajnimeve profesionale për të diplomuarit në bashkëpunim me sektorin privat, duke reflektuar kështu angazhimin e institucionit për zhvillimin profesional të vazhduar dhe përputhjen me nevojat e tregut. (Standarti I.2, Kriteri 5)
3. GVJ sugjeron që në dokumentacionin përkatës të shtohet një përshkrim i qartë mbi arsyetimin e ndarjes së projektit të diplomës në dy semestra, për të siguruar transparencë dhe koherencë të brendshme në strukturën e programit. (Standarti II.1, Kriteri 3)
4. GVJ rekomandon që zhvillimi i praktikës profesionale të kalojë në semestrin e dytë të programit, pasi në këtë fazë studentët kanë përfunduar pjesën më të madhe të lëndëve dhe kanë fituar njohuri më të thelluara, që do të mundësojnë një përvojë praktike më të efektshme. (Standarti II.1, Kriteri 3)
5. GVJ rekomandon plotësimin e dosjes së programit të studimit me dokumentat që mungojnë në anglisht, për të përmbushur kërkesat e transparencës dhe ndërkombëtarizimit. (Standarti II.3, Kriteri 5)
6. GVJ rekomandon përditësimin e vazhdueshëm të literatureës për çdo lëndë dhe ofrimin e materialeve ndihmëse në gjuhën shqipe. Kjo do të kontribuonte në rritjen e transparencës, cilësisë akademike dhe përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. (Standarti II.4, Kriteri 5) (Standarti IV.3, Kriteri 1)
7. GVJ rekomandon hartimin dhe dorëzimin e një dokumenti që vërteton impaktin e drejtpërdrejtë të projekteve mbi përmbajtjen e programit. (Standarti II.5, Kriteri 4)
8. Jo-qëndrueshmëri e lartë e stafit akademik. (Standarti II.1, Kriteri 1)

127




9. Të bëhen publike nga institucioni sipas rekomandimit, të dhënat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe duke u përmbajtur legjislacionit për të dhënat personale.
10. GVJ rekomandon të merren masa në lidhje me rritjen e ngarkesës mësimore për stafin akademik PAE me të paktën 70% të ngarkesës mësimore. (Standardi IV.1, Kriteri 2)

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Applied Informatics", with profiles: a) Application Design and Development; b) Data Management; c) Information Systems Security; d) Project Management and Evaluation, provided by the Higher Education Institution "European University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. The study program is innovative and aligned with labor market needs. *(Standard I.1, Criterion 4)*
2. The program is implemented by an academic unit with proven capacity and consistent experience in the relevant field. *(Standard I.2, Criteria 1, 2, 3)*
3. Functional internal cooperation structure, with clearly defined responsibilities among units and well-established roles of institutional actors in support of the program. *(Standard I.3, Criterion 1)*
4. Extensive network of partnerships with institutions and companies. *(Standard I.3, Criteria 2, 3)*
5. Academic staff with solid qualifications and professional experience. *(Standard III.1, Criterion 4)*
6. Well-defined procedures for student admission. *(Standard II.3, Criterion 3)*
7. Support for professional development and involvement in open lectures with field experts. *(Standard III.1, Criterion 1)*
8. Adequate facilities and modern didactic infrastructure available for the study program, providing contemporary spaces and conditions for the teaching process. *(Standard III.1, Criterion 3 and Standard IV.2, Criteria 1 and 3)*
9. Increased cooperation and participation in national and international projects. *(Standard I.3, Criterion 2)*
10. The institution has developed specific mechanisms to support and enhance the professional qualifications of academic staff, in line with modern teaching methods, scientific research, and participation in international projects. *(Standard IV.1, Criterion 1)*
11. Student support through scholarships and mobility programs, internationalization for high-achieving students, and participation in training activities organized by UET and professional organizations or private companies. *(Standard V.1, Criterion 8)*


12. Well-organized procedures, structures, and standards that contribute to improving the quality of the study program and supporting student success. (*Standard V.1, Criterion 1; Standard V.6, Criterion 1*)

Weaknesses


1. Lack of evidence and documentation on the impact of external projects and partnerships on the content of the study program (Standard I.1, Criterion 4).
2. Absence of analytical reports on the benefits derived from collaborations; no measurable indicators or documented reflections are provided (Standard I.3, Criterion 4).
3. The literature used in this study program is mostly in English and does not meet the requirement of being published within the last five years (Standard II.4, Criterion 5; Standard IV.3, Criterion 1).
4. The institution has not made public, as previously recommended, the results of the study program evaluation (Standard V.1, Criterion 4).
5. There is no annual institutional report (Standard I.3, Criterion 4).
6. The EEG recommends that steps need to be taken regarding the increase in the teaching load for PAE academic staff by at least 70% of the teaching load. (Standard IV.1, Criterion 2)

Recommendation

1. The External Evaluation Group (EEG) recommends emphasizing the impact of collaboration projects and partnerships with external stakeholders, which directly contribute to enhancing the quality and relevance of the study program. (Standard I.1, Criterion 4)
2. The EEG recommends taking steps to develop and document structured professional training for graduates in cooperation with the private sector, thereby reflecting the institution's commitment to continuous professional development and alignment with labor market needs. (Standard I.2, Criterion 5)
3. The EEG recommends that the professional internship be moved to the second semester of the program, as students at that stage will have completed most of the coursework and acquired deeper knowledge, enabling a more effective practical experience. (Standard II.1, Criterion 3)
4. The EEG suggests that the relevant documentation include a clear justification for splitting the diploma project across two semesters, to ensure internal coherence and transparency in the program structure. (Standard II.1, Criterion 3)

129 

5. The EEG recommends completing the study program file with the missing documentation in English, in order to meet the requirements of transparency and internationalization. (Standard II.3, Criterion 5)
6. The EEG recommends the continuous updating of course literature and the provision of supplementary materials in the Albanian language. This would contribute to improved transparency, academic quality, and compliance with international standards. (Standard II.4, Criterion 5 and Standard IV.3, Criterion 1)
7. The EEG recommends drafting and submitting a document that demonstrates the direct impact of projects on the content of the study program. (Standard II.5, Criterion 4)
8. High turnover and lack of staff continuity is noted as a concern. (Standard II.1, Criterion 1)
9. The institution is recommended to publish the results of the study program evaluation, in line with academic freedom and ethics, and in compliance with legislation on personal data protection.
10. The EEG recommends that steps need to be taken regarding the increase in the teaching load for PAE academic staff by at least 70% of the teaching load. (Standard IV.1, Criterion 2)



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

